



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 398 Akti

Nr. 570 Vendimi
Tiranë, më 7.10.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 30.9.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Arjana Gumbardhi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arjana Gumbardhi, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në dhjetor të vitit 2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arjana Gumbardhi, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tre kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale – në datën 21.7.2022 vendosi (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arjana Gumbardhi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit në datën 7.9.2022.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe i analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë znj. Arjana Gumbardhi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi u ftua në seancën dëgjimore në datën 22.9.2022, ora 10:00, me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*-in e datës 19.9.2022¹.

10. Subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesën me *e-mail* në datën 21.9.2022, e cila kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 22.9.2022 në një datë tjetër. Komisioni, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, vendosi të zhvillojë seancën dëgjimore në datën 28.9.2022, ora 13:30.

11. Subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi u paraqit në seancën e datës 28.9.2022 me bashkëshortin, njëherazi edhe përfaqësuesi i saj, ku i kërkoi Komisionit shqyrtimin e tri kërkesave paraprake, për të cilat trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi dhe pas kthimit në sallë vendosi shqyrtimin e tyre dhe bashkë me vendimet e ndërmjetme për këto kërkesa me natyrë procedurale ta ftonte subjektin në një datë të afërt për zhvillimin e seancës dëgjimore.

12. Komisioni shqyrtoi kërkesat paraprake të subjektit dhe mori përkatësisht dy vendime²: vendimin nr. *** prot., datë 28.9.2022 dhe vendimin nr. ***, datë 29.9.2022. Me vendimin nr. ***, datë 29.9.2022, trupi gjykues vendosi ta ftojë subjektin e rivlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 30.9.2022, ora 10:00.

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, edhe nëpërmjet përfaqësuesit të saj, bashkëshortit A. G., shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë. Pas seancës subjekti depozitoi sërish dokumente shkrese dhe prova, të cilat u administruan me procesverbal nga sekretaria gjyqësore.

14. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arjana Gumbardhi. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 30.9.2022, për të rifilluar në datën 7.10.2022, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Znj. Arjana Gumbardhi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b të saj, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në

¹Vendimi nr.***, datë 19.09.2022.

²Shihni vendimet e ndërmjetme të Komisionit nr. *** prot., datë 28.9.2022, sipas vendimit procedural nr. ***, datë 28.9.2022 dhe nr. ***, datë 29.9.2022.

lidhje me vlerësimin profesional dhe procedurën që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse. Referuar vendimit nr. 2/2017³ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Arjana Gumbardhi (Caco), në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *mungon dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

18. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (e) denoncimet e publikut; (ë) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

³“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

19. Në lidhje me pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr.*) të dorëzuar në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi si vijon:**

1. Apartament banimi me sip. 39 m², në Tiranë

1.1 Ky apartament ndodhet në adresën: rruga “****”, pallati ***, shk. ***, ap. ***, e fituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.7.1993. Burimi i krijimit: pasuri e fituar në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me të ardhurat e familjes Caco. Çmimi i blerjes: 3.170 lekë. E pavlerësuar sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 33.3 %.

1.2 Për këtë pasuri të paluajshme rezultoi kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 6.7.1993, midis NK Banesave dhe shtetasve P, S dhe Arjana Caco në vlerën 3.170 lekë, si dhe kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.7.2005, me palë shitëse P e S. C dhe palë blerëse A.G, për shitje apartamenti me sip. 39.7 m², rr. “****”, Tiranë, në vlerën 100.000 lekë (ku pala blerëse përfiton 66%).

1.3 Për këtë pasuri subjekti është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie datë 4.7.2005, për apartament me sip. 39.7 m², në bashkëpronësi të shtetasve P, S dhe Arjana Caco, si dhe kartelë pasurie dhe certifikatë për vërtetim pronësie datë 14.9.2005, për apartament me sip. 39.7 m², në pronësi të z. A. G me 2/3 pjesë dhe znj. Arjana Caco me 1/3 pjesë.

1.4 ZVRPP-ja Tiranë konfirmon pasurinë apartament me sip. 39.7 m², në pronësi të A.G dhe Arjana Caco dhe kartelën e pasurisë për apartament me sip. 39.7 m², në pronësi të këtyre shtetasve, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 7.7.2005, ku palët shitëse P e S.C i shesin palës blerëse A.G 2/3 pjesë të apartamentit me sip. 39.7 m², në rr. “****”, Tiranë, në vlerën 100.000 lekë.

1.5 Nga hetimi i Komisionit rezultoi: kontrata e shitblerjes e vitit 1993 ndërmjet NK Banesave dhe shtetasve P, S dhe Arjana Caco në vlerën 3,170 lekë; kontrata për privatizimin e kësaj banese e lidhur në datën 26.9.1993 dhe regjistrimin më pas të saj në emër të shtetasit P. C (babai i subjektit) dhe kontrata e shitjes e vitit 2005 ndërmjet shtetasve P e S.C dhe blerësit A.G, përfituar 66% të kësaj prone.

Konkluzion: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë.

2. Shtesë anësore e apartamentit të mësipërm (pa leje ndërtimi) me sip. 68 m², në vitin 2000

2.1 Bashkëshorti i subjektit A.G ka depozituar kërkesë-formular vetëdeklarimi, datë 1.8.2006, për shtesë me sip. 68 m², pranë ALUIZNI-t Tiranë, si dhe aktekspertimin inxhinierik për shtesën. Vlera e shpenzimeve për ndërtimin e shtesës është 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat e subjektit si gjuqtare dhe të bashkëshortit. Pjesa takuese: 50%.

2.2 ALUIZNI Tirana 2 ka konfirmuar se z. A.G ka vetëdeklaruar ndërtimin informal në praktikën e legalizimit të subjektit vetëdeklarues F.S. Subjekti është pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 17.11.2017. Titulli i pronësisë mbi parcelën ndërtimore do të miratohet me VKM dhe, si rrjedhojë, nuk janë bërë pagesa për pjesën takuese të parcelës ndërtimore.

Hetimi i Komisionit

2.3 Rezultoi se për ndërtimin e shtesës prej 68 m², në rr. “****”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor preventiv/situacion punimesh, por vetëm një vlerë deklarative, shumë e shpenzimeve të ndërtimit prej 1.000.000 lekësh.

2.4 Në DPV/2003 subjekti nuk e deklaroi shtesën e apartamentit me sip. 68 m². Kjo shtesë deklarohet për herë të parë në DPV/2005 me sip. 50 m², por pa deklaruar vitin dhe vlerën e kostos së ndërtimit.

2.5 Për këtë Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimin të paraqiste dokumentacion të plotë, ku të detajonte burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj pasurie dhe kontributin e secilit, duke i ndarë sipas viteve.

2.6 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka deklaruar se: *“Ndërtimi si karabina e shtesës të cituar më lart ka përfunduar në fund të vitit 2000, ndërsa e banueshme pas kryerjes së punimeve të brendshme në qershor 2001. Dokumentacion ligjor si leje ndërtimi, preventiv, situacion, nuk disponojmë për këtë pasuri. Punimet e kësaj shtese anësore nuk janë kryer me shoqëri ndërtuese, por me punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të palicensuar në fushën e ndërtimit. Burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj pasurie kanë qenë kursimet financiare nga paga ime si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që prej datës 1.12.1993 e në vijim, si dhe kursimet financiare të bashkëshortit, që nga viti 1989 deri në shtator të vitit 1993, si mësuës pranë shkollës 8-vjeçare O, Vlorë, nga 1 dhjetori 1993 deri në gusht 1996, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për krijimin e kësaj pasurie janë përdorur edhe të ardhurat nga puna e bashkëshortit si avokat nga viti 1997 e në vijim”.*

2.7 Në lidhje me provueshmërinë e aktivitetit privat si avokat, subjekti ka sjellë vendime gjyqësore nga viti 1997 e në vijim, ku bashkëshorti figuron si përfaqësues/avokat (shihni listën e provave bashkëngjitur pyetësorit) dhe të ardhura sipas aktmarrëveshjes së datës 1.10.1999, në të cilën është parashikuar që av. A. G në përfundim të ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 19.9.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Tiranë, do të përfitojë shumën prej 1.500.000 lekësh. Kjo shumë është marrë nga ana e bashkëshortit A.G në fund të muajit dhjetor të vitit 1999. Kjo shumë është neto, për shkak se detyrimet tatimore të shumës totale janë paguar nga kreditori, shoqëria “***” sh.p.k. Këtë e provon me dokumentacionin ligjor në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi, ku përfshihet praktika⁴ që aktualisht posedon.

2.8 Më pas, subjekti shton se: *“Në lidhje me këtë praktikë rezervoj të drejtën të paraqes përpara jush edhe dokumentacionin që mund të ketë në arkivin e ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Drejtoria e Kthimit të Shumave, pasi me kërkesën nr. *** prot., datë 22.2.2022, i jam drejtuar Drejtorisë së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku kam kërkuar një kopje të kësaj praktike (kërkesë nr. *** prot., datë 22.2.2022)”.*

Analiza financiare

Në analizën financiare kostoja e ndërtimit të shtesës prej 68 m² është vlerësuar sipas vendimit nr. 362, datë 14.7.2000, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB...”. Sipas këtij vendimi kostoja mesatare për m² sipërfaqe ndërtimi për vitin 2000 ka qenë 24.780 lekë/m² dhe në këto kushte kostoja e ndërtimit të shtesës prej 68 m² është llogaritur në vlerën 1,685,040 lekë (68 m² x 24,780 lekë/m²).

Lidhur me mundësinë financiare për mbulimin e kostove të ndërtimit të shtesës prej 68 m², Komisioni i referohet analizës financiare të periudhës dhjetor 1993 – 2000.

Sipas analizës, Komisioni konstatoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e pasurive (likuiditete dhe investime) dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës në vlerën 4,584,791 lekë.

⁴Shihni dokumentet bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit nr. ***.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni doli në konkluzionet, si vijon:

- Subjekti nuk e ka deklaruar në DPV/2003 shtesën e apartamentit me sip. 68 m² të ndërtuar në vitin 2000. Në DPV/2005 deklarohet për herë të parë me sip. 50 m², por pa deklaruar vitin dhe vlerën e kostos së ndërtimit.
- Subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion kohën dhe vlerën e saktë të punimeve për ndërtimin e shtesës së apartamentit me sip. 68 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.
- Në mungesë të dokumentacionit ligjor preventiv/situacion punimesh për ndërtimin e shtesës me sip. 68 m², në analizën financiare Komisioni zbatoi koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga EKB-ja për vitin 2000, që sipas përlllogaritjeve rezultoi në shumën 1.685.040 lekë.
- Subjekti dhe bashkëshorti i saj rezultuan me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2000.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet dhe paraqitur prova në lidhje me konkluzionet e mësipërme.

2.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se: *“Ky ndërtim është deklaruar në DPV/2005 pasi ka qenë ndërtim informal dhe për kohën që është ndërtuar në DPV nuk ka pasur rubrikë për deklarimin e ndërtimeve informale, por vetëm ato me dok. ligjor dhe me kalimin e pronësisë së apartamentit ekzistues në favor të bashkëshortit tim të 2/3 të saj në vitin 2005, praktikisht kaloi pronësia e apartamentit dhe shtesës së saj prej 68 m².*

Si prova për kohën e ndërtimit janë faturat e materialeve të ndërtimit, letër personale që shtetasi F.S, banor i katit të parë dhe të tretë në këtë ndërtim, i drejton bashkëshortit tim në maj të vitit 2000, në të cilën konfirmohet koha e ndërtimit dhe mospagimi i vlerës së themeleve dhe zërash të tjerë të punimeve që lidhen me koston e ndërtimit nga ana e bashkëshortit tim, si dhe lidhja e kontratës së energjisë elektrike në emër të babait tim P.C, në datën 5 qershor të vitit 2001.

Për sa i përket konkluzionit dhe ngarkimin të barrës së provës për vlerën e kostos së ndërtimit, që nga ana juaj është përlllogaritur duke u bazuar në vlerën e kostos së ndërtimit të aplikuar nga EKB ka rezultuar 1.685.040 lekë, sqaroj se ndërtimi si karabina ka përfunduar në fund të vitit 2000, ndërsa e banueshme pas kryerjes së punimeve të brendshme është qershor 2001. Dokumentacion ligjor si leje ndërtimi, preventiv, situacion, nuk disponojmë për këtë pasuri. Punimet e kësaj pasurie nuk janë kryer me shoqëri ndërtuese, por me punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të palicensuar në fushën e ndërtimit.

Vlera e materialeve të ndërtimit të përdorura për ndërtimin e kësaj pasurie kanë qenë me një cilësi të ulët, si tullat, pllakat, hidro-sanitaret, punime elektrike, hidraulike etj. Përgatitja e betonit, llaçit, janë kryer me punë krahu, transporti po ashtu është kryer me punë krahu.

Themelet e godinës janë kryer nga shtetasi F.S, që është njëkohësisht edhe pronari i katit të parë dhe të tretë të kësaj shtese anësore. Vlen të theksohet se nga ana jonë janë ndërtuar tre faqe muri, pasi njëra faqe është e pallatit ekzistues. Për të vërtetuar vlerën e kostos së ndërtimit të shtesës anësore me sip. 68 m², që unë kam deklaruar, paraqes raport vlerësimi (tekniko-ekonomik), të hartuar nga ing. e licensuar në fushën e ndërtimit, znj. I.S, e cila në mënyrë të detajuar ka përcaktuar koston e ndërtimit të kësaj shtese zë për zë, në vlerën 772.047 lekë, duke hartuar librin e masave, si dhe situacionin e punimeve.

Në DPV/2005 ne nuk e kemi deklaruar vlerën e ndërtimit dhe të mobilimit të kësaj shtese anësore, por në deklaratën Vetting kemi deklaruar vlerën prej 1.000.000 lekësh, ku përfshihet kostoja e ndërtimit dhe mobilimi i saj, si shpenzime në total për këtë apartament”.

Subjekti kërkoi që vlera prej 1,685,040 lekësh të korrigohej në AF për vitin 2000, pasi diferenca e vlerës së llogaritur nga Komisioni me vlerën sipas situacionit të paraqitur prej saj është 909,993 lekë. Gjithashtu i kërkoi Komisionit që të marrë në konsideratë si të ardhura me burim të ligjshëm shumën prej 1,500,000 lekësh, të përfituara nga bashkëshorti nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, çështja “***” sh.p.k., për të cilën do të analizohet në vijim.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me faktet dhe rrethanat e çështjes

2.10 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të kësaj shtese: *“Kursimet financiare nga paga ime si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që prej datës 1.12.1993 e në vijim, si dhe kursimet financiare të bashkëshortit që nga viti 1989 deri në shtator të vitit 1993, si mësues pranë shkollës 8-vjeçare O, Vlorë, nga 1 dhjetori i vitit 1993 deri në gusht të vitit 1996, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe ardhurat nga puna e bashkëshortit si avokat nga viti 1997 e në vijim”.*

2.11 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti kërkoi që të merreshin në konsideratë provat e sjella bashkëlidhur parashtrimeve që kishin të bënin me të ardhurat e përfituara nga puna si gjyqtare dhe nga profesioni si mësues i bashkëshortit A.G për vitet 1989 – 1993, duke qenë se sipas subjektit ato nuk ishin llogaritur siç janë në të vërtetë. Komisioni i konsideroi këto prova dhe doli në përfundimin se vërtetimi i ISSH-së Tiranë⁵, dokument i sjellë në përgjigje të rezultateve të hetimit, provoi evidenca të disa pagave si gjyqtare, të pavërtetuara më parë për vitet 1994, 1997 dhe 1998, të cilat u bënë pjesë e analizës financiare nga ana e Komisionit. Ndërsa shkresa e Zyrës Vendore të Arsimit Vlorë-Himarë⁶, në të cilën thuhet se: *“...ju figuroni në numrin *** të regjistrit ku është pasqyruar vjetërsia në punë...”*, përveç faktit që ka qenë mësues për tri vite, nuk vërteton të ardhurat e përfituara të bashkëshortit të subjektit.

2.12 Të ardhurat e subjektit nga pagat si gjyqtare u korrigjuan duke shtuar vlerat sipas muajve përkatës. Ndërsa për të ardhurat si mësues të bashkëshortit për vitet 1989 – 1993, Komisioni nuk bëri ndryshime në analizën financiare. Gjithsesi, sipas vendimit të Kolegjit⁷, periudha para vitit 1993 është konsideruar si një periudhë ku kursimi ishte praktikisht i pamundur për shkak të zhvlerësimit të lekut nga inflacioni i lartë, prandaj mosnjohja e këtyre të ardhurave nuk ka një ndikim domethënës në analizën financiare.

2.13 Ndërsa në lidhje me të ardhurat e tjera nga avokatia të deklaruara nga subjekti për bashkëshortin e saj, ku për provueshmërinë e aktivitetit privat si avokat subjekti solli vendime gjyqësore nga viti 1997 e në vijim, ku bashkëshorti figuron si përfaqësues/avokat, Komisioni, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të përllogarisë apo të konsiderojë të ardhura vetëm mbi ekzistencën e disa vendimeve gjyqësore të sjella nga subjekti në përgjigje të pyetësorit. Përkundrazi, është detyrim i çdo subjekti deklarues deklarimi i të ardhurave në mënyrë të saktë e të qartë dhe vërtetuar edhe pagesa e detyrimeve përkatëse në shtet për këto të ardhura të përfituara.

2.14 Vënia në dispozicion e disa vendimeve gjyqësore, ku bashkëshorti i subjektit ka qenë përfaqësues ligjor në disa çështje gjyqësore, nuk përbën dokumentacion provues të përfitimit

⁵Shihni vërtetimin nr. *** prot., datë 28.6.2022, bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare.

⁶Shihni shkresën kthim përgjigjeje kërkesës për vërtetim vjetërsie ne punë nr. *** prot., datë 16.6.2022, e ZVA-së Vlorë-Himarë.

⁷Shihni vendimin nr. 161/2019, të Kolegjit.

të të ardhurave përkatëse. Por kjo nga ana e Komisionit është parë si mangësi në deklaram dhe justifikim i mungesës së të ardhurave të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur me të.

2.15 Ndërsa në lidhje me të ardhurat e përfituara sipas aktmarrëveshjes së datës 1.10.1999, në të cilën është parashikuar që av. A.G në përfundim të ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 19.9.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, do të përfitojë shumën prej 1.500.000 lekësh, Komisioni nuk i konsideroi ato⁸.

2.16 Subjekti dhe bashkëshorti i saj duhej të deklaronin edhe vlerën e këtij ndërtimi në DPV/2005, kohë kur kanë deklaruar për herë të parë këtë pasuri.

2.17 Në lidhje me pretendimin e subjektit për koston e ndërtimit të shtesës anësore të apartamentit ekzistues, subjekti dhe bashkëshorti paraqitën para Komisionit edhe një raport vlerësimi tekniko-ekonomik të hartuar nga ing. I. S., e cila ka përcaktuar koston e ndërtimit të shtesës në vitin 2000, në vlerën 772.047 lekë.

2.18 Komisioni, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në lidhje me konsiderimin e vlerës së përcaktuar nga raporti i vlerësimit teknik të koston së ndërtimit, arsyetoi se vlerën e përcaktuar prej 772.047 lekësh për ndërtimin e shtesës në vitin 2000, nuk e mori parasysh sepse aktekspertimi teknik i hartuar nga ekspertja e zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit është një akt i njëanshëm dhe i përgatitur për qëllim kontrolli të pasurisë së subjektit.

2.19 Për shkak të mungesës së dokumentacionit ligjor dhe teknik të kohës për ndërtimin e kësaj shtese apartamenti nga ana e subjektit, Komisioni mori në konsideratë standardin e vendosur nga Enti Kombëtar i Banesave si një standard i arsyeshëm, kur subjektet kanë dështuar të provojnë me dokumentacion ligjor koston e objekteve të ndërtuara në mënyrë informale.

2.20 Si përfundim, Komisioni, në mungesë të dokumentacionit ligjor preventiv/situacion punimesh për ndërtimin e shtesës me sip. 68 m², zbatoi koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga EKB-ja për vitin 2000, që sipas përlllogaritjeve rezulton në shumën 1,685,040 lekë.

2.21 Lidhur me analizën financiare të mundësisë së ndërtimit të shtesës prej 68 m², referohuni analizës financiare të periudhës dhjetor 1993 – 2000, paraqitur në tabelën si vijon:

⁸Sqarimin në lidhje me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave do ta gjeni në vijim në këtë vendim.

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ARJANA P. GUMBARDHI (CACO) - Dhjetor 1993 - 2000									
PERSHKRIMI	Dhjetor 1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	TOTAL
PASURI	1,057	0	0	0	1,200,000	1,265,027	1,135,461	1,780,629	1,686,097
Apartament banimi 39.7 m2, Rr. *** TR - 1993/2005	1057								1,057
Shtese anesore e apartamentit Rr. *** TR - 68 m2 - 2000								1,685,040	1,685,040
Apartament 54 m2 Rr. *** Vlore - 1994 - A. G.									0
Ndryshim ne likuiditet				0	1,200,000	1,265,027	1,135,461	95,589	
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,057	0	0	0	1,200,000	1,265,027	1,135,461	1,780,629	1,686,097
TE ARDHURA dokumentuar	9,000	285,117	369,868	250,464	183,829	352,501	400,833	727,855	2,579,467
Te ardhura nga paga subjekti Arjana Gumbardhi	4,500	143,517	206,102	147,994	183,829	352,501	400,833	429,550	1,868,826
Te ardhura nga puna A. G.	4,500	141,600	163,766	102,470					412,336
Te ardhura ne projektin e PMU A. G.					0	0	0	298,305	298,305
SHPENZIME	2,700	85,535	110,960	75,139	171,327	352,651	364,550	432,000	1,594,862
Shpenzime jetese	2,700	85,535	110,960	75,139	121,327	232,651	264,550	432,000	1,324,862
Shpenzime qiraje Tirane					50,000	120,000	100,000		270,000
Analiza dokumentuar	5,243	199,582	258,908	175,325	-1,187,498	-1,265,177	-1,099,178	-1,484,774	-4,397,569
					Pamundesi financiare dhjetor 1993 - 2000				-4,397,569

2.22 Në këtë analizë financiare janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit të saj nga puna, të vërtetuara me dokumentacion.

2.23 Në analizën financiare, shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas jurisprudencës së Kolegjit⁹, duke pasur parasysh që subjekti dhe bashkëshorti ishin me detyrë gjyqtarë në periudhën 1993 – 1996 dhe pas këtij viti në familjen e tyre prej katër personash (subjekti, bashkëshorti dhe dy vajzat) vetëm subjekti është me detyrë gjyqtare.

2.24 Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamjaftueshmëri financiare prej 4,397,569 lekësh për shtimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën dhjetor 1993 – 2000.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2000, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në geramat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Shtëpi banimi me sip. 191 m², në Tiranë

3.1 Kjo pasuri ndodhet në rrugën “***”, nr. ***, Tiranë. Data e krijimit 13.12.2011. Burimi i krijimit: kalim me trashëgimi ligjore nga babai P.C, me vendimin nr. ***, datë 30.9.2011. E pavlerësuar, sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 50%.

3.2 Kjo pasuri rezultoi e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. pasurie ***. vol. ***, f. ***.

3.3 Subjekti deklaron si adresë banimi: Njësia Administrative Nr. ***, rruga “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë dhe adresë dytësore: Njësia Administrative Nr.***, rruga “***”, nr. ***, Tiranë. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaron se nga dhjetori i vitit 2016 e në vazhdim jeton në këtë shtëpi me adresë: rruga “***”, nr. ***, Tiranë.

⁹Vendimi nr. ***, datë 18.6.2021, i Kolegjit për subjektin K. S.

3.4 Subjekti nuk solli një preventiv punimesh apo një vlerë investimi për këtë apartament të fituar me trashëgimi ligjore në vitin 2011.

3.5 Gjatë viteve 2011 – 2016, pas çeljes së trashëgimisë dhe kalimi në pronësi të pjesës takuese të banesës në rrugën “****”, Tiranë, në favor të subjektit, pyetjes drejtuar subjektit se “*Që nga koha kur ju keni filluar të jetoni aty, a janë bërë investime tek kjo pasuri apartament dhe truall, e nëse po, sa janë vlerat e investuara dhe burimet financiare të përdorura?*”, ajo ka deklaruar¹⁰ se: “*Kjo banesë është ndërtuar nga gjyshi im T.C (K) që në vitin 1935, godinë e cila deri në vitin 1991 ka shërbyer si rezidencë qeveritare në zonën e ish-bllokut në Tiranë, vila nr. ***, me dy kate me truall 880 m². Nga ana ime si bashkëpronare e 1/4 pjesë janë kryer shërbime të nevojshme mirëmbajtjeje në vitin 2014, 1.250 euro dhe në vitin 2015, 1.250 euro, ndërsa investime në truallin e kësaj pasurie nuk janë bërë. Burimet financiare të përdorura nga ana ime për pjesën takuese prej 25% janë nga kursimet e pagës time si gjyqtare dhe kursimet nga të ardhurat e bashkëshortit si avokat*”.

3.6 Në analizën financiare vlerat e shpenzuara për shërbime mirëmbajtjeje të deklaruara nga subjekti janë përfshirë si shpenzime në vitet përkatëse. Ndërsa shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti, të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard, janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2016.

4. Truall i banesës së mësipërme me sip. 880 m², në Tiranë

4.1 Kjo pasuri ndodhet në rrugën “****”, nr. ***, Tiranë. Data e krijimit 13.12.2011, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***,. Burimi i krijimit: kalim me trashëgimi ligjore nga babai P. C me vendimin nr. ***, datë 30.9.2011. E pavlerësuar, sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 25%.

4.2 Nga hetimi rezultoi se Bashkia Tiranë ka lëshuar shkresën nr. *** prot., datë 5.1.1993, me lëndë “Kthim pasurie të konfiskuar T. C, ku vendoset t’i kthehet shtetasit T.C një shtëpi me gjashtë dhoma që ndodhet në lagjen “****, në zbatim të ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991”. Vendim nr. ***, datë 22.9.1996, i KKK Pronave, me të cilin vendoset të njohë T.C ish-pronar të një parcele trualli me sip. 880 m² dhe kjo pasuri t’i kthehet trashëgimtarëve të tij.

4.3 Rezultoi certifikatë pronësie datë 13.12.2011, për truall me sip. 880 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve Arjana Gumbardhi, S.C dhe V.S dhe kartelë pasurie me shënimin dëshmi trashëgimie.

4.4 ZVRPP-ja Tiranë konfirmoi¹¹ pasurinë truall me sip. 880 m², në bashkëpronësi të shtetasve Arjana Gumbardhi, S.C dhe V.S dhe apartament me sip. 191 m², në bashkëpronësi pronësi të Arjana Gumbardhi dhe S.C.

Nga hetimi kryesisht, Komisioni doli në konkluzionin se nuk kishte problematika në lidhje me këtë pasuri të trashëguar nga babai në vitin 2011.

5. Depozitë në vlerën 1.134.885 lekë në “Raiffeisen Bank”

5.1 Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pjesa takuese: 100%.

5.2 Bazuar në dokumentin “nxjerrje llogarie” të “Raiffeisen Bank”, datë 21.1.2017, konfirmohet se subjekti Arjana Gumbardhi ka llogari rrjedhëse me gjendje në datën 30.1.2017 në shumën 134.885 lekë dhe në datën 30.1.2017 “Raiffeisen Bank” konfirmon depozitë në emër

¹⁰Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. ***.

¹¹Shihni dokumentacioni ligjor bashkëlidhur përgjigjes së ZVRPP-së.

të Arjana Gumbardhit me gjendje në vlerën 1.000.000 lekë. Kjo vërtetohet me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, të “Raiffeisen Bank”.

5.3 Gjithashtu, në përgjigje të “Raiffeisen Bank” në shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2020, konfirmohet i njëjti informacion.

Komisioni doli në konkluzionin se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar totalin e këtyre dy llogarive së bashku.

6. Llogari bankare në vlerën 194.328 lekë në “Credins Bank”

6.1 Kjo llogari është krijuar me kursimet nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjendja në datën e deklaramit në vlerën 194.328 lekë. Pjesa takuese: 100%.

6.2 Bazuar në dokumentin “nxjerrje llogarie” në “Credins Bank”, datë 21.1.2017, konfirmohet se subjekti Arjana Gumbardhi ka gjendje në llogarinë e saj në datën 21.1.2017 shumën 194.328 lekë.

6.3 Gjendja e llogarisë së pagës në “Credins Bank”, deklaruar nga subjekti në shumën 164.328 lekë, vërtetohet edhe me shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2017, të kësaj banke.

DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT A.G NË DEKLARATËN VETTING

7. Apartament me sip. 54 m², në Vlorë

7.1 Ky apartament ndodhet në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, Vlorë, blerë në vlerën 14.890 lekë, me kontratën nr. *** rep., datë 29.6.1994, sipas ligjit të privatizimit.

7.2 Kjo pasuri figuron e regjistruar në ZVRPP-në Vlorë me nr. pasurie ***, datë 7.7.1994. Burimi i krijimit: të ardhurat e familjes G (A.G, D. G, M.R.G, I. G). E pavlerësuar, sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 25%.

7.3 Sipas kontratës së privatizimit datë 29.6.1994, rezulton se midis NK Banesave dhe shtetasve D.G, si një prej bashkëpronarëve të apartamentit, është privatizuar apartamenti i ndodhur në rrugën “****”, Vlorë, me vlerë 14.890 lekë. ZVRPP-ja Vlorë konfirmon apartamentin me sip.54 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve A, D, M dhe I. G.

Komisioni doli në konkluzionin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë.

8. Shtesë kati pa leje ndërtimi, me sip. 70 m², në Vlorë

8.1 Kjo shtesë është ndërtuar mbi banesën ekzistuese në lagjen “****”, Vlorë, e regjistruar në ZVRPP-në Vlorë me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e cila figuron në emër të babait të subjektit R.G dhe bashkëpronarëve të tjerë.

8.2 Rezultoi se për këtë ndërtim është depozituar kërkesa për legalizim pranë ALUIZNI-t Vlorë, datë 16.7.2013 nga A. G (bashkëshorti i subjektit). Vlera totale e shpenzimeve për ndërtimin e kësaj shtese prej 70 m² është 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit për këtë ndërtim janë të ardhurat nga puna si avokat e bashkëshortit të subjektit. Pjesa takuese: 25%.

8.3 Subjekti ka sjellë: kopje të kërkesës për legalizim nr. *** prot., datë 16.7.2013, nga A.G për shtesë kati me sip. 70 m², lagjja “****”, Vlorë; foto objekti; certifikatë pronësie nr. ***, datë 14.9.2009, të truallit me sip. 267 m² në bashkëpronësi të shtetasit R.G, i cili zotëron 1/12 pjesë; si dhe dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 3.2.2016, ku caktohen trashëgimtarët ligjorë të R. G të cilët janë D, A, M dhe I.G, me ¼ pjesë secili.

8.4 ALUIZNI Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 31.7.2017, konfirmon aplikimin e shtetasit A. G, në bashkëpronësi të shtetasit R.G dhe pronarëve të tjerë, ku ky i fundit zotëron 1/12 pjesë.

8.5 Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor preventiv/situacion punimesh për ndërtimin e shtesës me sip. 70 m², ndodhur në lagjen “***”, Vlorë.

8.6 Në lidhje me këtë, subjektit iu kërkua të deklaronte dhe të provonte me dokumentacion ligjor vlerën e investimit, të mirëmbajtjes e shfrytëzimit të kësaj pasurie shtesë kati me sip. 70 m², si dhe u pyet nëse janë bërë investime tek kjo pasuri apartament dhe truall dhe, nëse po, sa janë vlerat e investuara dhe burimet financiare të përdorura?

8.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se: “Dokumentacion ligjor si leje ndërtimi, preventiv apo situacion nuk disponojmë për këtë pasuri. Punimet e kësaj pasurie nuk janë kryer me shoqëri ndërtuese, por me punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të palicensuar në fushën e ndërtimit”.

8.8 Ndërsa në lidhje me vlerën e materialeve të ndërtimit të përdorura për ndërtimin e kësaj pasurie, subjekti shpjegon se: “Ato janë të një cilësie të ulët. Përgatitja e llaçit dhe transporti janë kryer me punë krahu. Themelet dhe dyshemeja janë të godinës ekzistuese e cila figuron në emër të babait të bashkëshortit R.G dhe trashëgimtarëve të tjerë. Nuk ka shpenzime apo pagesë për nxjerrje leje ndërtimi, taksë të ndikimit në infrastrukturë, shpenzime inxhinierike, arkitekturore, roje kantieri, si dhe për mbikëqyrje të punimeve ekonomike.

Ndërsa, për sa i përket pjesës takuese të bashkëshortit tim, investimi i tij është 1.000.000 lekë, e ndarë në vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, përkatësisht në vitin 2013 vlera 300.000 (treqind mijë) lekë, në vitin 2014, 100.000 (njëqind mijë) lekë, në vitin 2015, 200.000 (dyqind mijë) lekë, në vitin 2016, 100.000 (njëqind mijë lekë), në vitin 2017, 300.000 (treqind mijë) lekë, diferenca e pagesave për përfundimin e pasurisë në vitin 2018 është kryer nga bashkëpronari tjetër dhe konkretisht vëllai i bashkëshortit I.G.

Në lidhje me vetëdeklarimin e kryer pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë, për këtë pasuri është kryer nga bashkëshorti im A.G për lehtësi të kryerjes së procedurave të legalizimit (sipas të drejtës zakonore është djali i madh i familjes, si dhe për shkak të proceseve gjyqësore që ka patur në lidhje me pjesëtimin e pasurisë midis bashkëpronarëve për pronën, e cila figuron e ndërtuar në vitin 1924 nga gjyshi dhe vëllezërit e tij, të bashkëshortit, mbi të cilën është kryer edhe ky ndërtim). Burimet financiare janë nga puna e bashkëshortit si avokat. Ndërsa nuk ka kosto në lidhje me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kësaj pasurie”.

Komisioni, pasi analizoi edhe deklaratimet e subjektit, arriti në konkluzionin se:

- Subjekti nuk e ka deklaruar këtë ndërtim pa leje në DPV/2013. Për herë të parë e deklaroi në DPV/2016, si dhe në deklaratën Vetting.
- Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, koston e ndërtimit të saj prej 1,000,000 lekësh e deklaroi të shpërndarë nga viti 2013 deri në vitin 2017.
- Në analizën financiare kostoja e ndërtimit të shtesës prej 70 m² është vlerësuar sipas udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2013, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB...”. Sipas këtij udhëzimi kostoja mesatare për m² sipërfaqe ndërtimi për vitin 2013 ka qenë 31,588 lekë/m² dhe në këto kushte kostoja e ndërtimit të shtesës prej 70 m² është llogaritur në vlerën 2,211,160 lekë (70 m² x 31.588 lekë/m²).
- Kjo vlerë prej 2,211,160 lekësh është bërë pjesë e analizës financiare të vitit 2013, sipas kërkesës për legalizim që bashkëshorti i subjektit ka paraqitur pranë ALUIZNI-t në vitin 2013 dhe jo sipas deklaratimit të subjektit në përgjigjen e pyetësorit nr. ***.

- Nga rezultati financiar negativ i vitit 2013, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për ndërtimin e shtesës prej 70 m², shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të vitit.

Në përfundim të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

- Subjekti nuk ka deklaruar në DPV/2013 shtesën e apartamentit me sip. 70 m².
- Subjekti nuk vërteton me dokumentacion kohën dhe vlerën e saktë të punimeve për ndërtimin e shtesës së apartamentit me sip. 70 m² në lagjen “****”, Vlorë.
- Subjekti nuk ka sjellë dokumentacion ligjor preventiv/situacion punimesh për ndërtimin e shtesës me sip. 70 m² dhe në mungesë të këtij dokumentacioni në analizën financiare është zbatuar kostoja mesatare e ndërtimit të banesave të miratuar nga EKB-ja për vitin 2013, sipas së cilës kostoja e ndërtimit arrin vlerën 2,211,160 lekë.
- Subjekti dhe bashkëshorti kanë pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2013.

8.9 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit për këtë pasuri, ka prapësuar se: *“Kjo shtesë kati është deklaruar në vitin 2016, për shkak se ky ndërtim ka filluar në muajin maj të vitit 2013 dhe ka përfunduar së ndërtuari në vitin 2016 dhe e banueshme në vitin 2017, pas kryerjes së punimeve të brendshme. Vetëdeklarimi është kryer më 16.7.2013, fakt i provuar me fotot ilustruese të vitit 2013”.*

8.10 Subjekti paraqiti edhe faturat e materialeve të ndërtimit pas vitit 2013, si dhe kërkesën për lidhjen e energjisë elektrike të vitit 2015. Gjithashtu, subjekti i është drejtuar Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, i cili ka kthyer përgjigje se për periudhën e kërkuar 2013 – 2014 nuk kanë ortofoto, por zotërojnë vetëm për vitin 2015.

8.11 Në lidhje me dokumentacionin ligjor të punimeve të kryera (leje ndërtimi, preventiv, situacion etj.) subjekti pranon se nuk zotëron, por deklaron se punimet i ka kryer me punëtorë të thjeshtë ndërtimi dhe mbikëqyrja e punimeve është bërë nga vëllai i bashkëshortit I. G.

8.12 Për të vërtetuar koston e ndërtimit subjekti ka cituar se: *“...do të paraqes raport vlerësimi tekniko-ekonomik, të hartuar nga ing. e licensuar në fushën e ndërtimit, ku kosto reale e ndërtimit të shtesës është prej... lekë (pa vlerë) dhe kontributi i bashkëshortit është në masën e ½ pjesë të kësaj vlere”.*

8.13 Subjekti kërkoi që vlera prej 2,211,160 lekësh e koston së ndërtimit duhet të korrigjohet në analizën financiare të vitit 2013 dhe nga kjo vlerë duhet zbritur gjysma e investimit të vëllait të bashkëshortit I. G., si dhe kjo vlerë duhet të jetë e shtrirë deri në vitin 2017.

8.14 Ndërsa për pamjaftueshmërinë e të ardhurave për ndërtimin e kësaj shtese në vitin 2013, subjekti i kërkoi Komisionit t’i referohet shpjegimeve dhe kontestimeve tek metodologjia lidhur me të ardhurat e bashkëshortit në vitin 2013.

8.15 Në seancën dëgjimore të datës 30.9.2022, subjekti, krahas dokumenteve të tjera, ka sjellë edhe një raport vlerësimi tekniko-ekonomik të ing. I. S., e cila ka llogaritur koston e ndërtimit, duke përfshirë llojin e punimeve të ndërtimit dhe kohën e realizimit të tyre për vitet 2013 – 2016, që rezulton në vlerën 1,565,681 lekë.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me shpjegimet përfundimtare të subjektit

8.16 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se: “...diferenca e pagesave për përfundimin e pasurisë në vitin 2018 është kryer nga bashkëpronari tjetër dhe konkretisht vëllai i bashkëshortit I.G”.

8.17 Për sa i përket kostos së ndërtimit, Komisioni dhe Kolegji kanë konsoliduar standardin e përdorimit në analizën financiare të kostove të ndërtimit sipas EKB-së, si një standard i arsyeshëm.

8.18 Komisioni vlerësoi se të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti privat në vitin 2013, pavarësisht pretendimit për xhiron e realizuar (3,000,000 – 4,000,000 lekë), nuk mund të konsiderohen mbi fashën deri në 2,000,000, për arsyet e parashtruara në rezultatet e hetimit. Subjekti nuk arriti të provojë që bashkëshorti të ketë realizuar të ardhura më të larta se 2,000,000 lekë dhe të ketë paguar detyrimet tatimore pranë organeve tatimore sipas ligjit në fuqi. Ajo çfarë shpreh subjekti është deklarative dhe nuk shoqërohet me dokumente të tjera zyrtare të ndryshme me ato çfarë ka sjellë deri në përfundim të rezultateve të hetimit.

8.19 Në referim të procedurave që përcakton ligji i legalizimit të ndërtesave informale, Komisioni nuk mori parasysh kërkesën për përgjysmimin e vlerës së investimit prej 1,000,000 lekësh dhe shpërndarjen e saj deri në vitin 2017.

8.20 Komisioni nuk mori parasysh raportin e vlerësimit tekniko-ekonomik të ing. I. S. me vlerë 1,565,681 lekë, me argumentimin se ekspertimi tekniko-ekonomik i hartuar nga eksperti e zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit nuk është dokument i kohës kur është ndërtuar shtesë kati pa leje dhe është një dokument i njëanshëm dhe hartuar për qëllim të procesit të kontrollit të pasurisë së subjektit e personave të lidhur me të. Ky vlerësim i Komisionit është koherent me qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për çështje të ngjashme.

8.21 Si përfundim, për shkak të mungesës së dokumentacionit ligjor dhe teknik të kohës për ndërtimin e kësaj shtese apartamenti nga ana e subjektit, Komisioni mori në konsideratë standardin e vendosur nga Enti Kombëtar i Banesave për vitet përkatëse dhe pikërisht vlerën e kostos së ndërtimit të shtesës prej 70 m², llogaritur në vlerën 2,211,160 lekë.

8.22 Komisioni nuk mori parasysh kërkesën e parashtruar të subjektit për përgjysmimin e vlerës së kostos së ndërtimit (duke zbritur gjysmën e investimit të vëllait të bashkëshortit I. G.) prej 2,211,160 lekësh pas korrigjimit në analizën financiare të vitit 2013, si dhe të pretendimit se kjo vlerë duhet të jetë e shtrirë deri në vitin 2017 me argumentimin se viti 2013 është viti kur subjekti ka paraqitur pranë ALUIZNI-t kërkesën për legalizim të objektit të ndërtuar në mënyrë informale dhe supozohet se ndërtimi ka qenë i përfunduar nga pikëpamja tekniko-ekonomike.

8.23 Subjekti dhe bashkëshorti i saj rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2013.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtesës së apartamentit në vitin 2013, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në gerrat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

9. Pasuri tokë me sip. 20.000 m², në T, Lezhë

9.1 Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* një sipërfaqe prej 20,000 m² tokë, e titulluar “moçal”, ndodhur në T, Lezhë. Data e krijimit 14.10.2013, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.10.2013, e regjistruar në ZVRPP-në Lezhë me nr. *** pasurie, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Çmimi i blerjes: 2.500.000 lekë. Burimi i blerjes së kësaj sipërfaqeje janë kontrata e porosisë datë 12.6.2011 dhe kontrata shtesë porosie, datë 25.2.2013,

ku objekti i tyre është dhënia e shërbimeve avokatore, konsulenca dhe përfaqësim në gjykim (shihni vendimin nr. ***, datë 26.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). E pavlerësuar, sipas çmimit të zonës ku ndodhet. Pjesa takuese: 50%.

9.2 Në DPV/2013 ka deklaruar: pasuri e paluajtshme, lloji “moçal”, e ndodhur në T, Lezhë, e regjistruar pranë ZVRPP-së Lezhë, z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me sip. 10,000 m², përfituar nga profesioni i bashkëshortit si avokat, nëpërmjet kontratës së porosisë datë 12.6.2011.

9.3 Subjekti ka paraqitur: certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 14.10.2013, për moçal me sip. 20,000 m², në bashkëpronësi të shtetasve A.Sh dhe A.G; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 8.10.2013, me palë shitëse M. P etj. dhe palë blerëse A.Sh dhe A. G, për blerje toke moçal me sip. 20.000 m², në vlerën 2,500,000 lekë, e likuiduar totalisht në zbatim të kontratës së porosisë datë 12.6.2011 dhe kontratës shtesë të porosisë datë 25.2.2013. Me qëllim justifikimin dhe përmbushjen e kontratës së porosisë, subjekti ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 26.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse familja L, palë e paditur AKK Pronave, me objekt “shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 10.12.2008, të AKK Pronave dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 10.6.2008, të KK Pronave Lezhë dhe vendimit nr. ***, datë 28.12.2002, të KK Pronave Lezhë”.

9.4 Nga hetimi rezultoi: certifikatë për vërtetim pronësie për moçal me sip. 20.000 m², në bashkëpronësi të familjes L; kontratë porosie datë 12.6.2011, me palë porositëse familjen L dhe palë e porositur avokat A.G dhe avokat A.Sh, ku pala porositëse cakton palën e porositur për të ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe administrative për shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 10.12.2008, të AKKP-së dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 10.6.2008 të KK Pronave Lezhë dhe vendimit nr. ***, datë 28.12.2002, të KKK Pronave Lezhë. Për kryerjen e këtij shërbimi, shpërblimi për avokatët do të jetë 20,000 m² nga prona e kthyer me vendimin nr. ***, datë 10.6.2008, të KKK Pronave Lezhë. Palët bien dakord që me përfundimin e përfaqësimit dhe të mbrojtjes së suksesshme të çështjes do të hartojnë një shtesë kontrate, ku do të përcaktohet saktësisht jo vetëm sipërfaqja prej 20,000 m², por edhe pozicionimi i saj.

9.5 ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Lezhë, e cila konfirmon se z. A.G ka pasur në bashkëpronësi me shtetasin A.Sh pasurinë moçal me sip. 20,000 m². Nga pjesëtimi z. A. G merr pasurinë nr. ***, me sip. 4,000 m², pasurinë nr. ***, me sip. 4,000 m² dhe pasurinë¹² nr. ***, me sip. 2,000 m².

9.6 U vërejt se vendosja e vlerës së kontratës prej 2,500,000 lekësh ishte e paqartë për pasurinë moçal me sip. 20,000 m², ndërkohë që deklarohet se është përfituar bazuar në kontratat e shërbimit/porosisë dhe në dukje vlerë e madhe në raport me shërbimin e kryer.

9.7 Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit¹³, e cila deklaroi¹⁴ se: “Ndërmjet av. A.G dhe av. A.Sh si dhe shtetasit Ll. L dhe bashkëpronarëve të tjerë është lidhur një kontratë porosie në datën 12.6.2011, ku objekt i kësaj kontrate është parashikuar se: ‘Porositësi Ll. L, i cili është përfaqësues më prokurë të përgjithshme edhe për bashkëpronarët e tjerë, kanë emëruar si përfaqësues të posaçëm dhe mbrojtës të interesave të tyre av. A.G dhe av. A. Sh, të cilët në bazë të kësaj kontrate marrin përsipër të japin shërbime juridike, konsulenca të vazhdueshme juridike dhe të ndjekin si mbrojtës ligjorë të të gjitha çështjeve civile, që lidhen me çështjet civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën

¹²Shihni dokumentet ligjore të regjistrimit të pasurisë bashkëlidhur deklaratës.

¹³Shihni pyetësin nr. ***.

¹⁴Shihni përgjigjet e pyetësit nr. ***.

e Shqipërisë, me të paditur AKK Pronave Tiranë, si dhe Zyrën Rajonale të KKKP Qarku Lezhë dhe në çështjet kundër ZVRPP-së Lezhë’.

*Kohëzgjatja e kësaj aktmarrëveshjeje është për periudhën e punës të kryer para hartimit të kësaj kontrate, e cila ka filluar që në datën 7.11.2008 dhe vijon deri në zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke përfshirë ekzekutimin e vendimit gjyqësor që finalizohet me pajisjen e certifikatës nga ZVRPP-ja Lezhë, të porositësve si bashkëpronarë të sipërfaqes së përcaktuar në vendimin nr. ***, datë 10.6.2008, të KKKP Qarku Lezhë. Sipërfaqja e përfituar nga Ll.L dhe bashkëpronarët e tjerë, sipas vendimit nr. ***, datë 10.6.2008, të KKKP Qarku Lezhë është rreth 2.000. Dy, që do të thotë se sipërfaqja prej 20.000 (njëzet mijë) m², të konvertuar në përqindje përfituar nga avokatët është 1%.*

*Kjo mënyrë shpërblimi është konform ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003, i ndryshuar, ‘Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë’, si dhe me urdhrin nr. *** prot., datë 16.5.2005 të DH.K.A., si dhe neneve 659 e vijues dhe 913 e vijues të Kodit Civil. Pas përpjekjeve të vazhdueshme të palëve të kësaj kontrate pranë ZVRPP-së Lezhë për regjistrimin e kësaj pasurie në emër të avokatëve, rezultoi se ZVRPP-ja Lezhë pranonte kalim pronësie vetëm nëpërmjet tre mënyrave: kontratë shitje, kontratë dhurimi ose me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

Çmimi dhe kontrata e shitjes nuk janë fiktive, pasi është marrë çmimi minimal fiskal i kësaj pasurie, por i titulluar ‘kullotë’, që në fakt është zë kadastral ‘moçal’, pasi nuk ka pasur çmim reference për zërin kadastral ‘moçal’ dhe referuar nenit 92, germa ‘ç’ e Kodit Civil, sqarojmë se një kontratë që të jetë fiktive ose e simuluar duhet të bëhet në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasojat juridike. Në lidhje me shprehjen se ‘shuma është likuiduar paraprakisht nga blerësi jashtë kësaj zyre’, sqarojmë se nuk kemi të bëjmë me likuidim monetar me pagesë në lekë, por është shërbimi i konvertuar në pasuri të paluajtshme dhe konkretisht të pasurisë të sipërcituar”.

9.8 Komisioni konstatoi se bashkëshorti i subjektit ka lidhur një kontratë me elementet e një kontrate shitblerjeje sipas Kodit Civil të një sipërfaqeje toke “moçal” prej 20,000 m² dhe mënyrën e kryerjes së pagesës, duke specifikuar se *likuidimi është bërë jashtë zyrës noteriale*, por nga ana tjetër në përgjigje të pyetësorit pranon se kjo kontratë është hartuar si kontratë shitblerjeje për efekt regjistrimi pranë ZVRPP-së Lezhë, duke qenë se qëllimi ka qenë kalimi i pasurisë sipërfaqe toke moçal prej 20,000 m² në dobi të bashkëshortit, sipas kontratës së porosisë së vitit 2011 dhe kontratës shtesë të porosisë së vitit 2013.

9.9 Gjithashtu, nga këqyrja e dokumenteve në dosje hetimore vërehet se bashkëshorti i subjektit dhe av. A.Sh kanë bërë një bashkim dhe më pas pjesëtim të pasurisë me sip. 40,000 m². Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. ***¹⁵, ka deklaruar se: *“Bashkëshorti im dhe av. A. Sh kanë pasur në bashkëpronësi pasurinë moçal me sip. 20,000 m². Pas regjistrimit të pronës në favor të bashkëpronarëve L është bërë kalimi i pronësisë tek bashkëshorti im A.G dhe av. A.Sh. Bashkëshorti im aktualisht ka në pronësi si rezultat i bashkimit dhe ndarjes së pronave 10,000 m² moçal”.*

Komisioni, në përfundim të hetimit, ka konstatuar se:

- Bashkëshorti i subjektit së bashku me av. A. SH kanë nënshkruar një kontratë për shitblerjen e pasurisë moçal me sip. 20,000 m², me çmim 2,500,000 lekë, për efekt regjistrimi të pasurisë në ZVRPP.

¹⁵Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. ***.

- Bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e avokatit, nuk rezulton të ketë dokumentuar me faturim shërbimin e ofruar ndaj bashkëpronarëve Ll. Ll etj.

Ndodhur në këtë situatë, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të sqarojë nëse për këtë shërbim të kryer nga viti 2008 e në vazhdim është lëshuar faturë dhe a është paguar tatimi sipas legjislacionit në fuqi.

9.10 Në lidhje me këtë kërkesë të Komisionit, subjekti ka sqaruar se *sipas *** të kontratës së shitblerjes nuk ka lëshuar asnjë faturë për këtë shërbim dhe nga ana e palëve nuk është kryer asnjë pagesë kundrejt punës si avokat dhe nuk është faturuar asnjë shërbim për punën e kryer dhe, për rrjedhojë, nuk ka dhe pagim të detyrimeve tatimore.* Më tej subjekti sqaron se *kjo aktmarrëveshje nga ana formale, siç e ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorëve nr. *** dhe nr. ***, pavarësisht se është titulluar kontratë shitblerjeje, ajo në përmbajtje është kontratë shkëmbimi.*

9.11 Kështu, referuar nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti deklaroi se ajo dhe bashkëshorti kanë të konfirmuara marrëdhëniet me familjen L dhe i kanë të justifikuar ligjshmëritë e burimit të krijimit të pasurive.

Vlerësimi i Komisionit

9.12 Komisioni, pas konsiderimit të shpjegimeve përfundimtare të subjektit edhe në seancën dëgjimore të datës 30.9.2022, doli në përfundimin se bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e avokatit për familjen L etj., sipas aktmarrëveshjes së vitit 2008 deri në vitin 2011 (vit i hartimit të kontratës së porosisë) dhe deri në vitin 2013 (vit i shtesës së kontratës së porosisë së vitit 2011 dhe hartimit të kontratës së shitblerjes së sipërfaqes së tokës prej 20,000 m² tokë moçal) nuk ka faturuar asnjë shërbim në dobi të kësaj familjeje pranë gjykatave në Lezhë dhe në Tiranë.

9.13 Përkundrazi, subjekti në shpjegimet e saj prapësoi se *kjo kontratë shitblerjeje në përmbajtje është kontratë shkëmbimi ndërmjet familjes L dhe av. A. G dhe nuk është kryer asnjë faturim për punën e kryer dhe, për rrjedhojë, nuk ka dhe pagim të detyrimeve tatimore.*

9.14 Pra, pavarësisht se kemi të bëjmë me shkëmbim në natyrë (këmbim), kontrata e shitblerjes së vitit 2013 është një veprim që pason ofrimin e shërbimit nga bashkëshorti i subjektit në një moment kohor të mëparshëm dhe mënyra e shlyerjes nëpërmjet shkëmbimit nuk shuan kurrsesi detyrimin ligjor të bashkëshortit të subjektit për të faturuar shërbimin e ofruar dhe detyrimin e subjektit për ta deklaruar ndër vite.

9.15 Pavarësisht shpjegimeve të subjektit, Komisioni konkludoi se nga data e regjistrimit të bashkëshortit të subjektit në organet tatimore në vitin 2007, çdo shërbim i bashkëshortit për klientët, përfshirë shërbimet e kryera sipas kontratës së porosisë, do të duhej të shoqëroheshin me faturë tatimore, qëndrim i mbajtur ky edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit¹⁶.

Sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e avokatit, ka kryer veprime fiktive, duke nënshkruar një kontratë shitblerjeje (e cila ishte kontratë shkëmbimi), duke mos lëshuar faturë tatimore për shërbimin e kryer ndaj familjes Ll. L., si dhe duke shmangur pagimin e detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit.

¹⁶Shihni vendimin nr. 11/2022, të Kolegjit për subjektin E. I.

10. Automjet tip “**”**

10.1 Automjeti tip “****” me targa TR ***, viti i prodhimit 1996, blerë në vlerën 350,000 lekë, me kontratën nr. ***, datë 28.7.2006. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna si avokat. Pjesa takuese: 100 %.

10.2 Rezultoi kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.7.2006, me palë shitëse R.Sh dhe palë blerëse A. G, për blerje automjeti në vlerën 350,000 lekë + praktika e palës shitëse dhe leje qarkullimi për automjetin tip “****”, me targa TR ***, në pronësi të z. A. G.

10.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2017, konfirmon se z. A. G ka në pronësi automjetin me targa TR ***.

10.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së në lidhje me blerjen e pasurisë automjet tip “****” në vitin 2006, me vlerë 350,000 lekë. Por, për shkak se për vitin 2006 nuk janë të vërtetuara të ardhura nga avokatia për z. A. G, nuk vërtetohet burimi i krijimit të kësaj pasurie sipas deklarimit në deklaratën *Vetting*.

10.5 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi: “... për vitin 2006 nga analiza financiare e kryer nuk rezultojnë të vërtetuara të ardhura nga avokatia për A. G dhe për pasojë nuk vërtetohet burimi i krijimit të kësaj pasurie sipas deklarimit në deklaratën *Vetting*”.

10.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se: “... *pavarësisht se automjeti është blerë nga bashkëshorti im, kam kontribuar edhe unë për blerjen e tij... Kontributi i bashkëshortit përfshin të ardhurat e siguruara nga shërbimet juridike në vitin 2006 në favor të shoqërisë ‘***’ sh.p.k.; nga punësimi pranë shoqërisë ‘***’ sh.p.k. (2006 - 2007); nga të ardhurat ‘***’ sh.p.k. etj. Gjithashtu, nga ana e Komisionit nuk janë llogaritur pagat e tre muajve të parë të vitit 2006 pranë Projektit të Rehabilitimit të Ujitjes pranë Ministrisë së Bujqësisë në vlerën 1.662 USD (554x3). Qëndrimi i Komisionit në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare për vitin 2006 për blerjen e automjetit është kontradiktor dhe me pasqyrën financiare të hartuar nga ky Komision, ku sipas përlllogaritjeve tuaja, ne për vitin 2006 rezultojmë me një vlerë pozitive 262.180 lekë, pa përfshirë të ardhurat e deklaruara më lart nga ana e bashkëshortit, si dhe duke përfshirë shpenzimet e ekzagjeruara për arsimimin e vajzave për të cilat kemi paraqitur kontestimet në lidhje me këtë pikë”.*

Vlerësimi i Komisionit

10.7 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar burim të blerjes së automjetit të ardhurat nga puna si avokat të bashkëshortit, ndërsa në shpjegimet përfundimtare deklaroi si burim edhe kontributin nga të ardhurat e saj. Në këtë mënyrë, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit.

10.8 Komisioni konsideroi pretendimin e subjektit në parashtrimet përfundimtare të saj dhe rillogaritë pagat e bashkëshortit, duke shtuar edhe tre muajt e parë të vitit 2006, duke përfshirë të ardhurat e përfituara nga PMU-ja, pranë Ministrisë së Bujqësisë, në shumën 1.662 USD, e barasvlefshme me 155,683 lekë.

10.9 Rezultoi se edhe pas kësaj shtese të ardhurash të vitit 2006 në vlerën 155,683 lekë, subjekti kishte pamjaftueshmëri për blerjen e automjetit në vlerën 350,000 lekë.

Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konkluzionit të Komisionit, nuk justifikoi me burime të ligjshme blerjen e automjetit, sipas përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

11. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*:

- sipërfaqe trualli prej 6.000 m², e ndodhur në Vlorë;
- sipërfaqe trualli prej 3.590 m², e ndodhur në Vlorë;
- sipërfaqe trualli prej 1.200 m², e ndodhur në Vlorë;
- sipërfaqe trualli prej 8.399 m², e ndodhur në Vlorë;
- sipërfaqe trualli prej 1.350 m², e ndodhur në Vlorë¹⁷.

11.1 Të gjitha këto pasuri janë trashëgimi ligjore nga babai R.G. Pjesa takuese: 2%.

11.2 Bashkëshorti i subjektit deklaroi se janë në proces regjistrimi për shkak të pasaktësisë së emrit A, A.

11.3 Subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor që vërteton bashkëpronësi të shtetasit R.G dhe 12 bashkëpronarëve të tjerë. ZVRPP-ja Vlorë¹⁸ nuk i ka konfirmuar këto pasuri.

11.4 Në lidhje me pasuritë sipërfaqe trualli të trashëguara nga babai i bashkëshortit të subjektit R.G, Komisioni konkludoi se këto pasuri të bashkëshortit, të cilat nuk ishin regjistruar për shkak të pasaktësisë së emrit A, A, ky argument nuk rezultoi bindës për sa kohë dëshmia e trashëgimisë ligjore përmban emrin A dhe jo A. Subjekti nuk e provoi me një dokument të ndryshëm këtë arsye që ka çuar në mosregjistrim pranë ZVRPP-së Vlorë. Megjithatë, në vlerësimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, ekzistenca e këtyre pasurive të bashkëshortit nuk prodhoi asnjë efekt, pasi këto pasuri janë përfituar me trashëgimi ligjore dhe në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* rezultojnë të paregjistruara.

12. Depozitë në vlerën 22.779 USD, në BKT

12.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT ***. Pjesa takuese: 100%.

12.2 Subjekti ka paraqitur të dhënat e depozitës në BKT, datë 25.10.2016, në emër të z. A.G në vlerën 22.779 USD dhe *statement* të BKT-së për depozitë në emër të këtij shtetasi.

12.3 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, konfirmon depozitë në emër të z. A.G, me gjendje në datën 27.1.2017 në vlerën 22.838 USD.

12.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT-së.

13. Depozitë në vlerën 29.728 euro, në BKT

13.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT ***. Pjesa takuese: 100 %.

13.2 Subjekti ka paraqitur të dhënat e depozitës në BKT, datë 25.10.2016, në emër të z. A.G në vlerën 29.728 euro dhe *statement* të BKT-së për depozitë në emër të këtij shtetasi.

13.3 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, konfirmon depozitë në emër të z. A.G, me gjendje në datën 27.1.2017 në vlerën 29.741 euro.

13.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT-së.

14. Depozitë në vlerën 40.255 euro, në “Intesa Sanpaolo Bank”

14.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT ***. Pjesa takuese: 100 %.

¹⁷Shihni dokumentacionin bashkëlidhur deklaratimit në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017, të ZVRPP-së Vlorë.

14.2 Subjekti ka paraqitur dokumentin “nxjerrje llogarie” nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 25.10.2016, për z. A. G, ku pasqyrohen lëvizjet e depozitës. Në datën 18.12.2013 është hapur depozita në vlerën 40.255 euro.

14.3 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, konfirmon depozitë në emër të z. A.G, me gjendje në datën 28.1.2017 në vlerën 40.578 euro.

14.4 Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e “Intesa Sanpaolo Bank” dhe DPPPP-në.

15. Depozitë në vlerën 30.048 euro, në “Raiffeisen Bank”

15.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT ***. Pjesa takuese: 100 %.

15.2 Subjekti ka paraqitur dokumentin “nxjerrje llogarie” nga “Raiffeisen Bank”, datë 21.1.2017, për z. A.G, ku gjendja e depozitës në datën 16.1.2017 është 30.048 euro.

15.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, konfirmon depozitë në emër të z. A. G, me gjendje në datën 30.1.2017 në vlerën 30.048 euro.

15.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

16. Depozitë në vlerën 1.992.281 lekë, në “Raiffeisen Bank”

16.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT ***. Pjesa takuese: 100 %.

16.2 Subjekti ka paraqitur dokumentin “nxjerrje llogarie” nga “Raiffeisen Bank”, datë 21.1.2017, për “A.G” person fizik, me gjendje në datën 23.1.2017 në vlerën 1.992.281 lekë.

16.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datën 3.7.2017, nuk e konfirmon këtë depozitë, pasi është llogari si person fizik.

16.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.

17. Depozitë në vlerën 80.652 USD, në “Raiffeisen Bank”

17.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NITP ***. Pjesa takuese: 100%.

17.2 Subjekti ka paraqitur dokumentin “nxjerrje llogarie” nga “Raiffeisen Bank”, datë 21.1.2017, për z. A. G, me gjendje në datën 30.12.2016 në vlerën 80.652 USD.

17.3 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, konfirmon depozitë në emër të z. A.G me gjendje datë 30.1.2017, në vlerën 80.650 USD.

17.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e “Raiffeisen Bank” dhe DPPPP-në. Të ardhurat e deklaruara nga avokatia që kanë shërbyer si burim janë trajtuar në vijim.

18. Depozitë në vlerën 2.348 USD, në “Raiffeisen Bank”

18.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT ***. Pjesa takuese: 100%.

18.2 Subjekti ka paraqitur dokumentin “nxjerrje llogarie” nga “Raiffeisen Bank”, datë 21.1.2017, për z. A.G, me gjendje në datën 30.12.2016 në vlerën 2.348 USD.

18.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2017, konfirmon llogari kursimi në emër të z. A.G, me gjendje në datën 30.1.2017 në vlerën 2.348 USD.

18.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

19. Depozitë në vlerën 37.159 USD, në “ProCredit Bank”

19.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT ***. Pjesa takuese: 100%.

19.2 Subjekti ka paraqitur dokumentin “lëvizje llogarie” nga “ProCredit Bank”, datë 23.1.2017, për z. A.G, me gjendja në datën 1.1.2017 në vlerën 37,159 USD.

19.3 “ProCredit Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2017, konfirmon llogari kursimi në emër të z. A .G, me gjendje në datën 28.1.2017 në vlerën 37,127 USD.

19.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e “ProCredit Bank”.

20. Llogari rrjedhëse në vlerën 51.438 USD, në “ProCredit Bank”

20.1 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat me nr. licence *** dhe NIPT *** dhe nga administrimi i pronave të familjes M, sipas prokurës së përgjithshme datë 4.7.2001. Pjesa takuese: 100 %.

20.2 Bazuar në dokumentin “lëvizje llogarie” nga “ProCredit Bank”, datë 23.1.2017, për z. A.G, rezulton se gjendja e llogarisë në datën 1.1.2017 është në vlerën 51,438 USD.

20.3 “ProCredit Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2017, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të z. A.G, me gjendje në datën 28.1.2017 në vlerën 51,435 USD.

20.4 Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e “ProCredit Bank”.

21. Konstatime në lidhje me depozitat dhe llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit

- Komisioni, pas hetimit të mundësisë së krijimit të këtyre likuiditeteve sipas deklarimeve të bashkëshortit të subjektit në cilësinë e avokatit, konstatoi se, referuar burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit A.G ka ushtruar aktivitet privat të ligjshëm nga viti 2007 e në vazhdim. Të ardhurat e krijuara nga shtatori i vitit 2007 deri në vitin 2016 janë konsideruar të ardhura të ligjshme të tij.
- Komisioni ka konsideruar të ardhura të ligjshme të tij ato të ardhura që vërtetohen me dokumentacion tatimor të këtyre viteve (nga viti 2007 e në vijim), por edhe të ardhurat e përfituara nga Projekti i Rehabilitimit në MBU për vitet 2000 – 2005 (bashkë me dëmshpërblimin e fituar nga gjykata, si shkak i ndërprerjes së kësaj kontrate nga MBU-ja në vitin 2009).
- Të ardhurat totale të ligjshme të vërtetuara nga z. A. G si përfaqësues ligjor/avokat për periudhën 1997 – 2016, arrijnë vlerën 17,262,799 lekë.
- Ndërkohë, vlera e gjendjes së llogarive dhe depozitave në emër të tij në fund të vitit 2016 është 41,326,002 lekë.
- Për mundësinë e krijimit dhe shtimit të këtyre likuiditeteve, Komisioni duhet t’i referohet rezultatit financiar të viteve në analizën financiare të përgatitur nga Njësia e Shërbimit Ligjor.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor burimin e krijimit të totalit të likuiditeteve bankare (depozita dhe llogari rrjedhëse) të deklaruara në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratimet periodike, me burim të deklaruar nga të ardhurat e bashkëshortit nga puna si avokat.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

21.1 Në lidhje me pikën e parë të konstatimeve, subjekti ka sqaruar se: “...cilësia e avokatit nuk merret kur regjistrohesh në organin tatimor, por është titull që merret pas një kualifikimi të caktuar, si dhe bashkëshorti im në QKB për periudhën shtator 2007 – dhjetor 2016 figuron me objekt të veprimtarisë së tij shërbime juridike dhe jo avokat. Gjithashtu, nga ana e Komisionit nuk janë llogaritur të ardhurat si individ natyror në dhënien e shërbimeve juridike pranë shoqërive të ndryshme ose individëve të tjerë”.

21.2 Ndërsa në lidhje me përlllogaritjen e të ardhurave të përfituara nga PMU-ja, subjekti kërkon që t’i bëhen pjesë e analizës pagat e bashkëshortit deri më 31.3.2006, ditë kur janë ndërprerë marrëdhëniet e punës pranë PMU-së. Gjithashtu, pretendon se: “Komisioni në mënyrë të gabuar interpreton këto të ardhura si të ardhura nga aktiviteti privat dhe dëmshpërblimin e fituar nga gjykata e konsideron si shkak i ndërprerjes së kësaj kontrate, kur në fakt ato të ardhura janë si rezultat i marrëdhënieve të punës dhe dëmshpërblimi i fituar nga gjykata është dhënë për shkak të ndërprerjes së këtyre marrëdhënieve të punës në mënyrë të paligjshme. Komisioni anashkalon këtë fakt të rëndësishëm që është dhe determinant për të sqaruar shërbimet juridike të dhëna nga bashkëshorti im si i punësuar pranë PMU-së dhe pranë shoqërive ‘***’ sh.p.k. etj. Në kontratat të nënshkruara ndërmjet A G dhe PMU-së, ai është titulluar ‘avokat’, ndërsa në listën e punonjësve deklarohet jurist. Komisioni, në llogaritjen e të ardhurave totale nga punësimi pranë PMU-së, ka gabuar duke mos përfshirë edhe shpërblimet në fund viti, dhe si rezultat i këtyre paqartësive ka arritur në konkluzion të gabuar kur konkludon, që të ardhurat totale të ligjshme të vërtetuara nga A G si përfaqësues ligjor avokat për periudhën 1997 - 2016 në vlerën 17.262.799 lekë, ku në këtë shumë nuk është përfshirë paga si ndihmës gjyqtar dhe gjyqtar, megjithëse në analizën financiare janë të pasqyruara.

Bashkëshorti im vetëm për periudhën shtator 2007 - 2016 ka të ardhura të dokumentuara prej 30.000.000 lekësh, sipas xhiros vjetore mbi të cilën ka paguar detyrimet tatimore. Për sa i përket konstatimit të Komisionit se vlera e gjendjes së llogarive dhe depozitave në emër të A.G në fund të vitit 2016 është 41.326.002 lekë, ndërsa të ardhurat e dokumentuara për periudhën 1997 - 2016 janë 17.262.799 lekë, është rezultat i nxjerrë nga një metodologji e gabuar dhe alogjike sepse bën konvertimin e monedhave të ndryshme në të njëjtën periudhë kohore (dhjetor 2016), ndërkohë që ato janë depozituar në bankë në kohë të ndryshme”.

Vlerësimi i Komisionit

21.3 Për statusin e bashkëshortit të subjektit si i punësuar pranë PMU-së, Ministria e Bujqësisë, Komisioni nuk ka pasur objekt shqyrtimi çështjen nëse ai ishte i punësuar si jurist apo me kontratë si avokat pranë këtij institucioni, përkundrazi, Komisioni ka bërë pjesë të analizës financiare të ardhurat e përfituara për periudhën sipas dokumentacionit të sjellë nga subjekti (ku përfshihen kopje të kontratave, vendime gjyqësore urdhërezekutimi etj.).

21.4 Ndërsa, ashtu siç është sqaruar edhe më lart, Komisioni rilloqariti pagat e bashkëshortit të subjektit, duke shtuar pagën e muajit gusht të vitit 2000, si edhe tre muajt e parë të vitit 2006¹⁹, kurse për shpërblimet e përfituara prej tij përgjatë këtyre viteve shihni shpjegimin e dhënë në pikën 21 të këtij vendimi.

21.5 Komisioni ka vlerësuar të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit sipas dokumentacionit provues, duke vlerësuar të ardhurat në një total prej 17,604,356 lekësh. Ndërkohë, likuiditetet e krijuara prej tij gjatë viteve nuk janë bazë krahasuese me të ardhurat totale të gjithë periudhës. Mundësia e krijimit të secilës prej këtyre llogarive/depozitave shihet nga rezultati financiar i vitit përkatës të krijimit të tyre.

22. Konstatime të tjera në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit

22.1 Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit, në rubrikën e përshkrimit të të ardhurave, ka deklaruar:

- a. Angazhimin në veprimtari private me profesionin avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, në vlerën 24,318,000 lekë.
- b. Angazhimin pranë Projektit të Rehabilitimit të Ujitjes pranë Ministrisë së Bujqësisë për periudhën 2000 – 2006, në vlerën 40,000 USD.
- c. Angazhimin pranë shoqërisë “****” sh.p.k. për vitet 2004 – 2007, në vlerën 1.950.000 lekë.
- d. Angazhimin pranë shoqërisë “****” sh.p.k. në vlerat 960.000 lekë dhe 24,000 euro.
- e. Të ardhura nga administrimi i pronave të familjes M sipas prokurës së përgjithshme, datë 4.7.2001 (pa vlerë).

22.2 Në lidhje me pyetjen që i është bërë subjektit për angazhimin në veprimtari private nga bashkëshorti me profesion avokat në vlerën 24.318.000 lekë²⁰, subjekti ka paraqitur në formë tabelare të ardhurat e pretenduara nga veprimtaria private si avokat në: Projektin e Menaxhimit të PMU-së, Ministria e Bujqësisë; shoqërinë “****” sh.p.k.; shoqërinë “****” sh.p.k.; shoqërinë “****” sh.p.k.; shoqërinë “****” sh.p.k.; T. E; Xh.Sh; shoqërinë “****” dhe të ardhurat nga administrimi i familjes M.

22.3 Në lidhje me të ardhurat nga Projekti i Menaxhimit të PMU-së, Ministria e Bujqësisë, subjekti ka sjellë si prova kontratat për shërbime juridike pranë këtij institucioni (2000 – 2005) dhe ekzekutimin në vitin 2009 të vendimit nr. ***, datë 19.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

22.4 Komisioni i mori si të ligjshme këto të ardhura të pretenduara nga bashkëshorti i subjektit sipas kontratave të shërbimit në vlerën 24.750 USD dhe sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 19.3.2007, në vlerën 8.450 USD, të ekzekutuar në vitin 2009. Në total të ardhurat e vërtetuara nga bashkëshorti i subjektit nga Projekti i Menaxhimit të PMU-së në Ministrinë e Bujqësisë arrijnë në vlerën 33.200 USD.

22.5 Në lidhje me të ardhurat nga Projekti i Rehabilitimit në Ministrinë e Bujqësisë, Komisioni konkludoi se subjekti arriti të provonte me dokumentacion të ardhura nga Projekti i Rehabilitimit të Ujitjes pranë Ministrisë së Bujqësisë për periudhën 2000 – 2005 në vlerën totale 33.200 USD. Ndërkohë, në deklaratën *Vetting* pretendonte të ardhura totale pranë Projektit të Rehabilitimit të Ujitjes në Ministrinë e Bujqësisë për periudhën 2000 – 2006 në

¹⁹Shpjegim i dhënë tek analiza e mundësisë së blerjes së automjetit në vitin 2006, ku, pas rilloqaritjes së tre pagave (janar-mars 2006), Komisioni bëri pjesë të analizës financiare edhe vlerën prej 1.662 USD, të barasvlefshëm me 155.683 lekë.

²⁰Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. ***.

vlerën 40.000 USD. Mbetet e paprovuar me dokumentacion ligjor diferenca e të ardhurave të pretenduara prej 6.800 USD (40.000 – 33.200).

Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

22.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti prapësoi se: *“Komisioni ka marrë si të ligjshme të ardhurat e pretenduara sipas kontratave në vlerën 24.750 USD dhe sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 19.3.2007, në vlerën 8.450 USD, të ekzekutuar në vitin 2009, ku në total arrijnë vlerën 33.200 USD. Subjekti pretendoi se duhej të llogariteshin edhe tre pagat e para mujore të vitit 2006, si dhe sipas Bankës Botërore dhe të Ministrisë së Bujqësisë pagat e punonjësve në dollarë të konvertoheshin në kursin 1:1 në euro.*

*Në momentin e zgjidhjes së kontratës së punës, duke iu referuar kontratës së 6 pagave të fundit të vitit 2005, paga është 450 USD, ndërsa po t'i referohemi pagesës së pagës 554 USD kemi një diferencë të pallogaritur prej 110 USD në muaj. Këtë e vërtetoj me vendimin gjyqësor nr.*** datë 19.3.2007 dhe me transaksionin datë 10.4.2006, të BKT-së. Gjithashtu, nga Komisioni nuk janë llogaritur shpërblimet në fund viti, si dhe pagat e muajve prill, maj dhe gusht të vitit 2000.*

Në total të ardhurat e pallogaritura nga PMU-ja kapin vlerën 5.450 USD ose 904.686 lekë”.

22.7 Bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare, subjekti solli si provë edhe një kopje të observacionit mbi projekt-raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, lidhur me procesverbalin nr. *** në të cilin janë pasqyruar shpërblimet për fundvit dhe problematika lidhur me konvertimin e pagesës së punonjësve sipas kursit të këmbimit dollarë-euro, e cila është në raportin 1:1.

22.8 Për përllogaritjen e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit pranë PMU-së, Komisioni ka marrë parasysh kontratat 6-mujore të punës së tij pranë këtij institucioni, e cila daton më 15.5.2000 deri në dhjetor të vitit 2005. Por, Komisioni, duke parë prapësimet e subjektit si dhe datën 10.4.2006, ku bashkëshorti i subjektit i drejtohet gjykatës me kërkesëpadi për zgjidhje të kontratës së punës, duke cituar se *marrëdhënia e punës ka vazhduar pa kontratë në vitin 2006 deri në datën 31.3.2006*, bëri pjesë të analizës financiare pagën e muajit gusht të vitit 2000, si dhe tre paga mujore të vitit 2006 (janar – mars 2006).

22.9 Ndërsa në lidhje me shpërblimet në fundvit, siç subjekti pretendoi, rezultoi se në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka paraqitur në formë tabelare të ardhurat e realizuara nga veprimtaria private me profesion avokat nga bashkëshorti, ku shpërblimet nga dy paga për vit i pretendoi për vitet 2004 dhe 2005 dhe jo që nga viti 2000, siç i kërkon në prapësime. Ndërsa për vitin 2006 pretendoi pagat janar - mars nga 450 USD/muaj.

22.10 Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka qenë subjekt i përfitimit të këtyre shpërblimeve dhe aq më pak nuk provohet me dokumentacion që t'i ketë marrë ato shpërblime. Kështu që këto shpërblime për vitet 2000 – 2005, nuk u bënë pjesë e analizës financiare si të ardhura të përfituara nga bashkëshorti i subjektit.

22.11 Ndërsa në lidhje me konvertimin e pagesës me kursin dollarë-euro 1:1 nga viti 2003 e në vazhdim, rezultoi se kontratat e bashkëshortit të subjektit me PMU-në janë në monedhën dollarë. Gjithashtu, edhe dokumenti bankar nga BKT-ja (kërkesë transaksioni datë 10.4.2006), i përdorur si provë nga subjekti është gjithashtu në monedhën dollarë. Edhe vlera e dëmshpërblimit nga vendimi i gjykatës nr. ***, datë 19.3.2007, është në monedhën dollarë (8.450 USD). Kështu që, lidhur me saktësimin e monedhës (euro apo dollarë), me të cilën është paguar bashkëshorti i subjektit nga PMU-ja, Ministria e Bujqësisë, nga viti 2003 e në

vazhdimësi, Komisioni vlerësoi se me këto dokumente doli e qartë se ai ka përfituar të ardhurat në monedhën dollarë.

22.12 Pas rillogaritjes në analizën financiare, këto të ardhura të përfituara nga bashkëshorti i subjektit arrijnë vlerën 26.712 USD nga kontratat e shërbimit për periudhën maj 2000 – mars 2006, si dhe vlerën 8.450 USD nga vendimi i gjykatës për dëmshpërblim në vitin 2009. Në total këto të ardhura arrijnë vlerën 35.162 USD.

22.13 Lidhur me të ardhurat nga shoqëria “**” sh.p.k.**, subjekti ka sjellë si provë kontratën e porosisë me këtë shoqëri në vitin 2004, ku z. A. G nënshkruan si avokat pa qenë i regjistruar në organet tatimore.

22.14 Subjekti, në përgjigje të pyetjes së Komisionit për këtë fakt, është përgjigjur se: *“Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore të kërkuara prej jush sqarojmë se, bazuar në nenin 8 pika l/a ‘E ardhura e tatueshme’, neni 9 ‘Tarifa tatimore’, neni 10 ‘Mbledhja e tatimit’, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, si dhe të pikës 2.5 të udhëzimit nr. 3, datë 11.2.2002, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, është detyrë e punëdhënësit që të bëjë ndalesat në borderotë e pagave, për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me punësimin aktual”*. Gjithashtu, subjekti kërkon që t’i rezervohet e drejta për të paraqitur vërtetim përkatës të lëshuar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 2004 – 2007.

22.15 Komisioni vlerësoi se referuar edhe përgjigjes²¹ së subjektit, e cila deklaroi se është detyrë e punëdhënësit që të bëjë ndalesat në borderotë e pagave, për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me punësimin aktual, është e vërtetë kjo, por në kushtet kur bashkëshorti i subjektit do të ishte i kontraktuar me kontratë shërbimi/porosie si individ dhe duhet të vërtetohej pagesa e tatimit në burim për këto të ardhura.

22.16 Ndërsa, kur kontrata/marrëveshja lidhet në cilësinë e avokatit, siç është kontrata e porosisë së vitit 2004 ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe avokat A G, ky i fundit duhet të ishte patjetër i regjistruar në QKB dhe subjekt tatimor.

22.17 Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2022, si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2022, konfirmojnë se lidhur me shërbimet e kryera për shoqërinë “****” sh.p.k. me NIPT ***, nuk rezulton të kenë bërë ndonjë pagesë për tatimin në burim.

22.18 Në këto kushte, edhe të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti i subjektit përgjatë viteve 2004 – 2007 pranë kësaj shoqërie nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme.

22.19 Sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara pranë shoqërisë “****” sh.p.k. për vitet 2004 – 2007 në vlerën 1.950.000 lekë, sipas deklarimit në deklaratën *Vetting*.

Në referim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e këtij konkluzioni të Komisionit.

22.20 Subjekti, në shpjegimet përfundimtare, ka mbajtur këtë qëndrim: *“Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti im nga shërbimet e kryera pranë shoqërisë ‘****’ sh.p.k.; shoqërisë ‘****’ sh.p.k.; shoqërisë ‘****’ sh.p.k.; shoqërisë ‘****’ sh.p.k., si dhe personave fizikë natyrorë Xh.Sh etj., përkon me një pjesë të periudhës 1.4.2000 – 31.3.2006 që*

²¹Shihni përgjigjen e pyetësorit nr.***.

bashkëshorti im ka qenë i punësuar pranë PMU-së, MB, e provuara kjo me kontratat e punës dhe vendimin gjyqësor për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Sa më lart, shërbimi i kryer prej bashkëshortit tim ka qenë punë dytësore, ku sipas udhëzimit nr. 3, datë 11.2.2002, detyrimi në burim paguhej nga shoqëria që kryente pagesën”.

22.21 Subjekti citoi edhe përgjigjen nr. *** prot., datë 10.6.2022, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ku pretendoi se: *“Kjo përgjigje nuk është marrë në konsideratë si një e tërë në përmbajtje, por vetëm paragrafi i parë i saj, ku pasqyrohet mospagimi i tatimit në burim nga shoqëria, ndërsa paragrafi i dytë është anashkaluar duke rënduar pozitën time. Konkretisht, paragrafi i dytë thotë: ‘Sjellim në vëmendjen tuaj që për këto periudha deklarimi i tatimit në burim nuk kishte deklaratë tip dhe nuk është deklaruar elektronikisht, pagesat kryheshin jashtë sistemit tatimor’”.* Gjithashtu, subjekti i është drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k. dhe nuk ka marrë përgjigje dhe për këtë fakt edhe në analizë të shkresës së mësipërme subjekti pretendon pamundësinë objektive për të vërtetuar pagimin e tatimit në burim nga ana e shoqërisë, kjo referuar nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

22.22 Sa më sipër, subjekti kërkoi: *“Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shërbimi i sipërcituar si individ nga bashkëshorti im në vlerën 1.950.000, në shoqërinë ‘****’ sh.p.k., duhet të përfshihen në analizën financiare për vitet 2004 – 2007”.*

22.23 Në këtë mënyrë arsyeton dhe kërkon që të përfshihen në analizën financiare për vitet përkatëse të ardhurat nga shërbimet e kryera për shoqërinë “****” sh.p.k. në vlerat 960.000 lekë dhe 24.000 euro (pavarësisht mungesës së kontratës), shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe Xh.Sh, me të njëjtin arsyetim në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore, pasi duke qenë punë dytësore, detyrimet tatimore paguhen nga ai që kryen pagesën.

22.24 Subjekti, në shpjegimet e saj, sqaroi se: *“Në Kodin e Procedurës Civile për periudhën para shtatorit të vitit 2007 nuk kishte pengesë ligjore që çdo individ të përfaqësohte në gjykimin civil palët në proces. Vetëm pas vitit 2007 u bë e detyrueshme që në përfaqësimi në procesin civil të bëhej, ndër të tjera, edhe nga avokat i pajisur me certifikatë tatimore (NIPT). Me ndryshimet e bëra, detyrimet tatimore paguheshin nga subjektet që ofronin shërbime juridike. Ndërsa në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti im nga subjektet e sipërcituara për periudhën para vitit 2007, shpërblimi i tij ka qenë neto, pasi detyrimet tatimore janë paguar nga subjektet e sipërcituara”.*

22.25 Subjekti i kërkoi Komisionit që të konsiderojë periudhën 1.4.2000 – 31.3.2006 për bashkëshortin A.G si kohë që ka qenë i punësuar në marrëdhënie pune me projektin pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe për këtë periudhë për shpërblimet e tjera të përfituara të konsiderohen si individ natyror nga punë dytësore, të kryera jashtë qendrës së punës dhe se tatimi për këto shpërblime i takon atij që kryen pagesën.

22.26 Ndërsa për të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti i subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti pretendon se aktmarrëveshja e datës 1.10.1999 gjen gjerësisht bazueshmëri ligjore në dispozitat e Kodit Civil dhe konkretisht kontrata është kryer me shkresë të thjeshtë, është shprehur vullneti i të dyja palëve, objekti është i ligjshëm, si dhe përcaktimi i qartë i detyrimeve në mënyrë reciproke. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje mes bashkëshortit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. është parashikuar se *“diferenca e shumës prej 341.900 lekësh do t’i mbajë kjo shoqëri për shpenzimet e kryera gjatë procesit gjyqësor, si dhe shpenzime të tjera. Pra, detyrimet tatimore të kësaj shume janë në ngarkim të shoqërisë “****” sh.p.k., sipas aktmarrëveshjes dhe sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.*

Në kushtet dhe rrethanat kur është kryer ky shërbim nga ana e bashkëshortit, në aspektin e interpretimit dhe zbatimit të ligjit të mësipërm, ka pasur boshllëk ligjor, për arsye se në nenin

40 të tij është përcaktuar se ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji dhe përderisa ky ligj nuk është zbatuar deri në muajin shkurt të vitit 2003, kohë kur ka dalë udhëzimi i datës 11.2.2003, i miratuar nga MF, kjo nuk mund t'i penalizojë personat fizikë natyrorë dhe tregtarë për paaftësinë apo neglizhencën e treguar të administratës shtetërore, e cila nuk ka krijuar infrastrukturën e nevojshme që personat fizikë natyrorë të kishin mundësinë e pagesës së detyrimeve.

Në këto kushte, vlera e përfituar nga ana e bashkëshortit prej 1.500.000 lekësh duhet të përfshihet në analizën financiare si e ardhur e vitit 1999.

22.27 Komisioni pas shpjegimeve të subjektit, arsyetoi se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ka përcaktuar detyrimin e subjekteve për të paguar detyrimin tatimor për të ardhurat e përfituara. Pretendimi i subjektit për mungesë aktesh nënligjore dhe paaftësi të administratës shtetërore nuk e zhvesh nga detyrimi personin juridik, shoqërinë “****” sh.p.k., për përmbushjen e detyrimit tatimor, për më tepër kur këto pretendime të subjektit mbeten deklarative dhe nuk janë të vërtetuara nga institucionet kompetente ligjzbatuese. Prandaj edhe Komisioni vlerësoi se këto të ardhura të përfituara nga bashkëshorti i subjektit në vitin 1999 nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme, duke mos i përfshirë në analizën financiare.

22.28 Për sa i përket të ardhurave të pretenduara nga puna e bashkëshortit pranë shoqërisë “****” sh.p.k. për periudhën 2002 – 2007, subjekti solli si provë disa bordero të brendshme të shoqërisë, mandatpagesat dhe kërkesat për pagesë shpenzimesh gjyqësore drejtuar shoqërisë.

22.29 Subjekti, në përgjigjet e saj²², pretendoi në të njëjtën mënyrë si tek marrëdhënia me shoqërinë “****” sh.p.k. në lidhje me vërtetimin e pagesës së detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura të pretenduara për llogari të bashkëshortit A. G. Subjekti, për këtë marrëdhënie deklaroi, se bashkëshorti i saj është paguar 30.000 lekë në muaj dhe paraqet disa bordero të shoqërisë “****” sh.p.k., të cilat nuk janë në formën e kërkuar nga ligji (listëpagesa të cilat duhej të ishin dorëzuar pranë organeve tatimore). Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2022, si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2022, konfirmojnë se lidhur me shërbimet e kryera për shoqërinë “****”, me NIPT ***, nuk rezulton të kenë bërë ndonjë pagesë për tatimin në burim.

22.30 Ndodhur në këto kushte, edhe të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie me këtë shoqëri për vitet 2005 - 2007 nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme të subjektit dhe, si të tilla, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare, pasi subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara pranë shoqërisë “****” sh.p.k. në vlerat 960.000 lekë dhe 24.000 euro, sipas deklarimit në deklaratën *Vetting*.

22.31 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti ka sjellë kontratën e porosisë së datës 1.2.2008 dhe disa fatura tatimore, si dhe deklaroi se: “Bashkëshorti im ka kontratë porosie të datës 1.2.2008, si avokat dhe mbrojtës së interesave ligjore në organet e administratës shtetërore dhe ato gjyqësore për shoqërinë ‘****’ sh.p.k. nga data 1.2.2008 deri më sot. Kjo periudhë korrespondon me kohën kur bashkëshorti ishte i regjistruar si person fizik. Mënyra e pagesës së bashkëshortit pranë kësaj shoqërie është kryer në masën 50.000 lekë/muaj, pagesë neto kjo e cila është paguar cash dhe nëpërmjet bankës. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore të kërkuara prej jush, sqarojmë se kjo shoqëri ka pasur detyrimin për të paguar pagën neto, ndërsa për pagesat tatimore janë kryer nga bashkëshorti person fizik, fillimisht prej datës 1.2.2008 – 31.12.2013 pranë DPTTV,

²²Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. ***.

Bashkia Tiranë dhe prej vitit 2014 e në vijim pranë DRT-së Tiranë. Gjithashtu, sqaroj se me fillimin e aplikimit të skemës së TVSH-së, kjo e fundit është paguar prej shoqërisë, (shih mandat pagesat prej vitit 2014 e në vijim, ku përcaktohet përshkrimi shërbim avokatie, vlefëta pa TVSH 50.000 lekë, vlefëta e TVSH-së 10.000 lekë, në total 60.000 lekë, e cila është pasqyruar dhe në statement-in bankar)”

22.33 Ky shpjegim i bërë nga subjekti është në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Komisioni bëri pjesë të analizës financiare të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit në përputhje me deklaratimet e tij në organet tatimore, sipas vërtetimeve të disponuara.

22.34 Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti i subjektit nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti ka sjellë si provë aktmarrëveshjen me shkrim të datës 1.10.1999, vendimin e formës së prerë nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, prokurën e posaçme nr. ***, datë 5.11.1999 dhe vendimin për lëshim urdhër ekzekutimi nr. ***, datë 20.2.1998.

22.35 Subjekti²³ ka deklaruar se: “... është parashikuar që avokat A. G në përfundim të ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 19.9.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë pranë AKP-së Tiranë, do të përfitojë shumën prej 1.500.000 lekësh. Kjo shumë është marrë nga ana e bashkëshortit tim A. G në fund të muajit dhjetor të vitit 1999. Kjo shumë është neto, për shkak se detyrimet tatimore të shumës totale janë paguar nga kreditori, shoqëria “****” sh.p.k., sipas aktmarrëveshjes datë 1.10.1999, në të cilën është parashikuar se: ‘Diferenca e shumës prej 341.900 lekësh do t’i mbajë shoqëria “****” për shpenzimet e kryera gjatë procesit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera’. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore të kërkuara prej jush, sqarojmë se tatimi në burim i është mbajtur kësaj shoqërie bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, procedurë kjo që është ndjekur nga çdo institucion ose pages i të ardhurave për mbajtjen e tatimit në burim”.

22.36 Kjo aktmarrëveshje e nënshkruar ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit A. G nuk është një marrëveshje e njohur gjerësisht nga Kodi Civil, në kuptimin e objektit të saj, ku shprehimisht citohet: “Z. A.G merr përsipër të ekzekutojë vendimin gjyqësor nr. ***, datë 19.9.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku pala e paditur *** Lushnjë duhet t’i paguajë palës paditëse, shoqërisë “****” sh.p.k., shumën 3.341.900 lekë dhe në përfundim të ekzekutimit z. A. G do të marrë gjysmën e kësaj shume, atë prej 1.500.000 lekësh”. Komisioni nuk u ndal më tej, pavarësisht rezervave objektive mbi këtë lloj dokumenti të nënshkruar dhe pranuar nga palët.

22.37 Më tej, në këtë marrëveshje, thuhet se shoqëria “****” sh.p.k. do të paguajë të gjitha detyrimet tatimore që lidhen me këtë aktmarrëveshje. Subjekti më lart ka sqaruar se *diferenca e shumës prej 341.900 lekësh do t’i mbajë shoqëria “****” sh.p.k. për shpenzimet e kryera gjatë procesit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera*, ku nënvizon shprehjen e fundit, *si dhe shpenzimet e tjera*, për të nënkuptuar se detyrimi tatimor përfshihet tek shpenzimet e tjera.

22.38 Për të bërë pjesë të analizës shumën prej 1.500.000 lekësh, të pretenduar si të përfituar nga z. A. G nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 19.9.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Komisioni gjykon se deklarimi i subjektit lidhur me shprehjen në aktmarrëveshje *si dhe shpenzimet e tjera*, nuk përbën provë shteruese të pagesës së detyrimit tatimor nga shoqëria “****” sh.p.k.. Por, siç u sqarua më sipër, z. A.G, duke mos qenë i regjistruar në organet tatimore si avokat, edhe të ardhurat e tij nga shërbimi i avokatisë nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

²³Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. ***.

22.39 Lidhur me të ardhurat nga shoqëria “**”, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka sjellë një praktikë të përfitimit të një shume në masën 50% të shumës totale nga ana e kësaj shoqërie, ku kjo e fundit, me prokurën e përgjithshme nr. ***, datë 4.5.2005, emëron përfaqësues të posaçëm avokat A. G që ta përfaqësojë në zyrën e përmbarimit në ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë 22.9.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.**

22.40 Shuma e përfituar nga bashkëshorti i subjektit duket të ketë qenë 50% e vlerës 5.640.400 lekë = 2.800.000 lekë, sipas procesverbalit me shkrim dore të datës 27.12.2005, ndërmjet porositesit A. V dhe të porositurit avokat A. G. Kjo shumë prej 2.800.000 lekësh nuk mund të bëhet pjesë e analizës financiare të subjektit, pasi nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore.

22.41 Në lidhje me të ardhurat nga shoqëria “**” sh.p.k.** për vitet 2003 në vlerën totale 50.000 lekë dhe të ardhurat nga Xh.Sh për përfaqësim ligjor në vlerën 100.000 lekë (sipas dokumentacionit të sjellë bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorëve nr. *** dhe nr. ***), subjektit nuk mund t’i konsiderohen këto vlera financiare si burim i ligjshëm për shkak se nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura të pretenduara.

22.42 Ndërsa në lidhje me të ardhurat e pretenduara të përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti, në përgjigje të rezultateve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ka prapësuar se: *“Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti im nga shoqëria “****” (sipas një procesverbali me shkrim dore të datës 27.12.2005), në masën 50% të shumës totale nga dëmshpërblimi prej 5.640.400 lekësh, konkretisht shuma 2.800.000 lekë, kërkoj që kjo shumë të bëhet pjesë e analizës financiare për vitin 2005, duke qenë se është e provuar se është mbajtur 10% i tatimit të vlerës totale të dëmshpërblimit prej 6.156.000 lekësh dhe pikërisht vlera 615.600 lekë”.*

22.43 Subjekti këtë e argumenton me faktin se kjo shumë nuk mund të tatohej dy herë dhe se referuar nenit 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se *vendimet gjyqësore me objekt shpërblim dëmi janë të përjashtuar nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe për rastin konkret shuma e mbajtur nga organet tatimore është vetëm tatimi mbi të ardhurat e ndara nga bashkëshortit dhe shoqëria përkatëse.*

22.44 Në referim të ligjit të sipërcituar nga subjekti, *çdo e ardhur personale e përfituar i nënshtrohet detyrimit të pagimit të tatimit mbi këto të ardhura.*

22.45 Por, Komisioni, pas ballafaqimit edhe të ndryshimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në lidhje me argumentin që subjekti solli në shpjegimet e saj në lidhje me përjashtimin e vendimeve gjyqësore me objekt “shpërblim dëmi nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale”, konkludoi se ky ndryshim i ligjit nr. 8438/1998 i përket vitit 2012, ndërsa përfitimi i kësaj shume nga bashkëshorti i subjektit i përket vitit 2005.

22.46 Në këto kushte, Komisioni, edhe pas dëgjimit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në seancën dëgjimore të datës 30.9.2022, mbajti të njëjtin qëndrim si atë të bërë me dije subjektit në komunikimin e rezultateve të hetimit.

22.47 Shuma prej 2.800.000 lekësh nuk mund të bëhet pjesë e analizës financiare të subjektit, pasi nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore.

22.48 Për çështjet më sipër, trupi gjykues, në referim edhe të shpjegimeve të subjektit dhe të bashkëshortit, arsyeton si vijon:

- Në lidhje me mospagesën e detyrimit tatimor nga përfituesi i shërbimit sipas kontratave të shërbimit, bashkëshorti i subjektit prapësoi edhe në seancën dëgjimore të datës 30.9.2022, duke

thënë se: “Nuk e di dhe nuk ishte detyrim imi kjo pagesë dhe për këtë shkak nuk kam as informacion”. Gjithashtu, përsëri thekson se për vitet 1998 – 2003 nuk kishte akte nënligjore në zbatim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe, si e tillë (kjo situatë), e bënte të pamundur këtë pagesë pranë organeve tatimore dhe në vazhdimësi edhe në seancë prapësoi se këto ishin punë dytësore (duke ju referuar si marrëdhënie pune atë të PMU-së për vitet 2000 – 2006) dhe se kryente shërbime konsulente dhe jo aktivitet privat avokatie. Pra, subjekti e përjashtoi detyrimin qoftë nga palët përfituese të shërbimit të kryer nga ana e tij.

- Për sa i përket elementeve të një kontrate shërbimi/porosie, sipas Kodit Civil Shqiptar, ajo është një marrëveshje që lidhet mes palëve me kushtin e ofrimit të një shërbimi kundrejt një pagese të tatueshme, ku të përcaktohet shprehimisht në kontratë përgjegjësia tatimore, ku zakonisht kjo përgjegjësi i referohet kontraktuesit punëdhënës, ai që përfiton shërbimin. Në rastet kur avokatët e ofrojnë këtë shërbim, atyre u nevojitet që të jenë të pajisur me licencë profesionale dhe të ofrojnë shërbime juridike, konsulencia dhe përfaqësime, duke qenë të deklaruar nga përfituesi i shërbimit, e cila të jetë e provuar me kopje dokumentacioni nga organet tatimore që këto detyrime janë paguar. Kjo mbështetur edhe në pikën 2, të nenit 35, të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku citohet: “*Paguesi i këtyre shumave duhet të nxjerrë pagesat e përfitimeve dhe mbajtjen në burim të tatimeve dhe t’ia vërë në dispozicion organeve tatimore, si dhe personit për të cilin është bërë pagesa, regjistrimet përkatëse*”. Pra, nga kjo dispozitë kuptohet se individi ofrues i shërbimit vihet në dijeni sipas ligjit për kryerjen e pagesës së detyrimit tatimor për llogari të tij nga agjenti tatimor, përfitues i shërbimit. Në këtë rast, ofruesi i shërbimit individ me profesion avokat nuk ka nevojë të jetë i regjistruar. Ndërsa, kur ky shërbim ofrohet në cilësinë e avokatit, i cili lidh kontratë shërbimi/porosie, ai patjetër duhet të jetë i regjistruar pranë organeve tatimore dhe të jetë i pajisur me NIPT. Për shërbimin e ofruar, avokati lëshon faturë dhe e depoziton pranë organeve tatimore, duke paguar edhe detyrimet përkatëse. Vetëm kështu aktiviteti i tij privat konsiderohet i ligjshëm. Në bazë të ligjit, detyrimin për derdhjen e këtij tatimi në shtet e ka përfituesi i shërbimit, por, njëkohësisht, ai ka detyrimin për ta vënë në dijeni ofruesin e shërbimit për pagesën e tatimit. Kështu që ai nuk mund të pretendojë mosdijeninë e këtij fakti apo shmangien e detyrimit të tij për pagesën e tatimit.

Për çështjet më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga këto angazhime private të bashkëshortit të saj, sipas përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

22.49 Në lidhje me të ardhurat nga administrimi i pronave të familjes M, subjekti ka sjellë si provë prokurën e përgjithshme të datës 4.7.2001, vendimin nr. ***, datë 19.4.1996, të KKK Pronave, disa kontrata qiraje për një nga tri pronat e kësaj familjeje dhe urdhërpagesat në banka të ndryshme për likuidimet e qirave për llogari të z. A.G.

22.50 Bashkëshorti i subjektit nuk deklaroi në deklaratën *Vetting* vlerën e të ardhurave të përfituara nga administrimi i pronave të familjes M, sipas prokurës të vitit 2001.

22.51 Komisioni, gjatë hetimit nga informacioni bankar, evidentoi shumë veprime bankare, veçanërisht në “Raiffeisen Bank” në llogarinë nr. ***, ku ishin kryer disa depozitime *cash* nga shtetasi A.H dhe jo vetëm. Këto veprime ishin bërë në data të ndryshme në dollarë.

22.52 Subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në lidhje me këto transaksione dhe lidhjen apo marrëdhënien me shtetasin A.H, e cila, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka sqaruar se: “Z. A. H është banor i qytetit të Vlorës, i biri i N.J.H dhe V. H, njëkohësisht dhe vëllai i E.H. Këta persona kanë pasur biznes familjar me personin fizik ‘V.H’, e cila është dhe qiramarrëse e këtij

lokali me objekt veprimtarie “pastiçeri byrektore”, aktivitet të cilin e kanë ushtruar para vitit 2001 në lokalin në pronësi të trashëgimtarëve të M dhe S.M.

Me pajisjen e bashkëshortit tim, av. A. G, me prokurën e përgjithshme të datës 4.7.2001, të noterisë A. I, nga familja M, ka vijuar kontrata e qirasë së këtij lokali, i cili ndodhet në bulevardin kryesor përballë ish-mapos dykatëshe, dikur Arka e Kursimit Vlorë, me sipërfaqe 118 m².

Kjo kontratë ka vijuar ndër vite deri në vitin 2016. Kontratat kanë qenë identike dhe me çmim të qirasë mujore 500 USD. Këto pagesa të qirasë mujore janë kryer nga z. A. H.

Në kontratë është parashikuar që ‘qiramarrësja merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet, si faturat e ujit, të energjisë elektrike, si dhe të gjitha taksat lokale e qendrore që lidhen me lokalin objekt kontrate. Në vitin 2013 kontrata e qirasë ka vijuar me djalin tjetër të V. H, E. H (vëllai i A. H) me të njëjtat kushte.

Për të vërtetuar posedimin e këtij lokali nga familja H mund të verifikohet pranë shoqërisë ‘OSHEE Group’, dega Vlorë, nr. *** Kulla, si dhe kontrata e furnizimit me ujë nga Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë, me nr. ***, adresa: lagjja ‘***’, Vlorë, me nr. klienti ***, nr. kontrate ***”.

22.53 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka dhënë shpjegime edhe për disa transaksione me pjesëtarë të tjerë të familjes M, ku sqaroi se: “Shtetasja R.E (G) D është trashëgimtare ligjore e vetme e nënës së saj E. G (M), e cila në bazë të dëshmisë së trashëgimisë është trashëgimtare ligjore e M. M dhe e D e Z.M. Znj. E.M ka qenë një ndër trashëgimtarët që ka dhënë prokurë të përgjithshme bashkëshortit tim, av. A. G, në datën 4.7.2001, ku pas vdekjes së saj nga ana e trashëgimtares së vetme R.E.G (D) i është dhënë prokurë e përgjithshme, av. A.G. Në lidhje me transaksionet sqarojmë se ato janë si rrjedhim i të ardhurave të përfituara nga qiratë mujore të pronave të familjes M, prona të cilat janë një godinë trekatëshe në qendër të qytetit Vlorë, pranë ***, dhënë me qira shoqërisë ‘***’ sh.p.k., me ortak dhe administrator z. Z. Z, e cila përdoret si shkollë, si dhe një dyqan që ndodhet në bulevardin kryesor përballë ish-mapos dykatëshe, dikur Arka e Kursimit Vlorë, me sipërfaqe 118 m². Aktualisht ky dyqan i është dhënë me qira shoqërisë ‘***’ e provuar kjo me kontratën e qirasë datë 1.12.2019 dhe aneks-kontratës datë 1.8.2020, të lidhur midis kësaj të fundit dhe me bashkëshortin tim si administrator i pronave të familjes M, me vlerë qiraje 400 USD neto. Sipas kontratës së qirasë dhe aneks-kontratës është parashikuar se qiramarrësi ka marrë përsipër të paguajë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga konsumi i ujit, i energjisë elektrike, si dhe të gjitha taksat lokale e qendrore që lidhen me lokalin objekt kontrate.

Në lidhje me shtetasin M.XH.M, sqaroi se ky shtetas është trashëgimtar ligjor i Xh.M dhe është një ndër bashkëpronarët e pronave të cituara më lart, të cilat administrohen nga av. A. G (shihni prokurën e përgjithshme datë 4.7.2001, të noterit Y. B të A. I). Transaksionet për të cilat ju pyesni janë kalimet e një pjese të të ardhurave nga qiratë si rezultat i të ardhurave nga administrimi i pronave të familjes M nga bashkëshorti im av. A G. Këto transaksione janë pjesore, në kohë të ndryshme sipas pjesëve takuese”.

22.54 Referuar të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga administrimi i pronave të familjes M, bashkëshorti nuk solli kontratë shërbimi apo porosie nga ana e të përfaqësuarve me prokurë, ku të mund të përcaktohej masa e shpërblimit për punën si avokat, tarifa e shprehur në lekë ose në përqindje për shërbimet e kryera.

22.55 Ndërsa në lidhje me transaksionet bankare nga llogaritë e bashkëshortit në dobi të trashëgimtarëve të familjes M, subjekti nuk sqaroi në mënyrë shteruese se sa është vlera e qirasë së dhënë trashëgimtarëve të familjes dhe sa është shpërblimi nga dhënia e shërbimit të avokatisë

dhe administrimi i pronave që ai duhet të mbajë nga këto vlera monetare të derdhura në llogaritë e tij bankare.

22.56 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. *** në lidhje me transaksionet dhe kalimet në llogari bankare të bashkëshortit të saj, shprehet se: *“Transaksionet për të cilat ju pyesni janë kalimet e një pjese të të ardhurave nga qiratë si rezultat i të ardhurave nga administrimi i pronave të familjes M nga bashkëshorti im, av. A. G. Këto transaksione janë pjesore, në kohë të ndryshme sipas pjesëve takuese”*. Subjekti ka shpjeguar në mënyrë të përciptë dhe të paqartë për vlerat reale të cilat i takojnë bashkëshortit të saj në cilësinë e avokatit.

22.57 Me këtë përgjigje subjekti nuk shpjegoi vlerën apo tarifën shpërblyese për shërbimin e kryer për administrimin e pronave të familjes M, dhe sa është vlera monetare e përfituar sipas viteve përkatëse që nga dhënia e prokurës së përgjithshme të datës 4.7.2001 të noterisë A. I nga familja M, bashkëshortit të subjektit av. A. G dhe deri në vitin 2016.

22.58 Komisioni arsyetoi se duhet të bëjë pjesë të analizës financiare vlerat monetare të kaluara nëpërmjet transfertave bankare në emër të bashkëshortit të subjektit, av. A.G, sipas dokumentacionit provues që Komisioni disponon. Por përpara se ta bëjë këtë i kërkoi subjektit edhe një herë të paraqiste një kontratë shërbimi apo aktmarrëveshje ndërmjet bashkëshortit të saj dhe familjes M, të përfaqësuar me prokurën e vitit 2001, ku të përcaktohet masa e shpërblimit për punën si avokat, tarifa e shprehur në lekë ose në përqindje për shërbimet e kryera nga bashkëshorti në dobi të familjes M, si dhe fatura për shërbimet e kryera sipas prokurës në fjalë për të gjithë periudhën e përfaqësimit të familjes M. Gjithashtu, iu kërkua të deklaronte dhe të vërtetonte me dokumentacion se sa është vlera monetare e përfituar sipas viteve përkatëse që nga dhënia e prokurës së përgjithshme të datës 4.7.2001 bashkëshortit, av. A. G dhe deri në vitin 2016.

22.59 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, deklaroi se: *“Ndërmjet bashkëshortit tim A.G dhe familjes M nuk ka pasur kontratë shërbimi ose aktmarrëveshje të veçantë me shkrim, përveç prokurës së përgjithshme datë 4.7.2001, e cila ka luajtur dhe rolin e marrëveshjes (më hollësisht shihni pikat 1, 2, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 19 dhe 29 të prokurës).*

Në lidhje me shpërblimin e punës dhe përqindjes së bashkëshortit tim për administrimin e pronave të familjes M, do të përcaktohet pas rakordimit përfundimtar, ku do të ndahet shërbimi i avokatisë nga ai administrimi, që do të thotë shpërblimi si person fizik (avokat) dhe shpërblimi si person fizik natyral për administrimin duke zbritur dhe shpenzimet e kryera, për sa i përket administrimit. Bashkëshorti im A.G nuk ka fatura për shërbimet e kryera si avokat, pasi është marrë kryesisht me administrimin e pronave”.

22.60 Ndërsa në lidhje me vlerat monetare të përfituara nga administrimi i pronave të familjes M nga dhënia me qira e pronave të tyre që prej datës 15.9.2000 deri më 31.12.2016, subjekti paraqiti në formë tabelare sipas viteve shumat: nga kontrata qiraje shkolla, shoqëria “****” sh.p.k., Z.Z (nga 15.9.2000 deri më 31.12.2006), gjithsej 445.975 USD; nga dyqani, kontratë qiraje V.H (nga 1.1.2002 deri më 31.12.2016), gjithsej 89.400 USD; si dhe nga transfertat nga trashëgimtarët e familjes M (15.8.2007 – 30.6.2015), gjithsej **246.000 USD**.

22.61 Po të bëhet diferenca mes vlerave që pranon të ketë marrë bashkëshorti i subjektit nga familja M për periudhën 2000 – 2016 (535.375 USD = 445.975 + 89.400) dhe vlerave të transferuara tek kjo familje (246.000 USD), rezulton se nga kjo marrëdhënie ai ka mbajtur duke shtuar në pasurinë e tij personale një vlerë totale prej 289.375 USD (535.375 USDD – 246.000 USD = 289.375 USD).

22.62 Subjekti, në asnjë deklaratë periodike dhe as në deklaratën *Vetting*, nuk deklaroi ndonjë detyrim për t'i kthyer familjes M vlera monetare që ju takojnë nga të ardhurat e administrimit të pronave të tyre.

22.63 Subjekti, për sa i përket dokumentacionit për këto vlera monetare, sqaron se ka paraqitur edhe prova shtesë²⁴, të cilat Komisioni, pasi i studioi, nuk mori përgjigje për mënyrën dhe sasinë monetare të përfituar nga përfaqësimi dhe administrimi i pronave të familjes M nga ana e bashkëshortit të saj.

22.64 Ndërsa, për të parë ligjshmërinë e krijimit të këtyre vlerave monetare, Komisioni kreu një analizë si vijon:

- Bashkëshorti i subjektit A. G është pajisur me një prokurë të përgjithshme në vitin 2001 nga trashëgimtarët e familjes M me 30 pika apo tagra të listuara, ku avokati A. G merrte përsipër përfaqësimin dhe administrimin e këtyre pronave (shihni më lart vendndodhjen e tyre) në qytetin e Vlorës. Pavarësisht këtyre tagrave me fushë të gjerë veprimi të listuara në prokurë, siç u vërejt më lart, av. A.G nuk dispononte një marrëveshje, kontratë apo çdo lloj akti tjetër ligjor ku të përcaktohej fitimi i tij në lekë apo në përqindje. Në këto kushte, Komisioni, duke parë vlera të konsiderueshme parash në llogaritë e tij bankare dhe të deklaruara në DPV, deklaratën *Vetting*, si dhe në përgjigjet e pyetësorëve, dhe duke mos pasur të qartë pjesën takuese të tij si avokat, mori në konsideratë punën e tij si avokat dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore me qëllim vlerësimin sa më të saktë të mundësisë së tij të krijimit të të ardhurave.

- Për periudhën para regjistrimit të z. A. G si person fizik pranë organeve tatimore, Komisioni nuk konsideroi të ardhura të ligjshme, të ardhurat e siguruara nga administrimi i pronave të familjes M në cilësinë e përfaqësuesit ligjor.

- Për periudhën pas regjistrimit të z. A. G si person fizik pranë organeve tatimore, Komisioni konsideroi si të ardhura të ligjshme ato të ardhura të vërtetuara nga organet tatimore.

- Z. A. G është certifikuar si avokat në qershor të vitit 1997, por lejen e ushtrimit të profesionit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë e ka marrë në dhjetor të vitit 1999. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka sjellë vendime gjyqësore të viteve 1998 e në vijim, për të provuar faktin se ai ka përfaqësuar dhe mbrojtur palë në gjykata. Por, nga studimi i dokumentacionit pranë Komisionit rezultoi se z. A.G është regjistruar pranë organeve tatimore në shtator të vitit 2007, çka do të thotë që deri në atë vit ai nuk deklaroi xhiro/fitim në shtet. Sipas tagrave të prokurës, z. A. G ka kryer veprimtari në cilësinë e avokatit nga Dhoma e Avokatisë Tiranë, pa qenë i regjistruar në organet tatimore.

22.65 Sipas nenit D të Aneksit Kushtetues që ka të bëjë me rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, parashikohet se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të krijuara. Të ardhura të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Në këtë drejtim, subjektet kanë detyrim për vete dhe për personat e lidhur, siç është rasti konkret, ku bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit avokat ka detyrimin e deklarimit dhe dhënies së informacionit të saktë për të justifikuar krijimin e të ardhurave, si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për to.

²⁴Shihni provat e paraqitura bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit nr. ***: letër personale drejtuar z. A. G datë 17.11.2011, e E.G, bashkëshorti i E.G (M), babai i R.D; procesverbal i datës 15.7.2010, i mbajtur midis A. G dhe Z. Z; deklaratë e datës 20.11.2009, e Z.Z, me cilësinë e administratorit të shoqërisë "****" sh.p.k.; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.1.2012, e DRT-së Vlorë; mandatarëkëtim i viteve 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007 (7 copë); kontratë qiraje datë 3.1.2002, e lidhur midis A.G dhe V.H; kontratat e qirasë nga data 3.1.2003 deri në vitin 2016 dhe kërkesë për transfertë fondesh e "Raiffeisen Bank" (9 fletë).

22.66 Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji bazë mbi të cilin rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat për tri kategoritë: (i) tatimin mbi të ardhurat personale; (ii) tatimin mbi fitimin; dhe (iii) tatimin e mbajtur në burim të të ardhurave. Detyrimi tatimor lind kur individ i realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kur kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit sipas legjislacionit në fuqi. Referuar ligjit “Për taksat e tarifave vendore” si dhe ligjit “Për procedurat tatimore”, përcaktohet si detyrim pagimi i taksës së qarkullimit dhe detyrimi i taksimit mbi fitimin, kjo në varësi të xhiros së parashikuar dhe të deklaruar. Në rastin konkret, bashkëshorti i subjektit A.G nuk ka përmbushur këto detyrime, përderisa nuk e ka regjistruar aktivitetin e tij pranë organeve tatimore dhe, për pasojë, nuk ka paguar detyrimet tatimore deri në vitin 2007.

22.67 Për të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga administrimi pronave të familjes M sipas prokurës së përgjithshme datë 4.7.2001, të deklaruar pa vlerë në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor krijimin e tyre dhe pagesën e detyrimit tatimor përkatës.

22.68 Referuar këtij konkluzioni, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

22.69 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, shpjegoi se: *“Nuk ka marrëveshje me shkrim ndërmjet bashkëshortit dhe familjes M, si dhe ai nuk ka kryer shërbime avokatie dhe, për rrjedhojë, nuk ka faturuar shërbime. Puna e tij ka qenë kryesisht administrim në këtë marrëdhënie, ai duhet të trajtohet si individ natyral dhe jo si avokat, pasi administrimi i pronave mund të bëhet nga çdo individ që nuk është domosdoshmëri që të jetë avokat.*

Llogaritë dhe depozitat që janë krijuar nga ky administrim janë likuiditete në llogaritë bankare si individ A. G dhe jo si person fizik ‘A. G.

Meqenëse nuk është përfunduar kontrata e porosisë, shumat e vjela të qirave të pronave të familjes M janë në bankë, pra janë likuiditete dhe rezulton se bashkëshorti im nuk ka shtuar pasuri me to dhe në këto kushte nuk duhet të përfshihen në AF”.

22.70 Subjekti sqaroi se: *“Sipas tagrave të prokurës së vitit 2001 ka kryer administrimin deri më sot të këtyre pronave. Sjell si dokumentacion provues korrespondencat me R.D (trashëgimtare e familjes M) nga viti 2001 deri në vitin 2008, konferma zyrtare, situacione ndërtimesh (vitet 2000 dhe 2001).*

Për sa i përket një pjese të të ardhurave të administrimit të pronave të familjes M, të cilat gjenden në llogarinë bankare në emër të bashkëshortit tim me burim nga qiratë e pasurive janë, ndër të tjera, edhe për arsye të mosmarrëveshjeve midis bashkëpronarëve për vlera të papaguara para administrimit nga bashkëshorti im dhe pretendime për pronësinë e katit të tretë të godinës me destinacion, shkollë e cila është në proces legalizimi.

*Marrëdhënia e bashkëshortit tim me familjen M konfirmohet edhe nga deklarata noteriale datë 8.9.2022 nga një prej bashkëpronarëve të familjes R. D, e hartuar në A, I me nr. *** serie. Në këtë deklaratë, ndër të tjera, ajo thotë: ‘...gjatë gjithë kësaj periudhe që nga viti 2001 e deri tani ndërmjet A. G dhe pjesëtarëve të familjes M nuk ka pasur një kontratë me shkrim të veçantë. Përfaqësimi dhe administrimi i pronave është kryer prej tij vetëm mbi prokurën e përgjithshme të datës 4.7.2000 dhe më pas në prokurën e përgjithshme të datës 22.10.2010. Nga ana jonë janë marrë në rrugë bankare ose kur vijmë me pushime në Shqipëri një pjesë e të ardhurave nga qiratë e pronave. A. G thjesht administron në llogaritë e tij të ardhurat e ligjshme të përfituara nga administrimi i pronave tona. Deklaroj se ne nuk kemi lidhur ndonjëherë kontratë për përfitim prej z. A. G të ndonjë të ardhure, por vlerësimi i miqësisë, përkushtimit dhe ndershmërisë së tij lidhur me administrimin e këtyre pronave do të*

shpërblehet në një vlerë neto, pas rakordimit përfundimtar, duke zbritur shpenzimet e kryera për investimet e bëra në të dyja pronat, shpenzimet për legalizimin e katit të tretë, si dhe shpenzimet e tjera, taksat vendore mbi pasurinë, tatimin në burim të të ardhurave dhe detyrime të tjera që lidhen me këtë administrim që mund të jenë të prapambetura apo do të lindin në të ardhmen....”.

22.71 Në këto kushte, subjekti kundërshtoi konkluzionin e Komisionit dhe deklaroi se: *“Para vitit 2007, në vitin 2000 deri në vitin 2006 bashkëshorti ka qenë i punësuar tek PMU, MB, ndërsa nga viti 2006 deri në vitin 2007 pranë ‘***’ sh.p.k. dhe pas këtij viti të gjitha shërbimet që ka kryer, përfshirë edhe administrimin e pronave të familjes M, kanë qenë punë dytësore.*

Ndërsa për vitet 2007 – 2016 Komisioni, në mënyrë të padrejtë, ka bashkuar të ardhurat nga puna si avokat me taksë fikse për fashën 3-4 milionë me të ardhurat nga qiratë e familjes M, duke nxjerrë për këtë periudhë pamundësi financiare.

Si përfundim, të gjitha të ardhurat nga administrimi i pronave të familjes M që nga viti 2001 e në vazhdim janë të ardhura të ligjshme, pasi janë të ardhura të identifikuar, është paguar tatimi në burim nga ana e qiramarrësve, janë të deklaruara, pasi ndodhen në llogari bankare, nuk kanë lidhje me punën si avokat, por si individ (shihni shpjegimet pranë PMU-së, MB)”.

22.72 Subjekti, në përfundim, kërkoi që këto të ardhura të mos llogariten nga puna si avokat dhe të korrigjohet AF.

Vlerësimi i Komisionit pas shpjegimeve përfundimtare të subjektit

22.73 Subjekti dhe bashkëshorti i saj, në përmbushje të detyrimit të plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë pranë ILDKPKI-së, kanë deklaruar si pasuri vlera monetare në disa llogari dhe depozita bankare me burim nga profesioni avokat i bashkëshortit, si dhe nga administrimi i pronave të familjes M.

22.74 Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar si pasuri disa llogari dhe depozita bankare me burim nga avokatia, të cilat kapin një vlerë të konsiderueshme, ndërsa te përshkrimi i të ardhurave, ndër të tjera, deklaron të ardhura nga administrimi i pronave të familjes M sipas prokurës së vitit 2001, të cilat i deklaron pa vlerë.

22.75 Në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar asnjëherë detyrime ndaj të tretëve.

22.76 Ashtu siç edhe subjekti arsyeton në shpjegimet e veta në lidhje me elementet e një kontrate porosie, prokura e përgjithshme e vitit 2001, që familja M i ka dhënë z. A. G nuk mund të shihet si kontratë porosie. Mungesa e një kontrate ndërmjet familjes M dhe z. A.G lë të papërcaktuar pjesët takuese të bashkëpronarëve të familjes M dhe fitimin e z. A. G.

22.77 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka sqaruar se: *“Në lidhje me shpërblimin e punës dhe përqindjes së bashkëshortit tim për administrimin e pronave të familjes M do të përcaktohet pas rakordimit përfundimtar, ku do të ndahet shërbimi i avokatisë nga ai administrimi, që do të thotë shpërblimi si person fizik (avokat) dhe shpërblimi si person fizik natyral për administrimin duke zbritur dhe shpenzimet e kryera për sa i përket administrimit. Bashkëshorti im A. G nuk ka fatura për shërbimet e kryera si avokat, pasi është marrë kryesisht me administrimin e pronave”.* Ndërkohë që, në shpjegimet përfundimtare kërkon që këto të ardhura të përfituara të mos llogariten nga puna si avokat, si dhe të korrigjohet analiza financiare.

22.78 Për periudhën para regjistrimit si person fizik në organet tatimore (deri në shtator të vitit 2007) të bashkëshortit të subjektit, Komisioni nuk ka konsideruar të ardhura të ligjshme të ardhurat e siguruara nga administrimi i pronave të familjes M, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa pas regjistrimit (shtator 2007 e në vazhdim) bashkëshortit të subjektit i janë llogaritur si të ardhura të ligjshme ato të ardhura, të cilat përfshihen brenda fashës së pagesës së detyrimeve si person fizik “A.G”. E thënë me fjalë të tjera, me qëllim vlerësimin sa më të saktë të mundësisë së bashkëshortit të subjektit për të krijuar të ardhura, Komisioni mori në konsideratë punën e tij si avokat dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore nga viti 2007 e në vazhdim, duke llogaritur si të ardhura të ligjshme të ardhurat e përfituara brenda xhiros së deklaruar e realizuar për këto vite (2007 e në vazhdim).

22.79 Ndërsa, për të ardhurat në llogaritë dhe depozitat bankare të bashkëshortit të subjektit (likuiditeteve nga administrimi i pronave të familjes M), subjekti ka pretenduar se *puna e bashkëshortit të saj ka qenë kryesisht administrim në këtë marrëdhënie, ai duhet të trajtohet si individ natyral dhe jo si avokat, si dhe meqenëse nuk është përfunduar kontrata e porosisë, shumat e vjela të qirave të pronave të familjes M janë në bankë, pra janë likuiditete dhe rezulton se bashkëshorti i saj nuk ka shtuar pasuri me to dhe, në këto kushte, nuk duhet të përfshihen në AF*, Komisioni vlerësoi se subjekti dhe bashkëshorti janë mbështetur vetëm në kuadrin deklarativ, por nuk kanë përmbushur detyrimin sipas ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin e pasurive ...”, ku deklarimi i këtyre likuiditeteve (të parakorduara përfundimisht) të bëhej në përputhje me dispozitat detyruese të tij.

22.80 Këto likuiditete në llogari dhe depozita nga administrimi i pronave të familjes M janë të shpërndara në disa llogari bankare dhe ndarja e tyre nga të ardhurat e tjera të bashkëshortit të subjektit është pothuajse e pamundur. Subjekti ka deklaruar²⁵: *“Shpërblimi i punës dhe përqindjes së bashkëshortit tim për administrimin e pronave të familjes M do të përcaktohet pas rakordimit përfundimtar, ku do të ndahet shërbimi i avokatisë nga ai administrimi, që do të thotë shpërblimi si person fizik (avokat) dhe shpërblimi si person fizik natyral për administrimin, duke zbritur dhe shpenzimet e kryera për sa i përket administrimit”*. Pra, subjekti është kontradiktor për situatën e krijuar, kjo për shkak të detyrimit thelbësor që përcakton neni D i Aneksit Kushtetues, i cili shprehimisht thotë: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”*.

22.81 Subjekti, kështu, gjendet në kushte të një deklarimi të paplotë e të mangët për pasuritë në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të saj. Ndërsa, referuar neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, *objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij*, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e një deklarimi të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë likuiditete bankare në emër të bashkëshortit të saj.

22.82 Gjithashtu, ky shërbim dhe administrim i kryer ndër vite nga bashkëshorti i subjektit është një shërbim i pashoqëruar me faturë tatimore, ku dhe vetë subjekti pranon se: *“Bashkëshorti im A.G nuk ka fatura për shërbimet e kryera si avokat, pasi është marrë kryesisht me administrimin e pronave”*. Evidentohet si përfundim se, bashkëshorti i subjektit, gjithsesi, në këtë marrëdhënie shërbimi dhe administrimi me familjen M, edhe në mënyrë hipotetike, po të ishte e sqaruar tashmë pozita dhe roli i bashkëshortit në këtë marrëdhënie, prapëseprapë do të kishte të bënin me një veprim (kontratë apo marrëveshje), që pason ofrimin e shërbimit nga

²⁵Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. ***.

bashkëshorti i subjektit në bazë të prokurës së vitit 2001 (moment kohor i mëparshëm) dhe mënyra e shpërndarjes së fitimit nuk do të shuante detyrimin ligjor të bashkëshortit të subjektit për të faturuar shërbimin e ofruar në të shkuarën dhe detyrimin e subjektit për ta deklaruar atë ndër vite.

22.83 Komisioni doli në përfundimin se çdo shërbim i bashkëshortit në këtë marrëdhënie shërbimi dhe administrimi me familjen M do të duhej të shoqërohej me faturë tatimore.

22.84 Subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, të provonte me dokumentacion justifikues ligjor vlerën e këtyre likuiditeteve në emër të bashkëshortit të saj dhe pagesën e detyrimit tatimor përkatës.

22.85 Subjekti dhe bashkëshorti kanë bërë deklaram të pasaktë me qëllim fshehjen e vlerave reale të përfituara nga shërbimi dhe administrimi i pronave të familjes M.

Trupi gjykues arriti në konkluzionin se pasuritë e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike nga bashkëshorti i subjektit, si llogari dhe depozita bankare me burim nga avokatia dhe nga administrimi i pronave të familjes M, janë pasuri të krijuara me të ardhura për të cilat bashkëshorti i subjektit nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor përkatësinë dhe ndarjen e tyre dhe, si të tilla, ato vlerësohen se janë pasuri të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Analiza financiare

23. Analiza financiare është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë përfshin periudhën dhjetor 1993 – 2002, meqenëse subjekti ka filluar ushtrimin e funksionit si gjyqtare që në vitin 1993; pjesa e dytë përfshin periudhën 2003 – 2016, kur ajo është subjekt deklarues.

23.1 Nga analiza financiare e periudhës dhjetor 1993 – 2002, subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamundësi financiare totale prej 7,025,386 lekësh.

23.2 Nga analiza financiare e periudhës 2003 – 2016, subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamundësi financiare totale prej 36,087,134 lekësh.

23.3 Në total, pamundësia financiare e subjektit dhe familjes së saj për periudhën dhjetor 1993 – 2016, arrin vlerën 43.112.520 lekë.

23.4 Në përfundim të analizës së përgjithshme të pasurisë subjektit të rivlerësimit iu la barrë prove për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

23.5 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti sqaroi se: *“Pamundësia financiare e familjes time për periudhën 1993 – 2016, në vlerën 43.112.520 lekë, e nxjerrë nga ana e Komisionit, nuk është reale për arsye se po të kemi një rillogaritje sipas analizës që ne kemi parashtruar më lart, do të rezultojë që unë dhe familja ime jemi balancë pozitive dhe kemi mjaftueshmëri financiare”*.

23.6 Komisioni hartoi sërish analizën financiare pas përgjigjeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit, paraqitur në tabelat si vijon:

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ARJANA P. GUMBARDHI (CACO) - Dhjetor 1993 - 2002											
PERSHKRIMI	Dhjetor 1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	TOTAL
PASURI	1,057	0	0	0	1,200,000	1,265,027	1,135,461	1,780,629	1,476,285	1,527,219	1,686,097
Apartament banimi 39.7 m2, Rr.***, TR - 1993/2005	1057										1,057
Shtese anesore e apartamentit Rr.***, TR - 68 m2 - 2000								1,685,040			1,685,040
Apartament 54 m2 Rr.*** Vlore - 1994 - A. G.											0
Ndryshim ne likuiditet				0	1,200,000	1,265,027	1,135,461	95,589	1,476,285	1,527,219	
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,057	0	0	0	1,200,000	1,265,027	1,135,461	1,780,629	1,476,285	1,527,219	1,686,097
TE ARDHURA dokumentuar	9,000	285,117	369,868	250,464	183,829	352,501	400,833	727,855	954,046	992,384	4,525,897
Te ardhura nga paga subjekti Arjana Gumbardhi	4,500	143,517	206,102	147,994	183,829	352,501	400,833	429,550	468,168	506,506	2,843,500
Te ardhura nga puna A. G.	4,500	141,600	163,766	102,470							412,336
Te ardhura nga aktiviteti privat A. G.					0	0	0	298,305	485,878	485,878	1,270,062
SHPENZIME	2,700	85,535	110,960	75,139	171,327	352,651	364,550	432,000	553,728	728,574	2,877,164
Shpenzime jetese	2,700	85,535	110,960	75,139	121,327	232,651	264,550	432,000	403,728	375,456	2,104,046
Shpenzime arsimimi femijet										193,118	193,118
Shpenzime mobilimi									150,000	160,000	310,000
Shpenzime qiraje Tirane					50,000	120,000	100,000				270,000
Analiza dokumentuar	5,243	199,582	258,908	175,325	-1,187,498	-1,265,177	-1,099,178	-1,484,774	-1,075,966	-1,263,409	-6,736,944
Pamundesi financiare dhjetor 1993 - 2002											-6,736,944

Nga analiza financiare e periudhës dhjetor 1993 – 2002, subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamundësi financiare totale prej 6,736,944 lekësh.

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ARJANA P. GUMBARDHI (CACO) - 2003 - 2016															
PERSHKRIMI	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	2,369,204	1,780,514	1,308,182	-546,997	-2,208,935	6,095,423	8,489,151	3,058,840	4,241,732	3,042,469	4,894,200	7,956,691	416,615	-1,739,337	2,911,160
Apartament banimi 39.7 m2, Rr.***, Tirane - 1993/2005 - 100% - A.+ A. G.			100,000												100,000
Shtese anesore e apartamentit Rr. ***,TR - 68 m2 - 2000 - 50% - A. Caco															0
Shtepi banimi 191 m2, Rr. ***, Tirane - 2011 - 50% - A. Caco															0
Truall i baneses ne Rr. *** - 880 m2 - 2011 - 25% - A. Caco															0
Apartament 54 m2 Rr. ***, Vlore - 1994 - A. G. - 25%															0
Shtese kati 70 m2 e apartamentit mbi banesen ***, Vlore											2,211,160				2,211,160
Moçal 20,000 m2, Tale Lezhe - 2013 - A. G. - 50% - 2,500,000 leke															0
Truall 6,000 m2 Vlore - A. G. - 2%															0
Truall 3,590 m2 Vlore - A. G. - 2%															0
Truall 1,200 m2 Vlore - A. G. - 2%															0
Truall 8,399 m2 Vlore - A. G. - 2%															0
Truall 1,350 m2 Vlore - A. G. - 2%															0
Automjet Benz *** - 2004 - 50%		250,000													250,000
Automjet Benz - *** - 350,000 leke - 2006				350,000											350,000
Ndryshim ne likuiditet	2,369,204	1,530,514	1,208,182	-896,997	-2,208,935	6,095,423	8,489,151	3,058,840	4,241,732	3,042,469	2,683,040	7,956,691	416,615	-1,739,337	
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	2,369,204	1,780,514	1,308,182	-546,997	-2,208,935	6,095,423	8,489,151	3,058,840	4,241,732	3,042,469	4,894,200	7,956,691	416,615	-1,739,337	2,911,160
TE ARDHURA dokumentuar	1,126,800	1,271,093	1,331,584	969,174	1,723,151	2,418,008	1,776,599	2,642,941	2,670,702	2,690,248	2,694,300	2,135,996	3,828,301	2,409,054	29,687,952
Te ardhura nga paga subjekti Arjana Gumbardhi	605,088	760,361	773,602	813,491	789,818	818,008	640,468	1,021,282	1,029,307	1,053,473	1,064,377	1,335,605	1,314,469	1,345,127	13,364,476
Te ardhura nga puna dhe aktiviteti privat A. G.	521,712	510,732	557,982	155,683	933,333	1,600,000	1,136,131	1,600,000	1,600,000	1,600,000	1,600,000	797,915	2,510,864	1,063,842	16,188,194
Te ardhura nga interesi i depozites Raiffeisen Arjana Gumbardhi								21,659	41,395	36,775	29,923	2,476	2,968	85	135,281
SHPENZIME	895,728	868,849	967,821	972,848	1,127,138	1,172,207	1,512,539	1,332,731	1,235,470	1,633,864	1,358,499	2,108,139	2,970,342	3,537,657	21,693,831
Shpenzime jetese	375,856	375,856	438,228	438,228	546,480	580,635	683,100	683,100	683,100	697,740	705,120	989,991	747,587	822,822	8,767,843
Shpenzime arsimimi	519,872	492,993	529,593	534,620	580,658	591,572	829,439	649,631	531,072	544,908	546,819	728,222	1,693,767	2,156,982	10,930,147
Shpenzime mobilimi														270,540	270,540
Shpenzime per punime ne apartamentin Rr. ***												175,138	172,063		347,200
Shpenzime udhetimi		0	0	0	0	0	0	0	21,298	391,216	106,560	214,789	356,926	287,313	1,378,102
Analiza dokumentuar	-2,138,132	-1,378,270	-944,419	543,323	2,804,948	-4,849,621	-8,225,091	-1,748,630	-2,806,500	-1,986,085	-3,558,399	-7,928,834	441,344	610,734	-31,163,633
															Pamundesia financiare 2003 - 2016
															-35,563,982

Nga analiza financiare e periudhës 2003 – 2016, subjekti dhe bashkëshorti kishin një pamundësi financiare totale prej 35,563,982 lekësh.

Në total, pamundësia financiare e subjektit dhe familjes së saj për periudhën dhjetor 1993 – 2016 arrin vlerën 42,300,926 lekë

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare dhe problematikat

24. Gjatë kësaj analize Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “ProCredit Bank”; BKT-ja; “Raiffeisen Bank”; “Credins Bank”; “Intesa Sanpaolo Bank”; “Bank Austria”; dhe “Erste Bank”

- Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti solli *statement* bankar të llogarive të vajzave të saj në Austri. Njëra nga këto llogari vjen me një *statement* me faqe që mungojnë dhe, si e tillë, është e paqartë. Nga dokumenti nuk kuptohet për cilën bankë bëhet fjalë dhe as emri i mbajtësit të llogarisë. Gjithashtu, për shkak të mungesës së disa faqeve, aty nuk shihen gjendjet e likuiditeteve në fund të vitit, si dhe nuk shihen të gjitha lëvizjet e likuiditeteve.

- Në përfundim të hetimit, subjektin iu kërkua që këto llogari t'i sjellë të plota, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe sipas formës së kërkuar nga ligji.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti solli të përkthyer një pjesë të llogarive të vajzave në Austri, duke mos sqaruar ende llogarinë për të cilën ishte kërkuar sjellja e plotë dhe në formën e kërkuar nga ligji.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi se ka depozituar në total vlerën 1.200.000 lekë në depozita në vitin 1997 dhe vlerën 700.000 lekë në depozita në vitin 1998. Ai pretendon, gjithashtu, se nga këto depozita ka përfituar në total një interes prej 7.803.544 lekësh për periudhën 1997 – 2005. Për të mbështetur shpjegimet e tij, subjekti sjell përgjigjen me nr. *** prot., datë 27.5.2022, të “Raiffeisen Bank”, lidhur me disa depozita të trashëguara nga ish Banka e Kursimeve për periudhën 1998 – 2004. Në këtë shkresë jepet informacion lidhur me gjendjet e depozitave në emër të depozituesit A.R.G, por nuk jepet informacion mbi vlerat e depozituara nga mbajtësi i depozitave apo interesat e përfituara nga këto depozita.

- Subjekti nuk vërtetoi burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre depozitave në vitet 1997 dhe 1998 sepse të ardhurat e ligjshme të dokumentuara nga pagat e subjektit si gjyqtare (dhjetor 1993 – 1998) dhe të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si nd/gjyqtar dhe gjyqtar për periudhën 1993 – 1996, ishin të pamjaftueshme për krijimin e depozitave në vlerë totale 1.900.000 lekë deri në fund të vitit 1998.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti solli prova të reja lidhur me vërtetimin e disa të ardhurave nga gjykata për të dhe për bashkëshortin, të cilat Komisioni i bëri pjesë të analizës financiare. Edhe pas këtyre ndryshimeve në analizë, subjekti sërish nuk arriti të provojë burimin e krijimit të depozitimeve në vitet 1997 - 1998.

- Përveç kësaj, subjekti ka edhe një llogari në monedhën euro në BKT, e cila vjen me një gjendje të vërtetuar prej 8.873,96 euro (2.272,41 + 1.165,75 + 2.435,8) para datës 1.1.2002 nga kjo bankë, përmes shkresës nr. *** prot., datë 7.6.2022, në të cilën pranohet nga banka që në momentin e emetimit të monedhës euro (datë 1.1.2002) depozitat e mëparshme në monedhat ITL, DEM dhe GRD janë konvertuar në monedhën euro. Më pas, në datën 20.9.2002 ato janë unifikuar në një depozitë të vetme. Ndërkohë nuk saktësohet momenti i krijimit të tyre para vitit 2002.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

- Të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhjetor 1993 – 2016).

- Të ardhurat nga bashkëshorti i subjektit nga puna si nd/gjyqtar dhe gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë (dhjetor 1993 – mars 1995) dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (prill 1995 – gusht 1996) sipas dokumenteve²⁶ të sjella bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare.

Subjekti, në përgjigje pyetëso, ka pretenduar dhe të ardhura të bashkëshortit A. G nga mësimdhënia në shkollën 8-vjeçare O, Vlorë, për periudhën 1989 – 1993. Për këto të ardhura të pretenduara subjekti nuk ka sjellë dokumentacion vërtetues, prandaj nuk janë marrë parasysh si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.

- Të ardhurat nga shërbimet juridike pranë Projektit të Menaxhimit të Burimeve Ujore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (maj 2000 – mars 2006) dhe ekzekutimit në vitin 2009 të vendimit nr. ***, datë 19.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit të subjektit (shtator 2007 – dhjetor 2016).

Lidhur me këto të ardhura nga Bashkia Tiranë vërtetohet një xhiro e deklaruar nga z. A. G në vlerat 3-4 milionë lekë për gjithë periudhën e zhvillimit të aktivitetit. Gjithashtu, vërtetohet edhe pagesa e taksave vendore të biznesit të vogël për këtë xhiro të deklaruar, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.

Nga ana tjetër, nga organet tatimore nuk konfirmohet pagesa e detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël sipas ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, i ndryshuar, neni 12, pika 1, ku thuhet se: *“Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, të cilat realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale”*.

Meqë nuk vërtetohet deklarimi i xhiros mbi 2,000,000 lekë pranë DRT-së Tiranë dhe nuk vërtetohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për xhiron mbi 2,000,000 lekë, Komisioni vlerësoi se të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti i tij privat nuk mund të kapërcejnë pragun prej 2,000,000 lekësh për ato vite ku nuk vërtetohet kjo nga organet tatimore.

Si rrjedhim, për vitin 2007, xhiroja maksimale e mundshme nga aktiviteti prej 4,000,000 lekësh do të plotpjesëtohet për muajt e aktivitetit (meqë subjekti ekonomik u regjistrua si person fizik në datën 17.9.2007). Mbi këtë xhiro aplikohet një marzh fitimi prej 80%.

Për vitin 2008 është konsideruar xhiroja maksimale prej 2,000,000 lekësh pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007. Mbi këtë xhiro aplikohet një marzh fitimi prej 80%.

Për vitin 2009 është konsideruar vlera e fitimit prej 342,000 lekësh, të vërtetuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 19.5.2022, të DRT-së Tiranë.

Për vitet 2010 – 2013 është konsideruar xhiroja maksimale prej 2,000,000 lekësh. Mbi këtë xhiro aplikohet një marzh fitimi prej 80%.

Për vitet 2014 – 2016 është konsideruar vlera e fitimit, të vërtetuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 19.5.2022, të DRT-së Tiranë.

²⁶Vërtetim nr. *** prot., datë 23.6.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vërtetim nr. *** prot., datë 20.6.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit për periudhën 2007 – 2016, subjekti kundërshtoi marzhin e fitimit prej 80% të përdorur në analizën financiare.

Komisioni sqaron se ky marzh fitimi i përdorur në analizë përbën një standard të përdorur vazhdimisht në analizat financiare të Komisionit gjatë gjithë procesit për këtë kategori aktiviteti privat.

Ndërkohë, në seancën e datës 30.9.2022 lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit pas regjistrimit në organet tatimore, subjekti solli prova të reja që vërtetojnë sërish pagesën e taksës vendore të biznesit të vogël pranë Bashkisë për xhiro 3-4 milionë lekë (të cilën e kishin të vërtetuar edhe më parë). Sërish bashkëshorti i subjektit nuk vërtetoi deklarinimin pranë organeve tatimore për xhiro më të lartë se 2 milionë lekë dhe, si rrjedhim, nuk vërtetoi as pagesën e tatimit përkatës.

- Të ardhurat nga interesat e depozitave në emër të bashkëshortit të subjektit, edhe pas konsiderimit të shpjegimeve përfundimtare të subjektit, nuk u bënë pjesë e analizës financiare sepse nuk vërtetohet burimi i krijimit të tyre.

Në veçanti, për depozitat e krijuara tek ish-Banka e Kursimeve në vitet 1997 - 1998 nuk disponohet informacion i dokumentuar për vlerat e sakta të depozituara në secilin vit dhe për vlerat e sakta të interesave të përfituara nga këto depozita deri në vitin 2005.

Po ashtu edhe për depozitat pranë BKT-së nuk disponohet informacion i dokumentuar për vlerat e sakta të depozituara në secilin vit dhe për vlerat e sakta të interesave të përfituara nga këto depozita deri në vitin 2002.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i).

Për periudhën para vitit 2000 është zbatuar vendimi nr. 15, datë 18.6.2021, i Kolegjit për subjektin K. S.

- Shpenzimet për punime tek apartamenti në rrugën “****” (vitet 2014 - 2015), sipas deklarinimit të subjektit në përgjigje pyetësori.

- Shpenzime qiraje për periudhën 1997 – 1999, sipas deklarinimit të subjektit në përgjigje pyetësori.

- Shpenzimet e arsimimit të fëmijëve të subjektit (vitet 2002 – 2016).

Lidhur me arsimimin e vajzave të subjektit në institucionin arsimor “****”, vetë institucioni pranon se nuk disponon të dhëna për periudhën para vitit 2009. Po ashtu, edhe subjekti nuk deklaroi kostot e arsimimit për këto vite, duke pranuar që institucioni nuk ka informacion.

Në mungesë të një dokumentacioni provues për kostot reale të arsimimit të vajzave të subjektit pranë institucionit arsimor “****” për periudhën 2002 – 2008, Komisioni zbatoi një zbritje progresive nga kostoja e vitit 2009 në masën 10% çdo dy vite, duke iu referuar trendit rritës që ka pasur kostoja e arsimimit nga viti 2009 në vitin 2013. Për vitet e tjera në vazhdim, vlera e koston së studimeve të vërtetuara nga institucioni “****” është përfshirë në analizën financiare si shpenzim arsimimi për fëmijët.

Subjekti, për periudhën e arsimimit (2014 – 2016) të vajzave të subjektit në Austri, ka dhënë deklarata të ndryshme në deklaratat periodike të këtyre viteve edhe në përgjigje të pyetësorit. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi koston për kursin e gjuhës gjermane, koston e U.T.E të Vjenës, si dhe koston e akomodimit në konvikt, duke mos dokumentuar asnjë nga këto kosto me dokument vërtetues nga institucionet e cituara.

Shpenzimet e arsimit për vajzat në Austri për vitin 2014 janë marrë sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. ***, duke përfshirë edhe shpenzimet e konviktit të vërtetuara me dokumentacion.

Shpenzimet e arsimit për vajzat në Austri për vitin 2015 - 2016 janë marrë sipas deklaramit të subjektit në DPV/2015 - 2016, duke përfshirë edhe shpenzimet e konviktit të vërtetuara me dokumentacion.

- Shpenzime për mobilim të apartamentit në rrugën “****” (viti 2016) sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje pyetësori.

- Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

ç. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive²⁷.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar dhe Komisioni ka vlerësuar si vijon:

i) Lidhur me pretendimin e subjektit për burimin e krijimit të llogarive në “Raiffeisen Bank” në vitet 1997 - 1998 dhe shtesave të tyre në vazhdim, si dhe llogarive në BKT, duhet pasur parasysh se në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: *“Burimi i krijimit të këtyre vlerave janë nga puna e bashkëshortit para viteve 1990, pas viteve 1990 dhe, konkretisht, janë të ardhurat e realizuara nga puna si mësues dhe gjyqtar deri në gusht të vitit 1996 të cituara më lart.*

Burimi tjetër është puna e bashkëshortit si përfaqësues ligjor në konsulta juridike në përfaqësime në gjykime prej muajit shtator 1996 deri në dhjetor të vitit 1999, nga viti 2000 e në vijim në marrëdhënie të punës të cituara më lart.

Burim tjetër janë dhe një pjesë e kursimeve familjare të familjes së bashkëshortit para viteve 2000.

Burim tjetër i të ardhurave janë dhe një pjesë e familjes sime që para viteve 1990 dhe pas viteve 1990, ku përfshihet paga ime si gjyqtare që nga dhjetori i vitit 1993 e në vijim, pjesë e të ardhurave të cilat kanë rrjedhur nga letrat me vlerë të përfituara nga ana e babait tim, si dhe një pjesë e dëmshpërblimeve të personave të dëbuar dhe internuar”.

Ndërsa në shpjegimet përfundimtare, subjekti ka parashtuar duke paraqitur argumente dhe prova që lidhen me të ardhurat financiare të familjeve përkatëse, duke iu referuar përbërjes familjare sipas certifikatave familjare dhe gjendjes faktike gjatë ushtrimit të detyrës dhe përpara fillimit të ushtrimit të detyrës. Kështu, subjekti thotë se *Komisioni duhej të kishte hetuar në mënyrë më të thelluar në lidhje me përbërjet familjare të familjeve respektive të A. Caco dhe A. G dhe të ardhurat financiare të tyre.* Subjekti bën një përshkrim të të ardhurave të familjarëve të saj: të ardhura që nga viti 1980 të babait të saj, të motrës, të hallës bashkë me bashkëshortin e saj, si dhe të vetat duke theksuar se: *“... unë nuk kam paguar shpenzime jetese deri sa kam filluar bashkëjetesën me bashkëshortin tim në vitin 1997 dhe pagën time e kam kursyer neto, që nga fillimi i ushtrimit të funksionit si gjyqtare në vitin 1993. Gjithashtu, familjarët e mi më kanë dhuruar shuma në vazhdimësi, të cilat u janë bashkuar kursimeve të bashkëshortit tim, si dhe të familjarëve të tij.*

²⁷Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

Me familjarët e bashkëshortit (nënë dhe vëllain) tim kam qenë me gjendje familjare prej 6 personash deri në vitin 2003”.

Subjekti solli të ardhura nga familjarët e saj (babai, motra, halla me bashkëshortin, duke qenë se këta të fundit jetonin në një ekonomi të përbashkët), duke listuar edhe të ardhura nga kompensimet e pronave dhe dëmshpërblime si ish-të përndjekur në shumën totale deri në 1,200,000 lekë (sipas “Raiffeisen Bank”) në vitet 1994 – 1996, si dhe të ardhura nga kompensimi i pronave në Pogradec nga bashkëshorti i hallës.

Ndërsa në lidhje me të ardhurat e familjarëve të bashkëshortit, subjekti sjell dokumentacion dhe të dhëna që nga viti 1961, ku babai, nëna, motra, vëllai, gjyshja nga babai e gjyshi nga nëna e A.G kanë realizuar të ardhura. Sjell të dhëna, ku familja e bashkëshortit ka qenë subjekt i ligjit të tatimit të jashtëzakonshëm të vitit 1946 dhe, për pasojë, u janë konfiskuar pasuri e sende me vlerë, si dhe u janë shtetëzuar banesa private (sipas ligjit të vitit 1950).

Pas vitit 1990, subjekti pretendon se nëna e bashkëshortit ka përfituar:

Dëmshpërblim në bazë të ligjit nr. 7514/91, në masën 38.830 lekë, të ardhura nga pronat e trashëguara (qira nga shfrytëzimi i pyjeve), të ardhura nga shitja e një dyqani me sip. 5448 m², në vlerën 4.000.000 lekë, në Leskovik, në vitin 2004.

Të ardhura të përfituara nga babai i bashkëshortit nga pronat dhe sendet me vlerë (të trashëguara nga gjyshja e tij Z.G) të kthyera pas vitit 1990, si dhe të ardhura monetare si ish-veteran.

Të ardhura të përfituara nga gjyshi nga nëna e bashkëshortit si pasojë e administrimit të pyjeve në Bashkinë Kolonjë përgjatë viteve 2000 – 2014, ku bashkëshorti i subjektit është një nga administratorët e familjes V, për shfrytëzimin e pyllit dhe pronave të tjera sipas prokurës së vitit 2001.

Gjithashtu, subjekti pretendon dhe sjell të dokumentuara të ardhura të përfituara nga vëllai i bashkëshortit I. G, me profesion inxhinier, të ardhura nga interesat e huadhënies prej 500,000 lekësh në masën 45,000 lekësh nga shoqëria tregtare “***”, si dhe të ardhura nga emigracioni në Itali përgjatë viteve 1997 – 2003 dhe dëmshpërblim për shkak të një aksidenti të ndodhur në vendin e punës, po në shtetin italian.

Subjekti pretendon se së bashku me bashkëshortin kanë qenë subjekte të ligjit nr. 7903, datë 8.3.1995, “Për deklarimin e pasurive ...” dhe kanë deklaruar deri në vitin 2001 pasuri personale të trashëguara dhe sende me vlerë (monedha ari), të cilat më vonë janë konvertuar në tregun e lirë, duke cituar dispozitat e ligjit dhe duke arsyetuar se i janë drejtuar përkatësisht Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë dhe Vlorë me kërkesën për të tërhequr kopje të këtyre deklaratave, por nuk kanë marrë përgjigje.

Subjekti, pavarësisht këtij deklarimi e arsyetimi, nuk citon vlera konkrete, të cilat i ka deklaruar ajo dhe bashkëshorti i saj përgjatë këtyre viteve. Përkundrazi, subjekti deklaroi se referuar nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016, ndodhemi në pamundësi objektive për të siguruar këtë dokumentacion.

Komisioni i vlerësoi këto dokumente të sjella në përgjigje të rezultateve të hetimit në lidhje me konsiderimin e të ardhurave të përfituara nga familjet përkatëse (familjarët e subjektit dhe bashkëshortit të saj) dhe arriti në konkluzionin se ata kanë pasur pasuri dhe të ardhura të konsiderueshme para dhe pas vitit 1990, të cilat nuk janë të deklaruara më parë. Një pjesë e tyre nuk janë të ardhura të matshme në vlerë monetare, si dhe nuk ekziston asnjë dokument apo deklaratë që të vërtetojë që subjekti dhe bashkëshorti të kenë përfituar shuma monetare konkrete nga familjarët e tyre.

Ndërkohë, të ardhurat nga pagat e vërtetuara me dokumentacion për subjektin dhe bashkëshortin janë të pamjaftueshme për krijimin e depozitave në fjalë.

ii) Subjekti pretendoi që për vitet 1997 – 1999 shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të llogariten në masën 30% të të ardhurave të ligjshme. Ky standard, sipas vendimit të Kolegjit për subjektin K. S, është zbatuar në vitet 1993 – 1996, kur subjekti dhe bashkëshorti ishin të dy gjyqtarë. Ndërkohë, pas vitit 1996, vetëm subjekti është gjyqtarë dhe nga bashkëshorti i saj nuk vërtetohen të ardhura deri në vitin 2000. Përveç kësaj, në familjen e tyre nga viti 1996 janë edhe dy vajzat.

Subjekti pretendoi që për vitet 2000 - 2002, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të llogariten në masën 30% të të ardhurave të ligjshme. Ky standard nuk zbatohet për periudhën 2000 - 2002, sepse Komisioni për këtë periudhë zbaton shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së.

Subjekti pretendoi dhe kërkoi nga Komisioni që për vitet 2003 – 2016 të zbriten shpenzimet e jetesës së familjes së saj dhe të zbatohen ato sipas INSTAT-it dhe jo ato të ILDKPKI-së. Ndërkohë, Komisioni ka një standard të konsoliduar për këtë periudhë lidhur me shpenzimet e jetesës duke zbatuar ato të ILDKPKI-së.

iii) Subjekti pretendoi që vajzat e saj, gjatë periudhës së shkollimit tek shkolla “****”, kanë konsumuar atje mëngjesin dhe drekën, prandaj duhet t’i zbriten shpenzimet e jetesës së vajzave për këtë periudhë. Ky pretendim nuk dokumentohet nga subjekti. Vërtetimi i sjellë nga institucioni arsimor për vitet 2009 – 2014 paraqet pagesën e shkollimit dhe transportit, por jo ushqimin, librat apo diçka tjetër.

iv) Subjekti pretendoi mospërfshirjen e shpenzimeve të arsimimit të vajzave të saj pranë kësaj shkolle për periudhën 2002 – 2008 për shkak të pamundësisë objektive për të provuar se sa është paguar prej saj.

v) Subjekti pretendoi se shkolla ka aplikuar ulje nga tarifa shkollore deri në 50% në varësi të provimit të pranimit të nxënësve, si dhe ka aplikuar ulje çmimi për familjet me më shumë se një fëmijë në këtë shkollë. Ndërkohë, subjekti nuk solli ndonjë dokument që të provojë këtë rregullore të shkollës apo përfitimin e këtyre zbritjeve.

vi) Subjekti pretendoi se njëra nga vajzat (A) ka qenë me rezultate të shkëlqyera gjatë gjithë periudhës së shkollimit dhe, për këtë, ka përfituar pagesë jo të plotë, madje 3 vite shkollim falas. Për këtë, subjekti ka sjellë dëftesat dhe fletë nderi të vajzës gjatë viteve edhe pse nuk dokumentohet rregullorja e shkollës, ku të vërtetohet praktika e këtij institucioni për të aplikuar zbritje dhe masat përkatëse të zbritjes mbi tarifën e shkollimit.

Në lidhje me vlerësimin e shpenzimeve të arsimimit të vajzave në këtë shkollë për periudhën 2002 – 2008, Komisioni, në mungesë të dokumentacionit ligjor, arsyetoi se kostot e arsimimit të vajzave të subjektit në kolegjin “****” për këto vite duhen zbritur me normën 10% çdo 2 vite dhe kjo duke parë trendin rritës të kostove në vite, për të cilat ka informacion, por pa përfshirë kosto transporti.

vii) Shpenzimet e shkollimit në Austri janë vlerësuar sipas dokumenteve shtesë të sjella nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit (kontrata qiraje, fatura kurs gjuhë gjermane, *statement* bankar, etj.) dhe deklarimeve të subjektit.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjet e pasurive, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në gerimat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Arjana Gumbardhi, me anë të verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Arjana Gumbardhi, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar²⁸, ku rezulton se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Arjana Gumbardhi.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke përfshirë edhe lëvizjet e subjektit për hyrje-daljet jashtë vendit sipas informacionit²⁹ nga sistemi *TIMS*.

Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit; të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

²⁸Shihni shkresën raport përfundimtar me nr. *** prot., datë 13.7.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 12.7.2022, të KDZH-së.

²⁹Shihni shkresën kthim përgjigje të DPPSH-së.

Subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi (Caco) ka depozituar tri dokumente ligjore, të llojit “vendim gjyqësor”. Nga këto, një vendim i përket vitit 2014, një tjetër i përket vitit 2015 dhe i fundit i përket vitit 2016. Këto vendime përshkruhen dhe analizohen në vijim:

Dokumenti 1 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 13.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket çështjes civile me nr. akti ***, me palë: paditës I.F, kundër të paditurve I. F, M. F dhe I. F, me objekt “Konstatimin pjesërisht të pavlefshëm të testamentit nr. ***, datë 2.8.2012, të testatores M. B, në ½ pjesë të pasurisë që është disponuar me testament në dobi të I.F dhe M. F për shkak të cenimit të rezervës ligjore. Detyrimin e të paditurve ta njohin trashëgimtar me ½ pjesë të të gjithë pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të lënë nga trashëgimlënësja M. B. Marrjen e masës për sigurimin e pasurisë trashëgimore duke urdhëruar përmbaruesin gjyqësor, që të bëjë inventarizimin e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësës M.B, si dhe urdhërimin dhe mostjetërsimin e kësaj pasurie te personat e tretë deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Urdhërimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë që të fshijë të gjitha regjistrimet që janë bërë për kalimin e pasurisë trashëgimore nga M.B te I.F dhe M. F, në zbatim të testamentit nr. ***, datë 2.8.2012, të lënë nga testatorja M.B. Urdhërimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të bëjë regjistrimin e kalimit në bashkëpronësi të I. F në ½ pjesë të të gjithë pasurisë së lënë nga trashëgimlënësja M.B”.

Dokumenti 2 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 27.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket çështjes civile me nr. akti ***, që u përket palëve: paditëse shoqëria “****” sh.p.k. kundër të paditurit shoqëria përmbarimore “****” sh.p.k.; person i tretë “****” sh.a., me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. ***, ***, ***, datë 27.10.2014, ‘Vendim për caktimin e çmimit të sendit të sekuestruar’ të shoqërisë përmbarimore “****” sh.p.k.”. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtar i vetëm.

Dokumenti 3 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 22.1.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket çështjes civile me nr. akti ***, që u përket palëve: paditës i kundërpaditur shoqëria “****” sh.p.k. kundër të paditurit kundërpaditës shoqëria “****”, dega shqiptare, degë e shoqërisë së huaj, me objekt të padisë “Detyrim për pagimin e shumës 240.000 USD, rrjedhur nga mospërmbushja e detyrimit kontraktor për pagimin e shërbimeve dhe kamatat ligjore mbi këtë shumë deri në ditën e ekzekutimit të vendimit. Detyrimin për pagimin e shumës 480.000, dëm i shkaktuar nga zgjidhja e parakohshme dhe e njëanshme e kontratës, si dhe kamatat ligjore mbi këtë shumë deri në ditën e ekzekutimit të detyrimit. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestro konservative mbi llogaritë bankare të shoqërisë “***, Dega Shqiptare, deri në vlerën e detyrimit prej 720.000 USD”, me objekt të kundërpadisë: Rregullimin e pasojave të ardhura si rrjedhojë e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, kontratës së shërbimit datë 1.1.2014, duke detyruar paditësin e kundërpaditur t’i kthejë të paditurit kundërpaditës shumën 720.000 USD. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestron konservative mbi aktivet dhe llogaritë bankare të paditësit të kundërpaditur deri në shumën 720.000 USD”. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtar i vetëm.

Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore për gjyqtaren Arjana Gumbardhi (Caco) të përzgjedhura me short

Dosja 1 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 19.11.2014 regjistrimi, që u përket palëve: paditëse shoqëria “****” sh.p.k. kundër të paditurit shoqëria “****”, degë e shoqërisë së huaj, me objekt “Detyrimi i palës së paditur të ndalojë në mënyrë të menjëhershme përdorimin e emrit R dhe logos që sjell si pasojë konkurrencën e pandershme dhe dëm ekonomik. Ndalimin e konkurrencës së pandershme dhe antiligjore”. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.2.2015.

Çështja me shortin e datës 20.11.2014 iu caktua për gjykim gjyqtares Arjana Gumbardhi (Caco). Me vendimin e datës 24.11.2014 caktoi seancë përgatitore në datën 19.12.2014, ora 10:00.

Seanca 1 përgatitore e datës 19.12.2014 është çelur dhe është dokumentuar me procesverbal me shkrim i mbajtur nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco). Në procesverbal nuk është shënuar as ora e fillimit dhe as ora e mbarimit të seancës.

Seanca 2 përgatitore e datës 21.1.2015 është çelur dhe është dokumentuar me procesverbal me shkrim i mbajtur nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco). Në procesverbal nuk është shënuar as ora e fillimit dhe as ora e mbarimit të seancës.

Seanca 3 gjyqësore e datës 3.2.2015, është çelur në orën 11:40 dhe është dokumentuar me procesverbal i mbajtur me regjistrim në audio. Gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco) është asistuar nga sekretare gjyqësore E. Ç.

Seanca 4 gjyqësore e datës 19.2.2015 është çelur në orën 10:10 dhe është dokumentuar me procesverbal me shkrim. Nuk jepet shpjegim përse nuk është mbajtur me regjistrim në audio. Relatohet prej gjyqtares arsyeja e fillimit me vonesë të seancës.

Seanca 5 gjyqësore e datës 23.2.2015 është çelur në orën 12:15 dhe është dokumentuar me procesverbal i mbajtur me shkrim.

Gjyqtarja ka shpallur vendimin përfundimtar me të cilin ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur ‘R.C, Degë e shoqërisë së huaj të ndalojë në mënyrë të menjëhershme përdorimin e emrit ‘R’, të logos dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me konkurrencën. Gjyqtarja, në bazë të neneve 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të lëshojë edhe urdhrin e ekzekutimit për këtë vendim”.

Rezultoi se ndaj vendimit të mësipërm është ushtruar ankim nga pala e paditur në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. ***, datë 23.2.2015 dhe rrizimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.4.2018, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Rezultoi se dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 23.3.2015, brenda një muaji nga shpallja, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 3 muaj e 3 ditë, në intervalin kohor 20.11.2014 - 23.2.2015. Rezulton se gjykimi është realizuar në respektim të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga germa “b”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Konstatohet një menaxhim korrekt i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, gjë që çoi në respektimin e afatit standard të gjykimit.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 23.2.2015, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), përmban elementët e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Vendimi i mësipërm plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 30.8.2013 regjistrimi, që u përket palëve: paditës F.Ç, kundër të paditurit Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, me objekt “Anulim i aktit administrativ, vendimit nr. ***, datë 20.6.2013, i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë. Njohja e së drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Ç.Ç për pronën e ndodhur në fshatin P, Komuna V, Rrethi Berat dhe kthimin e sipërfaqes së lirë:. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.6.2015.

Çështja me shortin elektronik të zhvilluar në datën 3.9.2013 iu caktua për gjykim gjyqtares Arjana Gumbardhi (Caco).

Gjyqtarja ka shpallur vendimin përfundimtar me të cilin ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë si e pabazuar në ligj dhe në prova”.

Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim paditësi në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe pranimin e kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 29.9.2016, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 5.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs i padituri në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar: “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 29.9.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 5.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Rezultoi se dosja në Gjykatën e Lartë është regjistruar në datën 20.1.2017, por deri në datën e përpilimit të këtij raporti Gjykata e Lartë ende nuk ka disponuar me vendim përfundimtar për çështjen.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 22.6.2015, pas 17 ditëve nga shpallja, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit, 9 muaj e 6 ditë, në periudhën 30.8.2013 – 5.6.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është në shkelje të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Konstatohet se gjykimi është zvarritur si për shkak të sjelljes jokorrekte të palëve, ashtu edhe për shkak të organizimit të dobët të punës nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco). Si rezultat në zvarritjen e gjykimit, përveç sjelljes së palëve, ka kontribuar edhe gjyqtarja me organizimin e dobët të punës.

Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 5.6.2015, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), përmban elementet e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Sqarohet në arsyetim se për pretendimet e paditësit u krye edhe një ekspertizë nga një ekspert i zgjedhur nga gjykata, por nuk arsyetohet se çfarë pretendimi u provua apo u rrëzua nëpërmjet kësaj prove. Pra, gjyqtarja nuk ka analizuar përmbajtjen e ekspertizës së kryer prej saj gjatë këtij procesi.

Rezultoi se vendimi i mësipërm i gjyqtares Arjana Gumbardhi (Caco) u prish nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila konstatoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk kishte pasur kompetencën tokësore për shqyrtimin e asaj çështjeje dhe se gjykata kompetente për shqyrtimin e saj ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Bazuar në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. ***, datë 29.9.2016, vlerësohet se vendimi gjyqësor nr. ***, datë 5.6.2015, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), përmban mangësi serioze në arsyetimin e tij, të konstatuara nga gjykata më e lartë e sipërcituar dhe, për më tepër, vjen në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4, datë 20.12.2013, të Gjykatës së Lartë.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 16.10.2014 regjistrimi, që i përket paditësit N.L, kundër të paditurve: shoqëria “*****” sh.p.k., A. Sh, L. Sh, Banka Kombëtare e Greqisë sh.a., ZVRPP-ja Tiranë, përmbarues privat H.Xh, D.D, me objekt “Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës së hipotekës me nr. ***, datë 3.5.2012, e lidhur ndërmjet

përfituesit Banka Kombëtare e Greqisë, dega Tiranë (***) dhe hipotekuesit A.Sh dhe L. Sh për pasurinë e paluajtshme apartamentin nr. ****, me nr. pasurie ***, z. k., nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 8503 m², i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 14.11.2011, i ndodhur në katin e parë mbi dyqane, shk. ***, të godinës 9-katëshe, rruga ‘***... anulimin e veprimeve përmbarimore të përmbaruesit privat H.Xh., fshirjen nga regjistri i pasurisë së paluajtshme ... regjistrimin e pasurisë së paluajtshme ..., sigurimin e padisë ... etj.’. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 13.11.2015.

Çështja, me shortin e datës 17.10.2014, iu caktua për gjykim gjyqtares Arjana Gumbardhi (Caco).

Në përfundim të gjykimit, gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar me të cilin ka disponuar si në vijim: “Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore të përmbaruesit privat H.Xh për vendosjen e sekuestros konservative me urdhrin nr. *** prot., për kontratën e hipotekimit me nr. ***, datë 3.5.2012 dhe përjashtimin nga ekzekutimi i detyrueshëm i pasurisë apartament nr. ***, me nr. pasurie ***, z.k. nr. ***, vol. ***, f. *** e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 14.11.2011, të ndodhur në katin e parë mbi dyqane, shk. ***, të godinës 9-katëshe, me sip. 8503 m², rruga ‘***’, që i përket paditësit N. L. Marrjen e masës për sigurimin e padisë duke vendosur sekuestro konservative në ZVRPP Tiranë, për të ndaluar çdo veprim tjetërsimi për apartamentin nr. ***, me nr. pasurie ****, z.k. nr. ***, vol. ***, f. ***, e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 14.11.2011, të ndodhur në katin e parë mbi dyqane, shk. ***, të godinës 9-katëshe, rr. ‘***’, me sip. 85.03 m², që i përket paditësit N.L. Deklarimin e pavlefshëm të kontratës së hipotekës ***. Fshirjen nga regjistri i pasurisë së paluajtshme ***. Detyrimin e ZVRPP-së Tiranë për regjistrimin *** etj. Rrëzimin për pjesën tjetër të objektit të padisë si e pabazuar në ligj dhe në prova. Bashkë me vendimin është lëshuar nga gjyqtarja edhe urdhri i ekzekutimit të tij”.

Rezultoi se vendimi i mësipërm është kundërshtuar nga palët e paditura ‘****’ sh.a dhe ZVRPP-ja Tiranë në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.7.2017, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor nr. ***, datë 13.11.2015, janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 14.12.2015, pas një muaji nga shpallja, pra në shkelje të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit e 27 ditë, në intervalin kohor 17.10.2014 - 13.11.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është në shkelje të afatit standard 6-mujor të parashikuar në germen “e”, të nenit 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht nuk është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor, i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Konstatohet se çështja u zvarrit dhe për këtë kanë ndikuar palët sidomos pala paditëse me adresat e pasakta të të paditurve, por edhe qëndrimi tolerant i gjyqtares ndaj kësaj mangësie, të metë të padisë me moskthimin e padisë. Nga ana tjetër, edhe shtyrja e seancave gjyqësore për të marrë prova apo për t’u njohur palët me provat e njëra-tjetrës përbëjnë mangësi në organizimin e punës nga gjyqtarja, pasi veprime të tilla duhet të përfundojnë në seancë përgatitore. Vetëm pak seanca janë mbajtur me regjistrim në audio (katër të tilla nga 16 gjithsej të zhvilluara). Nuk jepen sqarime për moszhvillimin e seancave të tjera në audio. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 13.11.2015, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Ky vendim plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Dosja nr. 4 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 21.5.2013 regjistrimi, që u përket palëve: paditës M. M, kundër të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me

objekt “Detyrimin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për të më rillogaritur masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi që nga data 1.1.1999 e në vazhdim”. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 11.11.2013. Kjo çështje iu caktua për gjykim gjyqtarës Arjana Gumbardhi (Caco). Gjyqtarja, në datën 24.5.2013 caktoi seancën përgatitore më 28.6.2013, ora 11:30.

Gjyqtarja shpall vendimin ku ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Rezultoi se vendimi i mësipërm është kundërshtuar nga pala paditëse në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë sipas objektit. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 15.4.2014, ka vendosur: “Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për shqyrtimin e çështjes civile nr. *** regjistri, datë 13.2.2014. Dërgimin e saj në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë”.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.7.2014, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 11.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 21.11.2013, pas 10 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 5 muaj e 20 ditë, në intervalin kohor 22.5.2013 -11.11.2013. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit ***, të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 11.11.2013, është dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco) në cilësinë e gjyqtarit të vetëm. Vendimi përmban elementet e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Bazuar në disponimin e mësipërm të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, lidhur me arsyetimin e vendimit të bërë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco) konstatohen mangësi. Kështu, gjyqtarja ka gabuar me kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes pas datës 4.11.2013, pasi ajo nuk duhej të përfundonte gjykimin vet, por kryesisht të konstatonte mungesën e kompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti i rivlerësimit në arsyetimin e saj në vendim ka konstatuar se kishte të bënte me një mosmarrëveshje administrative dhe, pavarësisht kësaj, ka vazhduar gjykimin dhe madje i është referuar një dispozite ligjore që ishte shfuqizuar. Neni 328 i Kodit të Procedurës Civile, që i referohet gjyqtarja në arsyetimin e vendimit, ishte shfuqizuar nga dispozita tranzitore, neni 72 i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarrëveshjeve administrative”.

Dosja 5 – kërkesa penale nr. *** regjistri themeltar, datë 7.3.2014 regjistrimi, që i përket kërkuarit: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndaj personit nën hetim M. C, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Kjo çështje është e përfunduar me vendimin përfundimtar nr. *** akti, datë 9.3.2014.

Çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore në datën 9.3.2014, ora 10:50. Në dosje nuk ka akt të shkruar të gjyqtarit (vendim, urdhër) për caktimin e seancës gjyqësore dhe nuk gjendet asnjë akt njoftimi për palët ndërgjyqëse.

Gjyqtarja me vendim i dha fund hetimit gjyqësor dhe ftoi palët për konkluzionet. Gjyqtarja u tërhoq për marrjen e vendimit përfundimtar në bazë të nenit 378/6 të Kodit të Procedurës Penale dhe në kthim ka disponuar si vijon: “Pranimin e kërkesës. Vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të personit nën hetim M.M.C. Caktimin si masë sigurimi ndaj personit nën hetim M.M.C atë të ‘Detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore çdo të martë të muajit në orën 10:00’, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale”.

Rezultoi se vendimi gjyqësor i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga asnjëra palë. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor, i dhënë nga gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 24.3.2014, pas 15 ditësh nga shpallja e vendimit, duke shkelur afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 2 ditë, në intervalin kohor 7.3.2014 - 9.3.2014, duke respektuar afatin 48 orë të përcaktuar nga pika 5 e nenit 259 të Kodit të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar të përcaktuar nga pika 2 e nenit 28 të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 5 të KEDNJ-së. Procesverbali gjyqësor nuk është mbajtur me regjistrim në audio dhe nuk jepen arsyet për këtë gjë.

Vendimi gjyqësor nr. *** akti, datë 9.3.2014, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, përmban elementet e përcaktuara nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Vendimi i mësipërm i gjyqtarës Arjana Gumbardhi (Caco) paraqet mangësi në drejtim të arsytimit të tij. Kështu, gjyqtarja është kontradiktore kur arsyeton lidhur me kërkesën e prokurorit për vleftësim të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj personit nën hetim. Gjyqtarja citon parashikimin e nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim që dënohet në maksimum deri në 2 vjet burgim. Ndërkohë, megjithëse e pranon se krimi për të cilin dyshohet personi nën hetim parashikon dënimin në maksimum me 6 muaj burgim, gjyqtarja shprehet se: *“Për sa më sipër, arrestimi në flagrancë nga punonjësit e policisë është kryer sipas nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale”*. Në të vërtetë, arrestimi i shtetasit M. C. duhet të vlerësohej se ishte kryer në kundërshtim me përcaktimin e nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale, pra duhet të deklarohet si i paligjshëm. Gjithashtu, në lidhje me dyshimin e arsyeshem arsyetohet se ai u krijua mbi bazën e provave të administruara në dosjen gjyqësore, por pa u cituar përmbajtja e asnjë prove konkrete.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Arjana Gumbardhi (Caco) janë paraqitur gjithsej 10 ankesa (1 në vitin 2013, 7 në vitin 2015, 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish KLD-së.

Tri ankesa të vitit 2015 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat, 2 prej tyre me arsytimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ku për njërin prej ankesave arkivimi është bërë edhe për faktin se pretendimet ndaj vendimit të ndërmjetëm nuk mund të shqyrtohen kur procesi është në gjykim e sipër. Ndërsa, një ankesë është arkivuar si e përsëritur. Për 2 ankesa të vitit 2015 është sugjeruar bashkimi me ankesën bazë, e cila është verifikuar (këto të fundit nuk ndodhen fizikisht në ankesën bazë dhe as në arkivin e KLGJ-së).

Pesë ankesa (1 e vitit 2013, 2 të vitit 2015 dhe 2 të vitit 2016) janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

Dy ankesa (1 e vitit 2013 dhe 1 e vitit 2015), verifikuar për zvarritje, është vendosur për 1 prej tyre evidentim për efekt vlerësimi etik dhe profesional gjyqtarës dhe për një tjetër është sugjeruar tërheqje vëmendje me shkrim dhe fillimi i një inspektimi të përgjithshëm për afatin e dorëzimit

të vendimeve gjyqësore për vitin 2015. Tri ankesa (1 e vitit 2015 dhe 2 të vitit 2016), verifikuar për mosrespektim formal ligji është vendosur mbajtja e verifikimit në vijim deri në përfundim të gjyqimit në gjykatat më të larta. Për ankesën e vitit 2015, rezulton se nuk është regjistruar urdhër verifikimi në vijim dhe ajo është arkivuar, ndërsa 1 ankesë e vitit 2016 e cila duhej mbajtur në verifikim në vijim nuk rezulton të ketë urdhër verifikimi të regjistruar në protokoll dhe nuk ndodhet fizikisht në arkiv apo nuk rezulton e përcjellë pranë ILD-së.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Arjana Gumbardhi (Caco), përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Rivlerësimi i bërë nga Komisioni

Gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco), në tri dokumentet e paraqitura të prezantuara prej saj, në pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short, si dhe nga të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, ka shfaqur aftësi mesatare në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Mangësi në zbatimin e ligjit janë ndeshur në dy çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, vendimet e së cilës u prishën nga gjykata më e lartë dhe u vendos kthimi i çështjes për rigjykim.

Vendimi i parë i prishur i përket dosjes nr. 2, ku gjykata e apelit konstatoi se gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco) kishte shkelur dispozitat mbi kompetencën tokësore dhe se kishte vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4, datë 20.12.2013, i cili përcaktonte si gjykatë kompetente që shqyrtonte vendimet e Agjencisë së Kthimit e Kompensimit të Pronave, gjykatën e vendit ku ndodhej prona apo sendi që kërkohet nga ish-pronari.

Vendimi i dytë i prishur i përket dosjes nr. 4, ku Gjykata Administrative e Apelit konstatoi se: “Gjykatat administrative filluan funksionimin e tyre në datën 4.11.2013 dhe që nga kjo datë, me shfuqizimet e mësipërme, mosmarrëveshjet administrative janë në kompetencë të gjykatave administrative. Në këto kushte, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka pasur kompetencën lëndore për të gjykuar çështjen, pasi ajo është në kompetencë të gjykatave administrative, prandaj kompetente për çështjen në shqyrtim është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe, për pasojë, meqenëse jemi para shkeljes së ligjit procedural që passjell pavlefshmërinë e vendimit, vendimi objekt ankimi duhet të priset e çështja të dërgohet për rigjykim në gjykatën kompetente”.

Nga tetë vendime gjyqësore të vëzhguara janë konstatuar mangësi në arsyetim në tre prej tyre. Kështu, dy vendime gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit u prishën nga gjykata më e lartë dhe u vendos kthimi i çështjes për rigjykim (shihni dosjet 2 dhe 4).

Në njërin vendim të prishur gjyqtarja nuk kishte respektuar dispozitat mbi kompetencën lëndore, pasi gjykata e apelit konstatoi se kompetente ishte Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (dosja 4).

Në vendimin tjetër të prishur gjykata e apelit jo vetëm konstatoi mungesën e kompetencës tokësore në gjykimin e çështjes, por vuri në dukje se gjyqtarja nuk respektoi vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, për më tepër, gjyqtarja nuk kishte analizuar të gjitha dokumentet e administruara si prova.

Kështu, në vendimin që i përket dosjes nr. 2 të prishur nga apeli, kjo e fundit, ndër të tjera, shprehet se: “Gjykata e Apelit çmon se hetimi gjyqësor i gjykatës së faktit vlerësohet i mangët, kur nga Gjykata e Rrethit nuk janë analizuar të gjitha provat e paraqitura në gjykim dhe administruar në dosjen gjyqësore siç është vendimi gjyqësor nr. ***, datë 30.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Berat... Gjithashtu, nga pretendimet e paditësit, si dhe provuar nga akti i marrjes së

tokës në pronësi ka rezultuar se familja e F.Ç ka përfitur tokë nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, akte të cilat nuk janë marrë në shqyrtim dhe nuk janë vlerësuar nga gjykata e faktit ... etj.”.

Mangësi në arsyetim janë konstatuar edhe në vendimin që i përket dosjes nr. 5, ku është theksuar se gjyqtarja është kontradiktore kur arsyeton lidhur me kërkesën e prokurorit për vleftësim të ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj personit nën hetim. Gjyqtarja citon parashikimin e nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim që dënohet në maksimum deri në 2 vjet burgim. Ndërkohë, megjithëse e pranon se krimi për të cilin dyshohet personi nën hetim parashikon dënimin në maksimum me 6 muaj burgim, gjyqtarja shprehet se: *“Për sa më sipër, arrestimi në flagrancë nga punonjësit e policisë është kryer sipas nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale”*. Në të vërtetë, arrestimi i shtetasit M. C. duhet të vlerësohet se ishte kryer në kundërshtim me përcaktimin e nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale, pra duhej të deklarohet si i paligjshëm”.

Në pesë dosje të vëzhguara është konstatuar se në dy raste është shkelur afati ligjor ose afati standard i gjykimit (shihni dosjet 2 dhe 3). Në dy dosjet me nr. 2 dhe nr. 3, ku është tejkaluar afati standard i gjykimit, është konstatuar se përveç sjelljes së palëve në mosrespektimin e afatit standard ka ndikuar edhe organizimi dhe planifikimi i punës nga ana e gjyqtarës (më hollësisht shihni analizën e dosjeve 2 dhe 3).

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco) vetëm në një rast ka respektuar afatet ligjore për dorëzimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore. Në dy raste, shkelja e afatit ligjor në dorëzimin e vendimit të arsyetuar vlerësohet domethënëse (shihni dosjet 1 dhe 3). Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 1 muaj nga shpallja (shihni dosjet 1 dhe 3), për 17 ditë nga shpallja (shihni dosjen 2), për 10 ditë nga shpallja (shihni dosjen 4) dhe për 15 ditë nga shpallja (shihni dosjen 5).

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Arjana Gumbardhi (Caco) janë paraqitur 10 ankesa (1 në vitin 2013, 7 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016) në ish-Inspektoratin e KLD-së, nga trajtimi i të cilave nuk rezultuan shkelje në veprimtarinë e gjyqtarës (shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së). Vetëm për pesë ankesa është vendosur verifikimi dhe vetëm në dy prej tyre rezultuan shkelje në veprimtarinë e gjyqtarës. Kështu, për 2 ankesa (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2015), verifikuar për zvarritje, është vendosur për një prej tyre evidentim për efekt vlerësimi etik e profesional gjyqtarës dhe për një tjetër, e cila është sugjeruar tërheqje vëmendje me shkrim dhe fillimi i një inspektimi të përgjithshëm për afatin e dorëzimit të vendimeve gjyqësore për vitin 2015.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi është pjesërisht efiçente në çështjet që ka shqyrtuar. Rezultoi se gjyqtarja Arjana Gumbardhi (Caco) është problematike në arsyetimin në kohë të vendimeve gjyqësore të dhëna prej saj, prej nga ku rezultoi se vetëm në një rast afatet ligjore ishin respektuar. Gjithashtu, një problematikë e tillë rezultoi edhe nga verifikimi i ankesave adresuar për veprimtarinë e kësaj gjyqtareje, ku në një rast Inspektorati i KLD-së kishte sugjeruar: *“Fillimi i një inspektimi të përgjithshëm për afatin e dorëzimit të vendimeve gjyqësore për vitin 2015”*.

Në dosjet 2 dhe 3 janë evidentuar probleme në organizimin dhe planifikimin e punës nga ana e saj, fakt që ka çuar në zvarritje të gjykimit. Konstatohet se në dosjet 2 dhe 3 gjyqtarja zhvillon seanca përgatitore sa për të thënë, pasi shtyn shumë seanca gjyqësore për të marrë prova, për t’u njohur palët me provat e njëra-tjetrës, për t’u dhënë kohë palëve për t’i sjellë provat në formën e kërkuar nga ligji etj. Pra, veprimet përgatitore në vend që të ezaurojnë çështje të tilla dhe të

përgatisin plotësisht çështjen për gjykim, kryhen në mënyrë formale dhe, si të tilla, nuk janë efikase.

Një tjetër mangësi e konstatuar është fakti që nga ana e gjyqtarës Arjana Gumbardhi (Caco) regjistrimi audio është përdorur në fare pak seanca.

Për këto konstatime të listuara sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me rivlerësimin e bërë nga Komisioni për kriterin e aftësive profesionale, për konstatimet e listuara, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Ky vlerësim i aftësive profesionale në emrin tim është fyes për vetë periudhën e gjatë të punës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe konkretisht prej 29 vitesh, duke punuar në seksionet më të vështira dhe me volum më të madh, si ato prej 17 vjetësh në seksionin e gjykimeve administrative dhe civile dhe aktualisht në seksionin civil-tregtar.*

Në lidhje me konstatimin e Komisionit për përfundimin e gjykimeve të çështjeve nr. 2,3 dhe 4 nga ana ime jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa 'b' e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, sqaroj se: ‘Duke iu referuar Kodit të Procedurës Civile me ndryshimet e viteve 2008 – 2013 nuk është parashikuar një afat i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit të çështjeve civile, por në nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar se gjykata duhet të përfundojë gjykimin e një çështjeje civile brenda një afati të arsyeshëm, përveç gjykimeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e titujve ekzekutivë, të cilët e kanë afatin procedural për gjykimin e tyre 20 ditë. Nga ana e ish-KLD-së, për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve nëpërmjet Aneksit 1, pika 5, germa 'b' e Sistemit të Vlerësimit, ka caktuar nja afat prej 6 muajsh. Duke qenë se ka pasur një vakum ligjor në lidhje me përcaktimin e një afati të arsyeshëm për gjykimin e një çështjeje civile, në ndryshimet e vitit 2017 të Kodit të Procedurës Civile, u përcaktua qartë afati i arsyeshëm i gjykimit të një çështjeje civile në Gjykatat e Rretheve dhe konkretisht afati 2-vjeçar.

Ky afat i përcaktuar ka efekt vetëm në lidhje me vlerësimin profesional të gjyqtarëve dhe jo të shërbejë si normë vjetore për ligje të tjera.

*Një problematikë tjetër në lidhje me dosjen nr. 2, sipas vlerësimit të kryer nga vlerësuesi, është se vendimi i kësaj çështjeje përmban mangësi serioze në arsyetimin e tij dhe është një vendim i dhënë në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4, datë 20.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me këtë problematikë sqaroj se vendimi nr. ***, datë 5.6.2015, që i përket dosjes nr. 2 të vlerësimit, është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 29.9.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 5.6.2015, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.*

*Nga ana ime, pasi u njoha me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 29.9.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e konsideroj tendencioz konkluzionin e arritur nga ana e Komisionit në lidhje me cilësimin se vendimi im përmban mangësi serioze në arsyetimin e tij, pasi ky fakt nuk është konstatuar në asnjë rresht të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.*

Në vendimin e saj Gjykata e Apelit ka arsyetuar se sipas tyre është bërë një hetim jo i plotë dhe një analizë dhe interpretim i gabuar i provave të palës paditëse, gjë e cila ka çuar në një vendim jo të drejtë, e cila për mendimin tim ka të bëjë edhe me bindjen e brendshme të gjyqtarit për zgjidhjen e një çështjeje, bazuar kjo në nenin 29 të Kodit të Procedurës Civile. Megjithëse, ligjërisht unë nuk mund të shprehem për vendimin e një gjykate më të lartë, duke iu referuar arsyetimit të Gjykatës së Apelit, ku provat ishin marrë të gjitha, aktekspertimi topografik ishte kryer dhe kemi të bëjmë vetëm me analizim të provave, siç shihet edhe nga detyrat e lëna për gjykatën kompetente në rigjykim, nuk kishte shkaqe ligjore që ta pengonte këtë gjykatë të vendoste ndryshimin e vendimit dhe të mos i sillte zvarritje të gjykimit paditësit dhe në bazë të nenit 467/b të Kodit të Procedurës Civile t'i vinte në dukje gjyqtarit të çështjes d.m.th. mua, për moskompetencën tokësore.

Unë bëj me dije Komisionin se kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë që ka të bëjë me kthimin e çështjes për rigjykim për 'arsyetim me mangësi serioze' dhe në lidhje me vendimmarrjen e shpalljes së moskompetencës tokësore të gjykimit të çështjes nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe pritet për t'u shqyrtuar. Pra, nuk është zgjidhur nga ana e gjykatës më të lartë vendimmarrja e Gjykatës së Apelit, e cila pavarësisht se nuk ka deklaruar në vendimin e saj për mangësi serioze në arsyetimin e vendimit ka vendosur prishjen e vendimit dhe shpalljen e moskompetencës tokësore.

Në lidhje me pjesën e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku unë kam dhënë një vendim në kundërshtim me një vendim unifikues të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë sqaroj se, fillimisht, duhet të sqaroj se mosmarrëveshja që ka qenë e nevojshme për të unifikuar praktikën ligjore nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës ka qenë nëse vendimet e AKKP-së në lidhje me njohjen apo jo të së drejtës së pronësisë subjektive të shpronësuar do të konsiderohet si akt administrativ dhe, në këto kushte, duhet të gjykohet nga Gjykata Administrative, apo do të konsiderohen gjykime që kanë të bëjnë me njohjen e të drejtës së pronësisë, të cilat trajtohen me dispozitat e Kodit Civil dhe të gjykohen nga ana e gjykatave që shqyrtojnë mosmarrëveshjet civile nga gjykata kompetente. Nuk ka qenë qëllimi i unifikimit të praktikës gjyqësore i kompetencës tokësore, por unifikimi i praktikës gjyqësore për gjykimin e këtyre lloj kërkesëpadive me objekt kundërshtimin e vendimeve të AKKP-së, pra me kompetencën lëndore të gjykimeve të këtyre çështjeve.

Vendimi unifikues në konkludim ka vendosur që këto lloj çështjesh do të gjykohen nga gjykatat kompetente që zgjidhin mosmarrëveshjet civile, pra nga gjykatat civile, duke mos e përcaktuar qartë kompetencën tokësore të gjykimit të këtyre çështjeve.

Duke iu referuar vendimit unifikues dhe duke pasur parasysh nenin 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, 'Për kthimin dhe kompensimin e pronave' i ndryshuar, në të cilin parashikohet se kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtën të bëjë ankim brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, e cila për kohën që po flasim ishte në fuqi si dispozitë, si dhe duke pasur parasysh dhe parimin ligjor, që ligji i veçantë prevalon nga ligji i përgjithshëm, kam gjykuar këto lloj çështjesh, duke vlerësuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjykatë kompetente nga pikëpamja tokësore.

Vlen për t'u theksuar se si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë janë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me këto lloj gjykimesh.

Në lidhje me çështje të ngjashme që janë gjykuar nga ana ime dhe të gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë gjykuar në periudha të ndryshme pas daljes së vendimit unifikues, duke mos konstatuar moskompetencën tokësore janë gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe janë lënë në fuqi, duke mos i prishur dhe dërgimin për kompetencë tokësore në Gjykatën e vendit ku ndodhet prona, por ka pasur dhe raste që megjithëse ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe prona ndodhej në Rrethin e Fierit, përsëri e ka kthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe jo në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier³⁰.

Në lidhje me dosjen nr. 3 është konstatuar nga Komisioni zvarritje e gjykimit duke përfunduar çështjen, duke tejkalluar afatin e vendosur sipas Aneksit 1, pikës 5, germa 'b', e sistemit të vlerësimit.

Kjo çështje është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2014 dhe veprimet procedurale unë jam bazuar në ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile të bëra në vitin 2013.

³⁰Për ta konkretizuar, subjekti bashkëlidhur sjell edhe vendime gjyqësore.

Këto zvarritje kanë konsistuar në pasaktësinë e adresave të palës së paditur të paraqitura nga paditësi, qëndrimi tolerant nga ana ime që nuk e ka konstatuar me të meta kërkesëpadinë dhe të dilte me vendimmarrje kthimin e kërkesëpadisë pa veprim, lejimi nga ana e gjykatës e marrjes së provave në çdo moment procedural dhe lënia kohë palëve për t'u njohur me to, duke e konsideruar si një organizim të dobët të punës sime, pasi janë veprime që kryhen në seancë përgatitore, si dhe zhvillimin e pak seancave në sistemin audio.

Dosja nr. 3 me palë paditëse: N.L, palë e paditur L.Sh, D. d etj. sqaroj se në lidhje me konstatimin e Komisionit dhe vlerësuesit të aftësive të mia profesionale se zvarritja e gjykimit ka qenë përveç të tjerave edhe nga toleranca nga ana ime e palës paditëse për saktësimin e adresave të palës së paditur, bëj me dije se pala paditëse në kërkesëpadinë e tij kur ka paraqitur përpara gjykatës kërkesëpadinë, ka përcaktuar dhe adresat e të paditurve, por nga njoftimi i kryer nga gjykata ka rezultuar se të paditurit janë larguar nga adresa. Pra pala paditëse e ka përmbushur detyrimin procedural për paraqitjen e adresave të të paditurive të sipërcituar dhe mosnjoftimi i tyre për seancat gjyqësore për shkak të ndryshimit të adresës apo mosgjetjes së tyre në adresë, nuk është përgjegjësi e paditësit dhe, në këto kushte, gjykata nuk mund ta konsiderojë kërkesëpadinë me të meta që të ketë një vendimmarrje për kthimin e kërkesëpadisë pa veprim sipas nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa në lidhje me konstatimet e tjera për kryerjen e veprimeve përgatitore dhe veprimeve të mia i parashtrova më lart tek dosja nr. 2.

Dosja nr. 4 me palë paditëse: M.M, palë të paditur DRSSH Tiranë sqaroj se nga ana e Komisionit është konstatuar se vendimi në lidhje me këtë çështje ka mangësi në arsyetim dhe është dhënë nga një gjykatë që nuk ka pasur kompetencë lëndore, pasi kompetente ishte Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

Në lidhje me konstatimin e parë të Komisionit që ka të bëjë me mangësi në arsyetimin e gjykimit, meqenëse është një konstatim i përsëritur, si dhe te dosja nr. 2 unë e konsideroj si tendencioze.

*Së pari, këtë konstatim e bëjnë vetëm gjykatat më të larta, pasi ka të bëjë me gjykimin e një çështjeje, çmuarjen e provave dhe kryerjen e një hetimi të plotë, të cilët kryejnë dhe kontrollin e kësaj vendimmarrje. Po t'i referohemi arsyetimit të vendimit nr. ***, datë 21.7.2014, të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, që ka gjykuar këtë çështje, rezulton se është prishur dhe kthyer për rigjykim vetëm për efekt të moskompetencës lëndore dhe nuk e ka gjykuar çështjes në themel.*

Pra, përderisa Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë në arsyetimin e vendimit të tij nuk është shprehur në lidhje me themelin e çështjes, konstatimi i Komisionit për mangësi në arsyetimin e vendimit nuk qëndron, duke aluduar se ky është edhe konkluzioni i gjykatës më të lartë.

Në lidhje me dhënien e një vendimi, duke mos pasur kompetencë lëndore, sqaroj se vendimi i sipërcituar është prishur dhe kthyer për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak se në momentin kur unë kam përfunduar së gjykuari këtë çështje dhe kam shpallur vendimin kishte hyrë në fuqi ligji nr. 49/2012, 'Për funksionimin dhe organizimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative'. Është e vërtetë që ligji i sipërcituar ka hyrë në fuqi në datën 4.11.2013 dhe se unë kam shpallur vendimin në datën 11.11.2013, por në dispozitat kalimtare të këtij ligji nuk ishte parashikuar se çështjet e regjistruara në gjykatat civile me objekt të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve administrative para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të gjykoreshin nga gjykatat civile apo nga gjykatat administrative, pra kishte një vakum ligjor. Gjykata, referuar nenit 1, paragrafi i dytë, të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet se: '... Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë', është e detyruar të japë drejtësi, nëpërmjet vendimeve të saj.

Këtë paqartësi pra, plotësimin e dispozitave kalimtare të këtij ligji në lidhje me problematikën e krijuar e zgjidhën Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 3, datë 6.12.2013, ku u krye unifikimi i praktikës gjyqësore dhe u vendos që të gjitha çështjet e këtij lloji të cilat ishin regjistruar para hyrjes në fuqi të ligjit të sipërcituar do të gjykoheshin nga gjykatat administrative.

Nga sa arsyetova më lart, unë e çmoj se vlerësimi i Komisionit në lidhje me dosjen nr. 4 është i gabuar dhe i pabazuar në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ka sqaruar qartë dhe saktë këtë problematikë.

Gjithashtu, nga ana e Komisionit në lidhje me dosjen nr. 4 ka arritur në konkluzionin se nga ana ime në lidhje me këtë çështje është referuar mbi një dispozitë të shfuqizuar (neni 328 i Kodit të Procedurës Civile).

Siç e parashtrova dhe në fillim të shpjegimeve të mia, unë jam gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për një periudhë prej 29 vjetësh, ku 17 vjet kam gjykuar në seksionin administrativ dhe gjithashtu kam marrë pjesë edhe në testimin e gjyqtarëve sipas ligjit nr. 49/2012 për të qenë pjesë e Gjykatës së Apelit Administrativ dhe jam vlerësuar me 90 pikë, nuk më falet të gjykoj mbi një dispozitë të shfuqizuar.

Lidhur me këtë konstatim të Komisionit po shpjegoj se nga ana ime vendimmarrja në lidhje me dosjen nr. 4 nuk është referuar në një dispozitë të shfuqizuar (neni 324 i Kodit të Procedurës Civile), por në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, konkretisht në nenet 31, 32/a, 153, 154 dhe 156, si dhe në ligjet materiale që rregullojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes, që për rastin konkret është detyrimi i palës së paditur DRSSH Tiranë për të rillogaritur dhe për të paguar masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të paditësit M.M. Citimi i nenit 328 i Kodit të Procedurës Civile, në vendimin gjyqësor nga ana ime nuk ka të bëjë me bazueshmëri ligjore për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, por është cituar në lidhje me sqarimin e mosmarrëveshjes. Ky fakt është pasur parasysh dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me vlerësimin profesional të gjyqtarëve për këto vendimmarrje për të mos penalizuar këta të fundit për këto lloj gjykimesh.

Dosja nr. 5: kërkues - Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, personi nën hetim M. C. Në lidhje me konstatimet e Komisionit për sa i përket kësaj dosjeje sqarohet se nga ana e Komisionit është vlerësuar se ky vendim ka mangësi në arsyetimin e tij duke argumentuar se, referuar dispozitës për vleftësimin e arrestimit në flagrancë, është gabuar nga ana ime për arsye se për veprën penale që akuzohet i pandehuri, masa e dënimit nuk e justifikon arrestimin në flagrancë të tij dhe duhej të vleftësohej si i paligjshëm bazuar në nenin 251/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me arsyetimin e dispozitës për sa i përket vleftësimin të arrestimit në flagrancë për rastin konkret arsyetoj se në nenin 251/3 është e parashikuar se, kur lind nevoja, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë secilin që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2. Për rastin konkret, i pandehuri është arrestuar për shkak se drejtonte një mjet motorik a dokumentet ligjore të mjetit, si për lejen e drejtimit të mjetit dhe për dokumentacionin që ka të bëjë me pronësinë e mjetit, duke lindur dyshimin dhe për kryerjen e një vepre tjetër penale dhe deri në provueshmërinë e tyre ka kryer arrestimin në flagrancë. Me këtë vendim, edhe pse kam vendosur vleftësimin e arrestimit në flagrancë, nuk ka sjellë pasoja ligjore për të pandehurin, pasi me vendimin tim kam vendosur caktimin e masës së sigurimit personal 'Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore', parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Vlerësimi i kryer nga Komisioni në lidhje me vleftësimin e arsyetimit të këtij vendimi gjyqësor, për sa i përket kësaj dosjeje nuk qëndron, sepse ky vendim është i formës së prerë dhe duke u bazuar në nenin 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në dispozitat e Kodit të

Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale, institucionet përkatëse ligjore, të cilat cilësojnë që një vendim gjyqësor përmban elementet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar ose jo, janë Gjykatat më të Larta, siç janë Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, në bazë të ankimit të kryer nga palët, nëpërmjet institutit të ankimit.

Gjithashtu, në ligjin nr. 84/2016, neni 44, që ka të bëjë me relacionin e rivlerësimit është parashikuar se relatori që përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, duhet të bazohet në raportin e inspektorëve, informacione të marra nga burime të tjera, si dhe kriteret e vlerësimit të parashikuar në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

Për sa më lart, në përgatitjen e vlerësimit të aftësive profesionale dhe konkretisht për dosjen nr.5 sqarohet se jemi para një vendimi të formës së prerë dhe se ligjshmëria e vendimmarrjes nuk mund të jetë objekt vlerësimi nga organi kontrollues që në rastin konkret është Komisioni, bazuar në ligjin nr. 98/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', neni 72/4, ku është parashikuar vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet'.

Pra, përfundimisht vlerësimi i arsytimit të vendimit të sipërcituar si arsyetim me mangësi serioze të kryer nga Komisioni është i pavlefshëm, pasi bie në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit.

Nga ana e Komisionit është konstatuar se nga ana ime për dosjen nr. 5 nuk është hartuar vendim i caktimit të seancës gjyqësore dhe nuk ndodhen në dosje aktet e njoftimit të prokurorit dhe të arrestuarit. Komisioni, në arritjen e këtij konkluzioni, duhet të kishte parasyrsh se për çështje të tilla referuar Kodit të Procedurës Penale neni 259/5 afati i shqyrtimit të këtyre kërkesave ka karakter urgjent për vetë afatin prej 48 orësh dhe nuk ka kuptim hartimi i një vendimi për caktimin e një date për shqyrtim, pasi këtë ta dikton vetë Kodi i Procedurës Penale brenda dy ditëve.

Gjithashtu, në lidhje me mosqenien e akteve të njoftimit të prokurorit dhe të të ndaluarit unë mendoj se fakti që seanca është kryer brenda afatit ligjor dhe në prani të palëve tregon se ato janë kryer pavarësisht qenies ose jo në dosje të administruara.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur si praktikë në lidhje me njoftimin e Prokurorisë dhe nëpërmjet shërbimit telefonik, ndërsa për sa i përket njoftimit të të ndaluarit, realizohet me shpresë ku urdhërohet lëvizja e tij nga paraburgimi. Për mendimin tim ky konstatim dhe ajo më lart janë formalizma, të cilat pasqyrohen për të cenuar aftësitë e mia profesionale në mënyrë të padrejtë.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se jam problematike në dorëzimin e vendimeve gjyqësore brenda afatit të parashikuar nga ligji dhe, konkretisht, në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, sqarohet se kjo problematikë qëndron, por ajo duhet parë në harmoni dhe me sasinë e gjykimeve të përfunduara për çdo vit, si dhe mundësinë kohore për të dorëzuar në afat këto dosje.

Për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, unë kam përfunduar së gjykuar 1559 çështje civile, 26 çështje penale, 23 kërkesa penale, 368 masa sigurimi. Referuar nenit 3/c të aneksit 1, gjyqtari i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm duhet të gjykojë, jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare në një vit, pra jo më pak se 360 çështje në dy vjet. Rezulton se për periudhën e rivlerësimit unë kam përfunduar 1559 çështje civile dhe tregtare, duke respektuar dhe tejkaluar standardin sasior sa i takon gjykimit të çështjeve civile themeli, për afërsisht kam gjykuar dyfishin e çështjeve të themelit, pa përfshirë çështje të tjera civile (kërkesa civile) dhe kërkesave penale (masa sigurimi). Gjithashtu, duhet të theksoj se nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor ka pasur gjithnjë një problematikë të tillë, vetëm për shkak të ngarkesës së madhe në punë.

Për sa parashtrova më lart, vlerësimi mesatar për sa i përket aftësive profesionale nuk qëndron si në pjesën matematikore të përcaktimit të mesatares, ashtu edhe nga ana ligjore.

Në lidhje me aftësitë organizative në të cilën përfshihet aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore dhe aftësia për të administruar dosjen, Komisioni ka konkluduar se unë jam pjesërisht efiçente, për sa i përket përballimit të ngarkesës në punë, ndërkohë që sipas të dhënave statistikore për vitin 2013 – 2016 të pasqyruar edhe në raportin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ-ja, unë kam përfunduar së gjykuari 1473 çështje, nga të cilat 633 janë çështje themeli + civile, tregtare, 534 kërkesa civile, 301 kërkesa penale të llojit 'masa sigurimi' dhe 5 kërkesa penale, ku rendimenti i përfundimit të çështjeve e bazuar në këto të dhëna është 83.3%”.

Vlerësimi i Komisionit

Pas konsiderimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se argumenti i paraqitur nga subjekti në parashtrimet e saj në lidhje me gjykimin jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “b” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit se *ky afat i përcaktuar ka efekt vetëm në lidhje me vlerësimin profesional të gjyqtarëve dhe jo të shërbejë si normë vjetore për ligje të tjera*, është absurd ligjor për shkak se institucioni që ka për detyrë të bëjë vlerësimin profesional të gjyqtarëve (ish-KLD-ja, tani KLGJ) e bën këtë vlerësim në dobi të ecurisë së punës në shërbim të publikut, por edhe për qëllime vlerësimi siç është rasti për efekt të ligjit nr. 84/2016 dhe procedurës në zbatim të këtij ligji.

Është i vërtetë dhe evident fakti i volumit të proceseve gjyqësore, veçanërisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në vlerësimin profesional të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ky kriter për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë me tolerancë, por numri i madh i çështjeve jo domosdoshmërisht përbën shkak të vetëm për zvarritje në gjykim dhe në zbardhje vendimesh nga subjekti i rivlerësimit.

Ndërsa në lidhje me zhvillimet e seancave pa regjistrim audio, subjekti i rivlerësimit me të drejtë prapëson duke thënë se në vitet e para të zbatimit të kësaj procedure kishte vështirësi teknike në menaxhim aparaturash dhe mungesë sallash të nevojshme për zhvillimin e disa seancave nga disa gjyqtarë njëkohësisht. Kjo problematikë vetëm vitet e fundit është rregulluar me shtimin e numrit të sallave të seancave gjyqësore pranë gjykatës.

DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 23 denoncime. Disa prej tyre janë të përsëritura dhe gjithsej rezultojnë 18 denoncime për subjektin Arjana Gumbardhi (Caco).

1. Denoncim nr. * prot., datë 1.12.2020, i “R.B”**

Ky denoncim është nënshkruar nga drejtuesi i përgjithshëm i bankës, z. Ch.C. Ky denoncues liston shkeljet procedurale të subjektit të rivlerësimit në dhënien e një vendimi me objekt “Kundërshtim i veprimit përmbarrimor, me palë ankuese shoqërinë ‘***’ sh.p.k. dhe Dh.T kundër shoqërisë përmbarrimore ‘***’ sh.p.k.”. Nga studimi i akteve ligjore të sjella bashkëlidhur ankesës së denoncuesit rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare K. Ç., me vendimin nr. ***, datë 7.8.2020, ka vendosur: “Sigurimin e padisë duke vendosur zhvillimin e ankandit të shpallur me veprimin përmbarrimor. Vendim për shpallje ankandi nr. *** prot., nr. *** regj., datë 4.8.2020, nga përmbarruesi gjyqësor E. Ll. shoqëria përmbarrimore ‘***.’ sh.p.k. deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes”. Ndaj këtij vendimi banka ka ushtruar ankim. Të njëjtën kërkesë palët e kanë paraqitur në çështjen civile që po shqyrtohej nga gjyqtare Arjana Gumbardhi, e cila gjithashtu e ka pranuar atë në seancën e datës 28.10.2020, duke vendosur pezullimin e veprimeve përmbarrimore deri në përfundim të gjykimin. Përfaqësuesi i bankës pretendon se *në kundërshtim me nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile, gjyqtarja Arjana Caco nuk e ka thirrur bankën në*

*cilësinë e personit të tretë/kreditorit, duke cenuar rëndë parimin themelor të zhvillimit të një procesi të rregullt gjyqësor. Kjo për faktin se gjyqtarja, pa praninë e bankës, ka caktuar ekspert vlerësues duke i dhënë vetëm pyetjet e palës ankuese. Gjyqtarja, më 28.10.2020, ka vlerësuar të thërrasë bankën për seancën e datës 13.11.2020 dhe në të njëjtën datë ka pranuar kërkesën për pezullimin e veprimeve përmbare. Gjyqtarja Arjana Caco, gjithashtu, është shprehur për një kërkesë të gjykuar më përpara, në shkelje të afatit të përcaktuar (20 ditë nga marrja e vendimit) nga neni 610 i Kodit të Procedurës Civile dhe ka marrë një vendim duke mos argumentuar rrezikun e menjëhershëm dhe të pakthyeshem që i kanosej ankuesit nga veprimet e përmbaresit. Bashkëlidhur ankimit të “R.B”, përfaqësuesi i saj ka sjellë: kopje të kërkesës së “R. B”, drejtuar gjyqtarës Arjana Caco për thirrje për gjykim; vendimin nr. *** akti, datë 7.8.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2020, e përmbaresit privat “Për anulimin e ankandit të parë”.*

Duke shqyrtuar vendimin objekt ankimi, atë me nr. 28.10.2020, gjyqtarës Arjana Caco nuk mund t'i kërkohej shpjegime për vendimmarrjen në këtë proces gjykimi, kjo referuar pikës 3 të dispozitivit të këtij vendimi, i cili i jep mundësinë palëve për ankim brenda 5 ditëve, nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit, Komisioni nuk mund t'i kërkojë shpjegime të mëtejshme subjektit të rivlerësimit. Por, në lidhje me pretendimin e mosrespektimit të paragrafit të tretë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se *ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbaresin gjyqësor, pavarësisht faktit se kjo dispozitë është fakultative dhe jo domosdoshmërisht e detyrueshme, vlerësohet nga Komisioni se gjyqtarja e çështjes duhej ta kishte thirrur “R. B” si palë të interesuar në gjykim.*

Në këto kushte, duke u nisur edhe nga pretendimi i ankuesit, subjektit iu kërkuar shpjegime për këtë fakt.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: *“Pavarësisht se neni 610 i Kodit të Procedurës Civile është fakultativ dhe jo domosdoshmërisht i detyrueshem, vlerësohet nga Komisioni se unë duhet ta kisha thirrur shoqërinë ‘***’ sh.a. si palë e interesuar në këtë gjykim. Sqaroj se denoncimi dhe konstatimi i Komisionit në lidhje me këtë çështje është veprim procedural, i cili është objekt ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku në dijeninë time ky vendim është ankimuar në këtë gjykatë. Në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, është parashikuar që debitori ka të drejtë të paraqesë ankim kundër veprimeve përmbare të përmbaresit gjyqësor kur e çmon se ato bien në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Ky ankim, duke iu referuar nenit 610/3 të Kodit të Procedurës Civile, mund të shqyrtohet nga gjykata edhe në dhomë këshillimi pa praninë e palëve.*

Unë, gjyqtarja e çështjes, për rastin konkret, meqenëse për shqyrtimin e këtij ankimi kërkohej edhe kryerje të veprimeve procedurale, siç është edhe caktimi i një eksperti në fushën e posaçme i një inxhinieri ndërtimi dhe vlerësues të pasurive, e kaloj çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

*Fillimisht, unë, gjyqtarja e çështjes, kam thirrur ankuesin dhe shoqërinë përmbare si palë të përcaktuar në ankim, meqenëse kundërshtoj direkt veprimi i përmbaresit gjyqësor në lidhje me përcaktimin e vlerës së sendit të sekuestruar. Përmbaresi gjyqësor është njoftuar nga gjykata, i cili megjithëse merrte dijeni për gjykimin e kësaj çështjeje nuk është paraqitur në gjykim. Pas kryerjes së veprimeve përgatitore nga ana ime dhe pas parashtrimeve dhe kërkimeve të ankuesit, pasi siç thamë përmbaresi gjyqësor nuk paraqitej në gjykim, meqenëse duhej të administrohej dhe prova e një aktekspertimi teknik në lidhje me përllogaritjen e vlerës së sendit në bazë të kërkesës së ankuesit, unë gjyqtarja kam caktuar ekspertin dhe i kam dhënë detyrat bazuar në nenin 227 të Kodit të Procedurës Civile. Pas kësaj seance përgatitore, nga ana e shoqërisë ‘***’ sh.a. është depozituar një kërkesë për të ndërhyrë në këtë proces me cilësinë e*

personit të tretë, kërkesë të cilën unë e kam pranuar në bazë të nenit 192 të Kodit të Procedurës Civile dhe që nga ky moment i kam komunikuar të gjitha aktet shkresore, duke përfshirë dhe aktin e ekspertimit të kryer nga ana e ekspertes së caktuar nga Gjykata. Në lidhje me denoncimin e shoqërisë "****" sh.a, që nga ana e Gjykatës duhej të ishte thirrur në cilësinë e personit të tretë, pretendim i cili është pranuar dhe nga Komisioni për mendimin tim nuk qëndron, pasi në nenin 192 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar që kushdo që shfaq interes në zgjidhjen e një çështjeje, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për të marrë pjesë në gjykim me cilësinë e personit të tretë, siç është bërë në rastin konkret, dhe gjithashtu është parashikuar që Gjykata kur e gjen të arsyeshme në bazë të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, kryesisht mund të thërrasë me cilësinë e personit të tretë. Në rastin konkret, siç është verifikuar nga dosja, shoqërisë 'R.B' sh.a. nuk i është mohuar asnjë e drejtë procedurale. Në seancë përgatitore personit të tretë, shoqëria 'R.B' sh.a. i është dhënë e drejta të kontestojë ekspertin në qoftë se ka pasur rezerva për të, i është dhënë e drejta e njohjes me aktekspertimin dhe dhënien e mundësisë për të paraqitur objeksionet në lidhje me këtë akt, nëse do të kishte, dhe ajo që është më kryesorja nga ana ime është vendosur pezullimi i veprimeve përmbartimore, duke qenë prezent edhe personi i tretë, shoqëria 'R.B' sh.a. dhe pasi është administruar akti i ekspertimit teknik në lidhje me përcaktimin e vlerës së sendit të sekuestruar e kryer nga eksperti i caktuar nga gjykata”.

2. Denoncim nr. * prot., datë 23.12.2019, i shtetasit A. Ç**

Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit se ka deleguar çështjen me objekt “Dëmshtëpërbli për dëmin jopasuror ... etj.” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier me qëllimin për ta favorizuar të paditurin K. Ç, i cili gjatë vitit 2015 kishte kryer kundërvajtjen penale, atë të “deklaratës së rreme”. Në vitin 2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me kallëzues denoncuesin A. Ç ndaj K. Ç. Në të gjithë parashtrimin që bën denoncuesi në lidhje me ngjarjen nuk dolën *indicie* për hetime të mëtejshme në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

3. Denoncim nr. * prot., datë 27.2.2020, i shtetasit B.P**

Ky denoncues ka denoncuar në emër të një grupi punonjësish të shoqërisë “****”, të cilët janë në proces gjyqësor me drejtuesit e kësaj shoqërie. Ata pretendojnë se gjyqtarja Arjana Caco ka favorizuar këta të fundit, duke ndryshuar oraret e seancave pa lajmëruar, me synimin që të kryejë makinacion në dëmin e tyre. Denoncuesit kërkojnë mbështetjen dhe prezencën e Komisionit dhe ONM-së në seancën gjyqësore të radhës. Për sa denoncuesi parashtron, nuk doli e qartë se ku mund të kishte kryer shkelje procedurale subjekti i rivlerësimit dhe, në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej.

4. Denoncim nr. * prot., datë 21.2.2020, i shtetasit Sh.B**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për “dhënie vendimi të padrejtë”. Nga vendimi bashkëlidhur ankesës nuk kishte *indicie* për hetime të mëtejshme në adresë të subjektit të rivlerësimit.

5. Denoncime nr. * prot., datë 26.7.2018 dhe nr. *** prot., datë 29.1.2019, të shtetasit A.B**

Ky shtetas ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, për “dhënie vendimesh në kundërshtim me kushtetutën”, të cilët kanë dhënë prona mbi dokumente false. Në dokumentacionin bashkëlidhur dy ankesave, ankuesi liston një vendim të organit të Prokurorisë së Rrethit Tiranë për mosfillim procedimi penal mbi një kallëzim penal të bërë nga ankuesi dhe shumë vendime gjyqësore të viteve të kaluara, por që nuk atakon personin e tij direkt. Në këto kushte nuk u konstatuan *indicie* për hetime të mëtejshme në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

6. Denoncim nr. * prot., datë 18.6.2018, i shtetasit J.J**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit “për dhënie vendimi të padrejtë” për shkak se duhej të thirrej si palë e interesuar në gjykim, meqenëse prekeshin interesat e pronësisë së tij, si dhe është ndryshuar sipërfaqja e pronësisë nga 266 m² në 211 m². Denoncuesi i referohet vendimit nr. ***, datë 20.2.2003, të cilin e ka sjellë bashkëlidhur ankesës së tij. Nga studimi i vendimit, bashkëlidhur ankesës, evidentohet fakti se gjyqtarja Arjana Caco për saktësimin e sipërfaqes në dispozitiv të vendimit (i cili është i formës së prerë) është bazuar në aktin e përgatitur nga eksperti topograf, i cili për sa kohë nuk është kundërshtuar nga palët në proces, shihet si provë determinante në vendimmarrje. Sa më sipër, nuk kishte *indicie* për hetime të mëtejshme në adresë të subjektit të rivlerësimit.

7. Denoncim nr. * prot., datë 21.11.2019, i shtetases A.Q**

Kjo shtetase ka denoncuar edhe subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, “për dhënie vendimesh të padrejta” në kundërshtim me ligjin. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtares së vetme në dhënien e vendimit nr. ***, datë 11.11.2016, ankuesja pretendon se gjyqtarja, me vendim të ndërmjetëm, ka pranuar caktimin e ekspertit kontabël për saktësimin e detyrimit të palës huamarrëse (paditëses) ndaj palës huadhënëse (të paditurit). Eksperti, pas betimit dhe marrjes së detyrës së tij, ka përgatitur aktekspertimin, mbështetur në dokumentet e dosjes gjyqësore. Gjatë prezantimit të konkluzioneve nga ana e ekspertit kontabël nuk ka pasur pyetje e kundërshtime nga palët, por gjyqtarja, sipas ankueses, e fshehu aktin dhe nuk pasqyroi të vërtetën duke arsyetuar në mënyrë të paligjshme dhe të palogjikshme. Edhe zbardhja e vendimit u bë me dy muaj vonesë. Ankuesja ka sjellë bashkëlidhur vendimin nr. ***, datë 11.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare Arjana Caco dhe kërkesën ankimore të datës 23.11.2016, drejtuar Gjykatës së Apelit dhe një akt vlerësimi kontabël të datës 10.10.2016. Ndër të tjera, gjatë studimit të vendimit të mësipërm, vërehet se gjyqtarja Arjana Caco, si gjyqtare e vetme e çështjes, gjatë arsytimit të vendimit nuk ka cituar faktin e pranimit të caktimit të ekspertit kontabël B. H. dhe, për pasojë, nuk e ka çmuar si provë të marrë në gjykim. Gjithashtu, edhe në kërkesën ankimore (në faqen 4 të saj) ndaj këtij vendimi, ankuesja liston këtë ankim ndaj vendimit të dhënë nga gjyqtarja Arjana Caco. Ankuesja depoziton pranë Komisionit një kopje të aktvlerësimit kontabël datë 10.10.2026 të ekspertit B. H. Siç duket edhe nga përmbajtja e ankesës, vendimit dhe kërkesës ankimore të ankueses, rezulton se ankuesja ka ushtruar të drejtën për t’u dëgjuar në gjykatë edhe nëpërmjet “zërit të ekspertit vlerësues”, por gjyqtarja e çështjes nuk e ka cituar dhe as konsideruar në vendimmarrjen e saj. Kjo bie në kundërshtim me nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile, i cili shprehimisht thotë: *“Vendimi mbështetet vetëm në të dhëna që ndodhen në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore. Gjykata çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre”*.

Në këto kushte, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për këtë mënyrë hartimi dhe arsytimi të vendimit nr. ***, datë 11.11.2016, që lidhet me procedurën e gjykimit të çështjes objekt ankimi pranë Komisionit.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: *“Në lidhje me këtë denoncim sqarohet se, fillimisht, konstatimi i Komisionit se nga ana ime është vepruar në kundërshtim me nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile nuk qëndron, pasi ky pretendim i ankueses është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, e cila me vendimin e saj nr. ***, datë 28.6.2018, ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar. Theksoj se nga ana ime për këtë çështje është kryer një hetim i plotë, ku përfshihet dhe aktekspertimi financiar, në bazë të kërkimit dhe pretendimit të palës paditëse. Në seancën përkatëse, nga ana ime si gjyqtare është kryer edhe relatimi i aktekspertimit nga ana e ekspertit B. H., duke marrë në shqyrtim edhe objeksionet në lidhje me këtë akt”*.

8. Denoncime nr. * prot., datë 11.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 8.2.2018, të shtetasit A.E**

Ky shtetas ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, “për favorizime të çiftit I dhe L. H.”, të cilët kanë komprometuar gjyqtarë e prokurorë në dhënien e drejtësisë. Në fakt, referuar dokumentacionit bashkëlidhur dy ankesave, evidentohet qartësisht e kundërta e pretendimeve të ankuesit. Personat (çifti i sipërpërmendur më lart) kanë qenë në cilësinë e viktimës në proces penal përkundëjt ankuesit A.E. Në këto kushte nuk dolën *indicie* për hetime të mëtejshme në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

9. Denoncim nr. * prot., datë 18.1.2018, i shtetasit E.A**

Ky denoncues ka denoncuar në mënyrë të vazhdueshme subjektin e rivlerësimit edhe në instanca të tjera dhe është e qartë se asnjë nga pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë dhe, për këtë, nuk mund të bëheshin hetime të mëtejshme në adresë të subjektit të rivlerësimit.

10. Denoncim nr. * prot., datë 4.2.2019, i shtetasit H.M**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit “për zvarritje të panumërta dhe shkelje të ligjit në dhënien e vendimit bashkëlidhur këtij denoncimi”. Nga sa u vërejt në arsyetimin e vendimit, nuk u konstatuan shkelje procedurale nga subjekti dhe, për këtë arsye, nuk mund të bëheshin hetime të mëtejshme.

11. Denoncim nr. * prot., datë 12.5.2021, i shtetasit J N**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për “dhënie vendimi të njëanshëm dhe korruptiv pa marrë parasysh faktet dhe provat e paraqitura në gjykim”, si dhe për “vonesë në zbardhjen e vendimit”. Duke studiuar vendimin dhe dokumentet bashkëlidhur vendimit të gjykatës me gjyqtare Arjana Caco konstatohet se vendimi nr. *** (objekt denoncimi) është regjistruar në datën 13.9.2019 dhe është shpallur në datën 1.10.2020 dhe sipas pretendimit të denoncuesit është zbardhur disa muaj me vonesë (në datën 3.5.2022 i është vënë në dispozicion nga postieri). Në referim të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, ndër të tjera thuhet se: *“Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë”*. Pra, siç shihet, gjyqtarja nuk e ka respektuar këtë dispozitë, çka ka çuar në shkelje nga ana e saj të afatit procedural. Ndërsa në lidhje me pretendimin se vendimi i dhënë nga gjyqtarja është vendim i njëanshëm dhe korruptiv, Komisioni nuk mund të hetonte më tej, për sa kohë ky vendim është i ankimeshëm dhe, si i tillë, mund të ndryshohet nga gjykata.

Sa më sipër, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me vonesën në zbardhjen e këtij vendimi.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se: *“Vendimi që ka të bëjë me këtë denoncim është shpallur në datën 1.10.2020 dhe është dorëzuar në sekretari në datën 25.1.2021, e provuar kjo me fletën e regjistrimit të dorëzimeve të dosjes dhe jo sipas pretendimit të z. J. N në denoncim në muajin maj 2021. Në lidhje me këtë vonesë unë sqaroj se shkak kryesor ka qenë ngarkesa e lartë në gjykimin e çështjeve, numri i lartë i vendimeve të shpallura deri në periudhën e përfundimit të gjykimit përkatës, ku kam përfunduar 119 çështje themeli, 39 kërkesa dhe 343 urdhra ekzekutimi. Të kihet parasysh edhe periudha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore mars - qershor 2020, ku për shkak të periudhës së pezullimit u mbivendos puna”*.

12. Denoncim i përsëritur nr. * prot., datë 23.2.2018, i shtetasit D.U**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit edhe në instanca të tjera për “dhënie vendimi të paligjshëm dhe në shkelje të etikës profesionale”. Referuar pretendimeve të denoncuesit evidentohet qartësisht se ato nuk qëndrojnë dhe, për këtë, nuk mund të bëheshin hetime të mëtejshme në adresë të subjektit të rivlerësimit.

13. Denoncim nr. * prot., datë 26.3.2018, i shtetasit B. B**

Ky denoncues ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit edhe në instanca të tjera për dhënie vendimesh të padrejta. Siç u vërejt nga ankesa e denoncuesit, nuk dolën *indicie* për hetime të mëtijshme në adresë të subjektit të rivlerësimit.

14. Denoncim nr. * prot., datë 6.6.2018, i shtetasve P dhe F M**

Këta denoncues kanë denoncuar subjektin e rivlerësimit për “njëanshmëri dhe shkelje të afatit të arsyeshëm ligjor në dhënien e vendimit objekt ankimi”. Referuar pretendimeve të denoncuesve pas studimit dhe analizimit të akteve ligjore bashkëlidhur këtij denoncimi nuk u evidentuan shkelje procedurale nga ana e gjyqtarës dhe, për këtë arsye, nuk mund të hetohet më tej.

15. Denoncim nr. * prot., datë 15.10.2018, i shtetas K.Ç**

Kjo shtetase ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit për “shkelje të etikës profesionale, për njëanshmëri në gjykim, si dhe ka marrë vendim të pabazuar në prova”. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit nuk u konstatuan shkelje nga subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte nuk dolën *indicie* për hetime të mëtijshme.

16. Denoncim nr. * prot., datë 16.7.2019, i shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator S.F**

Ky denoncues denoncon subjektin e rivlerësimit për “konsumim të shkeljeve të rënda ligjore dhe qëndrimin haptazi të njëanshëm në gjykimin e çështjes civile nr. ***, datë 24.11.2016, me palë: E dhe L.G, me objekt padi shkaktim dëmi”.

Rrethanat e çështjes: shoqëria “****” sh.p.k. është thirrur në gjykim si palë e paditur nga ankueset me pretendimin se kjo shoqëri i ka shkaktuar L.G dëm pasuror dhe jopasuror. Në shkurt të vitit 2014, paditësja L.G i është nënshtruar operacionit të liposuksionit pranë palës së paditur shoqërisë “****”, me mjek operator shtetasin italian A.B. Në muajin maj të vitit 2016, shoqërisë “****” i është kërkuar nga ana e paditëses L. G. realizimi i një takimi me qëllim evidentimin prej saj të disa shqetësimeve që kishte konstatuar në aspekt të formave të papëlqyeshme në zonën ku është realizuar liposuksioni (ndërrhyrja estetike). Shoqëria “****”, e përfaqësuar nga z. S.F tregoi disponueshmërinë dhe la takimin për në datën 31.5.2016, me qëllim identifikimin e problematikave të mundshme, pasojave të ardhura dhe përgjegjësitë e mundshme. Por, fatkeqësisht, mjeku italian ndërroi jetë 1 ditë përpara se të realizohej takimi me ankuesen L.G., duke bërë që takimi të shtyhej për një datë tjetër. Por, pa pritur të realizohej takimi, paditësja L.G. kreu ndërhyrje kirurgjikale të të njëjtit lloj (thithje dhjami të tepërt) me atë që kreu tek shoqëria “****”, pranë klinikës “A. C”, në Turqi, më 13.6.2016. Për rrjedhojë, takimi i dytë nuk u zhvillua kurrë. Paditësja L. G. vendosë t’i drejtohet gjykatës me kërkesëpadinë, ku shprehet se gjendja e saj u përkeqësua dukshëm, sidomos pas ndërhyrjes së dytë në klinikën në Turqi dhe, për këtë shkak, i drejtohet shoqërisë “****” sh.p.k. me kërkimet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, duke e ngarkuar me faj këtë të fundit. Në kërkesëpadi u kërkuar për të dëmshpërblyer dëmin shëndetësor pasuror, shpenzime farmaceutike dhe spitalore e të tjera shpenzime të nevojshme për paditësen, si dhe dëmin jopasuror, biologjik, moral, ekzistencial të paditëses dhe familjarëve të saj, si pasojë e ndërhyrjes kirurgjikale të pakujdesshëm të datës 14.2.2014. Shoqëria “****” kërkoi pushimin e gjyqimit për këtë padi, për sa kohë nuk mund të vërtetohet nëse dëmi kishte ardhur nga veprimet e kësaj shoqërie apo klinikës “****”, si dhe shoqëria “****” nuk gëzon legjitimitet pasiv për shkak se nuk vërtetohet se dëmi të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit/mosveprimit.

Pas caktimit të ekspertëve psikologë dhe mjeko-ligjor nga gjykata, gjyqtarja Arjana Caco pranoi shpërblimin e dëmit në vlerat e kërkuara nga paditëset në vlerën 2.579.735 lekë. Shoqëria “****” pretendon se: “Gjykata doli me këtë vendim përkundër të gjitha prapësimeve tona mbi mungesën

e provave për të vërtetuar lidhjen shkak – pasojë”. Përpos këtyre, shoqëria “****” pretendon se ky vendim është zbardhur me shumë vonesë nga gjyqtarja Arjana Caco.

Duke parë datën e regjistrimit, 24.11.2016, dhe datën e shpalljes së vendimit nr. ***, datë 1.12.2017, si dhe referuar pikës 19 të ankimit të shoqërisë “****”, drejtuar Komisionit, ku shprehimisht ankohet se *edhe pse kanë kaluar 1 vit e gjysmë nga dhënia e vendimit, ai nuk është zbardhur ende*, duket se subjekti deri në datën e regjistrimit të ankimit të shoqërisë “****” pranë Komisionit më 17.6.2019 nuk është njohur me vendimin e arsyetuar. Nga detajet e çështjes civile të printuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duket se ankuesi ka depozituar ankim në Gjykatën e Apelit, ku kërkon ndryshimin e vendimit pa numër, datë 1.12.2017 (ankuesi ka ushtruar ankim në referim të dispozitës së Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve të muajit gusht 2017, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit).

Referuar nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile thuhet se: *“Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtjje shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë”*.

Ndodhur në këto kushte, kur ankuesi pretendon këtë shkelje, vonesën tej afatit ligjor për zbardhjen e vendimit të datës 1.12.2017, Komisioni i kërkon shpjegime subjektit në lidhje me respektimin e afatit të arsyetimit të këtij vendimi.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: *“Vendimi që ka të bëjë me këtë denoncim është shpallur në datën 1.12.2017 dhe është dorëzuar në sekretari në datën 16.1.2018, e provuar kjo me fletën e regjistrimit të dorëzimeve të dosjes dhe jo sipas pretendimit të shoqërisë ‘****’ sh.p.k., në denoncim që për rreth një vit e gjysmë nuk është njohur me vendimin, për të cilin ka ushtruar edhe të drejtë ankimi dhe denoncim pranë jush. Në lidhje me këtë vonesë unë sqaroj se shkak kryesor ka qenë ngarkesa e lartë në gjykimin e çështjeve për vitin 2017, numri i lartë i vendimeve të shpallura deri në periudhën e përfundimit të gjykimit përkatës, konkretisht kam përfunduar 194 çështje themeli, 25 kërkesa civile, 320 urdhra ekzekutimi dhe 62 masa sigurimi personal”*.

17. Denoncim i përsëritur nr. * prot., datë 27.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 1.12.2021, i shtetases R. L**

Ankimin e parë shtetasja R.L ia drejton kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për dijeni Komisionit. Në këtë ankim ankohet se: *“Gjyqtarja A. Caco pasi e zvarriti çështjen për më shumë se 11 muaj duke thirrur 4 dëshmitarë dhe në fund rrëzon kërkesëpadinë, por ajo që po krijon më shumë probleme është se ajo nuk po zbardh vendimin duke më penguar mua të vazhdoj rrugën gjyqësore”*. Denoncuesja e mbyll ankimin e saj duke kërkuar zgjidhjen e problemit dhe vënien para përgjegjësisë së kësaj gjyqtareje duke kërkuar edhe inspektimin e dosjes gjyqësore. Ndërsa në denoncimin e dytë, të paraqitur pranë Komisionit, kjo shtetase ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për *“zvarritje gjykimi, zvarritje vendimi e gjykimi të njëanshëm”*. Ankuesja sjell bashkëlidhur vendimin nr. ***, datë 23.12.2020, *“Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën janar - mars 2021”*. Ky vendim duket se nuk ka lidhje me ankesën e shtetases së paraqitur pranë Komisionit. Denoncuesja R. L (S) nuk paraqiti një vendim apo referencë të saktë se kur i është drejtuar gjykatës dhe ku konsistojnë shkeljet procedurale të subjektit të rivlerësimit. Ndodhur në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej në lidhje me këto denoncime.

18. Denoncim i përsëritur nr. * prot., datë 20.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 17.5.2021, i shtetasit L.S, aksioner i shoqërisë **** sh.a.**

Në denoncimin e parë ankuesi denoncon shumë subjekte të tjera e krahas tyre edhe gjyqtarja A. Caco. Ai paraqitet si një nga aksionerët e shoqërisë “****” sh.a., i cili që nga viti 2014 e deri tani është palë në një gjykim për të përcaktuar dëmin e krijuar nga një shoqëri përmbarimore dhe një

bankë e nivelit të dytë. Ai ankohet duke thënë se: *“Më kanë grabitur përmes çekanit dhe peshores së drejtësisë, më kanë shkatërruar familjen dhe fëmijët”*. Edhe në ankimin e dytë denoncuesi pretendon se *trupit gjykues me relatores Arjana Caco pezullonte pa asnjë arsye gjykimin e çështjes pa ia kërkuar asnjë palë në proces...* Në dokumentacionin bashkëlidhur vërehet një histori gjykimi e nisur që në vitin 2009, ndërmjet palës ankuese, në cilësinë e palës paditëse, shoqërisë përmbartimore *** dhe një banke të nivelit të dytë, në cilësinë e palës së paditur. Gjyqtarja Arjana Caco duket të ketë pasur rolin e relatores së çështjes, së bashku edhe me dy gjyqtarë të tjerë të kësaj gjykate. Vendimi nr. *** akti, datë 25.9.2019 duket se është marrë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile në lidhje me pezullimin e gjykimit të një çështjeje deri në përfundim të gjykimit të një çështjeje tjetër, të filluar më parë, por që ka lidhje me çështjen e ngritur më vonë.

Ndërsa, në lidhje me pretendimet e tjera të ankuesit, ato ishin në dukje shumë subjektive dhe, për këtë, nuk mund t'i kërkoreshin shpjegime subjektivit.

19. Denoncim nr. * prot., datë 9.7.2018, i shtetasit A.M**

Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për mënyrën se si e ka trajtuar dhe argumentuar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 15.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në tri pika kryesore: për dhënie vendimi të paqartë, të paargumentuar dhe të pambështetur në norma ligjore; për zvarritje të procesit mbi dyfishin e mesatares pa ndonjë arsye apo shkak që e përligj; dhe mbajtja e një qëndrimi të njëanshëm gjatë procesit. Duke parë vendimin nr. ***, datë 15.2.2018, me gjyqtare Arjana Caco, nuk mund të gjykohet vendimmarrja e saj, por duke parë datën e regjistrimit të vendimit (15.9.2016) dhe datën e shpalljes së vendimit (15.2.2018), si dhe duke marrë parasysh pretendimet e ankuesit në lidhje me zvarritjen e procesit, Komisioni konstaton se vendimi është arsyetuar me vonesë, jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: *“Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë”*.

Për këtë arsye, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektivit, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit justifikues ligjor (kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore, si dhe kopje të vendimit nr. ***, datë 15.2.2018).

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: *“Vendimi që ka të bëjë me këtë denoncim është shpallur në datën 15.2.2018 dhe është dorëzuar në datën 23.3 2018, e provuar kjo me fletën e regjistrimit të dorëzimeve të dosjes. Në lidhje me këtë vonesë unë sqaroj se shkak kryesor ka qenë ngarkesa e lartë në gjykimin e çështjeve, numri i lartë i vendimeve të shpallura deri në periudhën e përfundimit të gjykimit përkatës, që ka të bëjë me ngarkesën e vitit 2017, meqenëse vendimi është shpallur në shkurt të vitit 2018, konkretisht kam përfunduar 194 çështje themeli, 25 kërkesa civile, 320 urdhra ekzekutimi dhe 62 masa sigurimi personal”*.

20. Denoncim nr. * prot., datë 18.1.2022, i shtetasit M. P**

Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit se: *“Në konfliktin që ka pasur me shoqërinë ‘*** ...’ sh.p.k., pas rigjykimit nga gjykata e shkallës së parë me gjyqtare Arjana Caco, nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit si gjykatë më e lartë duke e shtyrë pafundësisht gjykimin për arsye absurde. Pas shumë zvarritjeve të qëllimshme dhe krejt abuzive ka shtyrë për shpallje seance nga data 26.5.2021 deri më 16.6.2021 dhe, në përfundim, e ka dorëzuar në sekretari të arsyetuar më 30.12.2021 (6 muaj më vonë), ku është tërhequr nga ana jonë në datën 31.12.2021”*. Në vështrim të përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 16.6.2021, bashkëlidhur ankimit të shtetasit M.P, evidentohet se në lidhje me detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit, gjyqtarja Arjana Caco i ka konsideruar dhe është shprehur për to. Ndërsa, në lidhje me pretendimin e ankuesit se gjyqtarja ka zvarritur gjykimin dhe zbardhjen e vendimit, ku pretendohet se vendimi

i zbardhur është tërhequr 6 muaj pas shpalljes së vendimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime për këtë fakt.

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: *“Vendimi që ka të bëjë me këtë denoncim është shpallur në datën 16.6.2021 dhe është dorëzuar në datën 23.12.2021, bashkëlidhur fletë e librit të dorëzimit të dosjes. Në lidhje me këtë vonesë deklaroj se ngarkesa në punë ka qenë tejet e lartë për shkak të zvogëlimit të numrit total të gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhoma civile), numri i lartë i vendimeve të shpallura deri në periudhën e përfundimit të gjyqimit përkatës, ku konkretisht kam përfunduar 224 çështje themeli, 65 kërkesa civile, 692 urdhra ekzekutimi dhe 36 OJF”.*

Vlerësimi i Komisionit pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit për denoncimet e publikut

Subjekti i rivlerësimit prapësoi kërkesat për shpjegim për secilin denoncim, duke sjellë si argument ngarkesën tejet të lartë në punë për shkak të zvogëlimit të numrit total të gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Trupi gjykues, në përfundim, arriti në konkluzionin se subjekti ka kryer shkelje lidhur me afatin e arsyetimit dhe të zbardhjes me vonesë të vendimeve, jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se në bazë të rrethanave dhe kushteve të mësipërme subjekti i rivlerësimit konsiderohet e aftë dhe efiçente në masë të pranueshme, duke arritur në përfundimin se ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Komisioni, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsyet e përmendura në këtë vendim në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.*

Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -36.169.783 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në kushtet e germave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Arjana Gumbardhi, për kriterin e vlerësimit të pasurisë vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për pesë çështjet e shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi i kriterit të pasurisë sipas paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Arjana Gumbardhi ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, referuar germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arjana Gumbardhi, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.10.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi